

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 399 • SHKURT 2024



INTERVISTA ME ISH-PRESIDENTIN
PROF. DR. FATMIR SEJDIUN

“PRERJA E ARTË” — MASA HYJNORE
E BUKURISË DHE E HARMONISË

BULLIZMI NGA
KËNDVËSHTRIMI ISLAM

Zahir Pajaziti:
***"Dëshira ime është me i pa trojet
shqiptare të lira"***



Hakif Zejnullahu

Zahir Pajaziti

Edmond Hoxha

PUSHKA E PARË E LIRISË

EDITORIAL

- 4 Çlirimi ishte ideali
i tyre, sendërtimi i lirisë
mbetet detyrimi ynë

INTERVISTA

- 5 Projekti i pavarësisë
është projekt i përbashkët i
BESA – BESËS (intervistë me
ish-presidentin Sejdiu)

FETARE

- 11 Migrimi nga
persekutimi dhe
varfëria
Daut Dauti
- 13 Feja apo kombi
– absurdi i manipulimit të
panevojshëm
Hajrudin S. Muja
- 17 “Prerja e artë” –
masa hyjnore e bukurisë
dhe e harmonisë
Mimoza Sinani
- 21 Kaptina Keuther –
Njëshmëria e Zotit (Teuhidi)
Dr. Valmire Batatina – Krasniqi
- 24 Përvetësimi i
virtyteve të moralit
Dr. Sadat Islami
- 27 Israja dhe Miraxhi -
mrekulli unike
Mr. Muharrem Bryma
- 30 Ixhtihadi kolektiv
bashkëkohor, rëndësia
dhe nevoja
Dr. Selatin Mehani
- 34 Dispozitat e
huadhënies dhe dhuratës
në të drejtën islame
Dr. Flamur Sofiu
- 38 Doracakët më të
njohur të fikhut hanefi (4)
Hazir D. Selmani



FAMILJE & EDUKIM

- 41 Bullizmi nga
këndvështrimi islam
Mr. Jakup Çunaku

HISTORI & CIVILIZIM

- 46 Rrëfimi i hoxhës Isë
Tërshani për masakrën
e Reçakut
- 49 Vështrim mbi
mendimin e Ukshin Hotit
Ma. Blerim Halili
- 52 Kontributi i grave në
shkencën e tefsirit
përgjatë historisë
Anisa Hoti



KULTURË

- 55 Muhamedi a.s. në
letërsinë e divanit
Dr. Besir Neziri
- 58 Kultura, keqkuptimet
dhe ridizajnimi i vlerave
Imer Topanica



REPORTAZH

- 61 Vizita e Myftiut Naim
ef. Tërnavë në
Arabianë Saudite

AKTIVITETE

- 67 Urimi i Myftiut
Tërnavë për zgjedhjen
e kryeministrit të
Maqedonisë së Veriut, z.
Talat Xhaferit

POEZI

- 69 Frymëzimi
Granit Sadiku
- 70 Perlë e kokës sime
Samire Bilalli



DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare,
shkencore e kulturore
Nr. 399 • viti 37 • Shkurt 2024
• Rexheb / Sha'ban 1445
• çmimi 1 €

Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë

Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi
Anëtarë:
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,
Mr. Muharrem Tërnavë,
Mr. Vedat Shabani.
Lektor & korrektor: Bajram Zeqiri
Redaktor artistik & teknik:
Bashkim Mehani

Adresa

"Dituria Islame",
rr. "Bajram Kelmendi" nr. 182,
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +384 38 224 024
E-mail: redaksia@dituriaislame.net
www.dituriaislame.net
Shtypi:
"Ilirprint", Prishtinë



“Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij...”

(Ali Imran, 169-170)

Çlirimi ishte ideali i tyre, sendërtimi i lirisë mbetet detyrimi ynë

Atëbotë kur robëria dhe pushtimi i egër kishte ngrysur qiellin tonë të kthjellët, çdo aspiratë tjetër pos çlirimit dhe largimit të okupuesit nga pellgu ynë autokton, ishte një luks që as nuk duhej ëndërruar. Duarlidhur, gojëmbyllur e kokulur, s'mund të aspironim ndonjë cilësi në arsim, apo rend ligjor, por as stabilitet ekonomik, apo zhvillim të gjithmbarshëm në vend. S'mundnim, ngase s'merrnim dot as frymë lirshëm në truallin e trashëguar. Këto preokupime të avancuara, atëherë edhe sot, mbetin privilegj i popujve të mëdhenj. Ne të vegjlit e privuar, ato lukse nuk i gëzonim.

Për të krijuar një kapërcyell të lavdishëm të idealeve kombëtare, e për t'i futur në plan tonin preokupimet e popujve të zhvilluar, duhej një vetëdije e lartë shoqërore, e cila do të listonte njëherë e mirë prioritetet e kombit, doemos me fillim nga liria. Njëherësh, duhej të shmangeshin ato “prioritetet” lajthitëse të inskenuara nga dora e pushtuesit hegjemonist, që pos se do ta shtynin lirinë tonë të vonuar, ndoshta edhe do ta fshinin atë në tërësi nga harta e projektit tonë shekullor për mëvetësi.

Shkurti i çdo viti, dhe 17-shi i tij i paharruar, për ne shqiptarët e Kosovës, mbetet data që freskon po atë vetëdije kombëtare dhe rigjeneron mahnitshëm gjithmonë shpirtin tonë atdheadashës. Ajo na detyron të mbajmë sytë kah e ardhmja gjithsesi, porse na thotë me ngulm edhe që të mos harrojmë kurrë ata heronj që e deshën më së miri e më së shumti atdheun tonë të çmuar. Ata që “ikën” nga këtu, për të lënë pas vete namin e flijimit, si vepër kolosale që i bëri të pavdekshëm në histori. Zoti i Madhërishëm, “pavdekësinë” e kësaj kategorie deficite e proklamoi në shpalljen e fundit hyjnore, kur tha: “Kurrresi të mos mendoni se janë të vdekur ata që ranë dëshmorë në rrugën e Allahut. Përkundrazi, ata janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar me atë që u dha Allahu nga të mirat e Tij...” (Ali Imran, 169-170). Nëse e kuptojmë idealin sublim që u kalit në shpirtrat e tyre, e kemi të lehtë për të kuptuar edhe arsyen e pavdekësisë së veprës e emrave të tyre. Gjëma e rezistencës së tyre jehoi fuqishëm, sa bëri botën të kthejë kokën, e të dëgjojë më kujdes klithmën e një populli të përvuajtur e pa liri.

Të mëdhenjtë e këtij kombi e të kësaj toke, megjithatë me dëlirësi “lëshuan” vend e rend për ne brezat që erdhëm pas tyre, sikur për të na thënë se edhe ne mund dhe duhet ta duam atdheun, ani pse me diç më pak se sa flijimi për të. Ata ikën, por lanë amanet në duart tona, ngritjen lart të shtetit tonë me sakrifica më modeste, e gjëra më të vogla, paçka se në vitet e paqes ato duket se janë tejet të mëdha. Atdheu e kursen dhe e ruan me çdo kusht jetën tonë bashkë me pasuri, ndërsa kërkon nga ne flijimin, vetëm atëherë kur bëhet i domosdoshëm për shpëtim, dinjitet e pavarësi. Andaj ne, e jo të tjerët, edhe tani mund të bëjmë historinë tonë me heroizmat tonë “modestë”, ngase në çdo epokë e nga çdo brez, “historia e shqiptarëve nuk duhet të bëhet nga të tjerët, por duhet njohur nga të tjerët”, do të thoshte i flijuari për mëvetësinë e kësaj toke, Ukshin Hoti.

Të qëndrojmë në truallin tonë, të mos e braktisim atë për një plaçkë të lirë të kësaj bote, të mbjellim shpirtin e unitetit e mirëkuptimit reciprok, ta duam e ta ruajmë njëri-tjetrin, ta flakim sëmundjen e smirës, urrejtjes e mos durimit ndaj bijve të këtij kombi. Të gjitha tok, e të tjera si këto, mund të duken vepra të pavlera për dikë, porse të tillat mbetin shtyllat themelore të ruajtjes e forcimit të lirisë sonë të vonuar. Pa një edukatë të qëndrueshme e arsimim të mirëfilltë, në njërën anë, si dhe pa besim në Atë Zot që përvijoi shkaqet njerëzore për lirinë tonë dhe mirënjohje të thellë ndaj Tij, në anën tjetër, ne do të mbeteshim shpirtërisht e kombëtarisht të çorientuar dhe me duart tona rrezikojmë ta njollosim tregimin e triumfit që breza të tërë e aspiruan.

Brezi i sakrificës, na dha emër, dhe e fitoi trofeun e çlirimit e të pavarësisë, e ne sot na ka mbetur për t'u fituar ai i mëkëmbjes së shtetit e i forcimit të mëvetësisë. Këtë tokë e këtë liri e kemi amanet, andaj ruajtja e tij është dëlirësi e dinjitet.

Mr. Driton Arifi

Intervistë me ish-presidentin e Republikës së Kosovës, prof. dr. Fatmir Sejdiun

“Projekti i pavarësisë është projekt i përbashkët i BESA – BESËS”

I nderuari president, më lejoni që në fillim të shprehim falënderimin tonë për kohën që keni ndarë, si dhe mundësinë që na e dhatë që të takohemi e të jepni këtë intervistë për revistën “Dituria Islame”, e cila tash e 38 vjet përpiqet që në fletat e saja të mishërojë te njerëzit e kësaj gjuhe e këtij kombi dashurinë për Zot e për atdhe. Kjo revistë lindi në Kosovë, në një kohë sakrificash dhe sfidash të mëdha për popullin e Kosovës, që në vitin 1986, por megjithatë nuk u ndal për asnjë moment që të hedh dritë në rrugën e këtij populli për liri e për pavarësi.

Faleminderit që keni ardhur dhe që keni marrë një vendim të tillë. Është një kënaqësi që të jemi bashkë me ju, duke çmuar traditën e “Diturisë Islame” dhe angazhimet e saj për një kohë të gjatë, përtej tri dekadash, në shërbim të një informimi të mirë, të drejtë, të nevojshëm dhe të dobishëm për qytetarët e Kosovës, për Kosovën tonë. Faleminderit!

I nderuari president, ju vini nga një familje fisnike, nga Pakashtica e Podujevës, një pjesë pothuajse kufitare me fqinjin verior, a mund të na flisni për prejardhjen tuaj familjare dhe cili ishte ndikimi i prindërve e i gjyshit, madje edhe ndikimi i kësaj frymëse së kësaj treve në formimin tuaj intelektual, kombëtar edhe atë edukativ?

Po, ju keni të drejtë, unë rrjedh nga një mjedis gati në kufi, në vijën ajrore janë diku një kilometër apo një kilometër e gjysmë, jo më shumë në pjesën lindore me kufirin me Serbinë. Një vend, i cili gjatë historisë ka dhënë vërtet personalitete të rëndësishme që janë angazhuar dhe kanë dhënë kontribute të rëndësishme për të ardhmen e popullit tonë. Unë nuk do të zgjatem shumë për pjesën e historikut të familjes sime, por mund të them se vërtet është një nga familjet, sikur edhe shumë familje të tjera, që në trevën e Llapit dhe andej-këndej Kosovës, ka pasur aspiratë të veçantë lirinë nacionale, duke qenë gjithmonë e angazhuar për të kundërshtuar të gjithë atë që bëhej kundër popullit tonë nëpër vitet apo dekadat e kapërcyera, pra për një shekull të plotë.

Gjyshi im ka qenë një personalitet jashtëzakonisht i çmuar. Ka qenë me shkollim fetar, pra me Medresenë “Isa Beg” në Mitrovicë, në fillim kur ka qenë, ngase ajo më vonë është bartur në Shkup, dhe është çmuar jashtëzakonisht shumë prej bashkëvendësve dhe të gjithë të tjerëve, që kanë gravituar në atë qendër, sepse ajo ka qenë një xhami që ka pasur edhe mejtepin e vet, dhe si e tillë, natyrisht se ka pasur mbështetjen e popullatës. Në një kohë të mëvonshme, kur është lejuar mundësia që nxënësit shqiptarë të regjistrohen në shkolla



laike, pas presioneve të mëdha që janë bërë në lidhjen e kombeve, ai është pranuar si mësues. Ka qenë kërkesa e xhematit, ka qenë kërkesa e popullit, që të japë një lëndë tepër të rëndësishme, edukatën mbi fenë apo shkencën mbi fenë. Ka qenë një porosi paralele e tij se nxënësit duhet të shkollohen dhe të përcjellin mësimet e rregullta edhe në shkollën laike, për të qenë të dobishëm për vend. E di se në ditët e para kur gjyshi im ka tubuar nxënësit shqiptarë, që kanë qenë të përfshirë në atë shkollim, përveç të tjerash, u ka thënë edhe një fjali, se përveç kësaj që do të mësojmë për fenë, do të mësojmë edhe sa herë sillet rrota nga vendi ynë, do të thotë nga vendbanimi ynë deri në Prishtinë, që tregon se ka qenë ideja e tij për të mësuar dhe për të bërë nga shkencat ekzakto, atë që kishin bërë medresetë e reformuar në kohët e mëvonshme. Ai ka arritur që të jetë një shembull personal jashtëzakonisht unikat, sepse ka shkolluar të gjithë fëmijët e tij, ka dhënë porosi që të shkollohen nxënësit shqiptarë edhe të viseve të tjera, po flas të rajonit tonë. Ajo që ka qenë tepër interesante, ka qenë se në një periudhë në fillim të kohës së Luftës së Dytë Botërore dhe pak më vonë e ka dërguar edhe vajzën e vet në shkollim. Ajo ka qenë diku deri në klasën e tetë në shkollimin fillore, dhe atëherë, pas disa aksioneve të qëllimta për familjen tonë, babai imë është arrestuar, xhaxhain e kanë përjashtuar nga detyra, xhaxhait tjetër i është ndaluar bursa, ndërsa të katërtin e kanë larguar nga shkolla. Atëherë gjyshi në njëfarë mënyrë e ka parë gati një perspektivë të mbyllur, sepse jemi detyruar në atë kohë, e mbaj mend edhe vet, që të emigrojmë nga fshati, të shkojmë në një fshat të rrethit të Kumanovës, për të qëndruar një kohë atje, derisa të krijohen rrethanat e tjera të reja. Kjo ka qenë një shembull, unë them edhe shembull sakrifice, me atë përballje që ishte me regjimin e kohës, i cili nuk ishte ndalur vetëm me marrjen e të drejtave qytetare dhe politike të gjyshit tim, por ishte marrë edhe me përndjekje të tjera. Duke pasur parasysh shembullin e babës tim, i cili ka filluar edhe ky shkollimin, pra ka kryer klasën e parë në Medresenë “Isa Beg”, pra ajo që ishte në Mitrovicë dhe më vonë është bartur në gimnazin “Sami Frashëri”, ka bërë atë kapërcimin në normale dhe ka diplomuar shumë herë, pra në vitet 1947-1948, ndërsa në 1949, ka përfunduar edhe normalen. Kjo, pavarësisht gjitha rrethanave që i përmenda, nuk e ka ndalur atë që të bëjë përpjekje të vazhdueshme për t’i vetëdijesuar qytetarët e vendit, sidomos dy – tre situata të vështira, që kanë qenë koha e aksionit të pushkëve, 1956, në atë dimër, sado që kam qenë

E di se në ditët e para kur gjyshi im ka tubuar nxënësit shqiptarë, që kanë qenë të përfshirë në atë shkollim, përveç të tjerash, u ka thënë edhe një fjali, se përveç kësaj që do të mësojmë për fenë, do të mësojmë edhe sa herë sillet rrota nga vendi ynë deri në Prishtinë.

fëmijë, e mbaj mend ofshamën e njerëzve që i rrihnin në sheshin e fshatit, sidomos në fshatin e dajallarëve të mi, në Letancë. E di edhe personat që kanë qenë vërtet më të nënshtruar ndaj asaj dhune dhe terrori, sikur që ishte edhe në familjen tonë dhe në familjet e tjera të shumta. Ata kanë kundërshtuar paralelisht atë që ka qenë një nga atutë, apo në njëfarë mënyrë ka qenë një nga shkaqet, sepse shkaku ishte qëllimi për dëbimin e shqiptarëve në Turqi, që të propagandohej realisht se ne duhet të rrimë në vendin tonë, kjo është toka jonë, kjo është buka jonë dhe kjo është ardhmëria jonë. Andaj, i takoj asaj familje dhe me krenari them gjithmonë, me përpjekjet që ta mbaj lart atë porosinë e saj (familjes), mesazhet që ka pasur për qytetarët e vendit dhe për vetvete, natyrisht, duke pasur parasysh se fat identik kanë pasur edhe shumë familje të tjera të Kosovës apo të shqiptarëve anekënd saj.

Në rrugëtimin tuaj intelektual, ku e gjenit motivimin shtytës për shkollim e ngritje intelektuale, marrë parasysh kushtet socio-ekonomike e rrethanat politike të asaj kohe?

Jeta është sfidë e vazhdueshme dhe natyrisht se nuk është porosi që njerëzit të dorëzohen, thjesht është një përballje me gjithë ato rrethana, që siç i thamë më parë, i kanë përjetuar edhe shumë familje shqiptare, sidomos në këto kohë e cikleve të mëdha të

krizave që janë krijuar qëllimshëm për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e veta dhe thjesht për realizimin e atij projektit të Çubrilloviqit, i cili ishte shumë i hershëm dhe i Garashaninit, edhe më herët se ai, që të zhbëhet Kosova dhe të zhbëhet gjendja shqiptare. Ishte një përpjekje e vazhdueshme në përplasje me tendencën e tilla. Periudha e dytë është kjo që na ka përcjellë, sidomos pas përjashtimit të serishëm të babës nga puna, më 1962, dhe më 1963, jemi bartur në Podujevë. Megjithatë nuk kishte kuadër krejt të kualifikuar, kishim gjithë arsimtarët shqiptarë në qendër, që ishte edhe preferencë e etërve tanë. Arsimtarët shqiptarë shumicën e tyre i kishin vendosur nëpër fshatra larg, apo edhe i kanë larguar nga puna. Gjysmën e lëndëve në shkollën fillore, në klasën e gjashtë, të shtatë dhe të tetë, i kam pasur në gjuhën serbokroate. Kjo ka zgjatur deri në periudhën e rënies së Rankoviqit, në korrikun e vitit 1966, dhe imagjinoni, një fëmijë që ka përpjekjet e veta të përgatitjes në gjuhën amtare dhe ta mësojë atë si duhet, të detyrohet që të mësojë edhe lëndë të tjera, jo vetëm në gjuhën serbokroate si lëndë mësimore, por edhe lëndë të tjera. Pra, ka qenë diçka që është

përjetuar në atë kohë dhe ka qenë jashtëzakonisht goditëse dhe thjesht frikësuese, dhe për shumë kënd që nuk kanë pasur pastaj mundësi dhe janë tërhequr nga shkollimi. Dëshira ishte që njerëzit apo nxënësit shqiptarë të mos shkojnë në shkollë, dhe të mos hiqet ajo pjesë e përqindjes së madhe të analfabetizmit, pavarësisht kurseve që janë organizuar, që ishte një diçka që përkonte apo lidhej me projektet që Serbia kishte në vazhdimësi. Në fazën e mëvonshme, natyrisht që ishte një kohë pak a shumë liberale, nga 1966 e këndeje dhe kjo do të na përcjellë deri në vitet '80. Në atë kohë unë kam përfunduar studimet, ka qenë fati im që të përcaktohem për studimet e drejtësisë, e di që kjo në njëfarë mënyre ka qenë në kundërshtim pak a shumë me vullnetin e prindërve të mi, që kanë dashur që të shkojë dhe të bëhem mjek, dhe pavarësisht qasjes sime që të jem i mirësjellshëm me njerëz, me ata që kanë nevoja të veçanta, kam zgjedhur drejtësinë. Kam menduar që është tepër e nevojshme që të studiohet si duhet, dhe për të qenë një njeri me shkollim të lartë, që mund të ndihmojë vendim tim. Kam pasur aspirata, e po ashtu edhe për shkak të rezultateve që kisha, mbeta që të mbetem në fakultet dhe të kontribuoj nga aty në mësimdhënie. Kam mbaruar studimet në '74, e kam vazhduar pastaj me masterin dhe në fazë të mëvonshme me doktoratën. Por të gjitha këto lidhen me tema që janë me interes për vendin, për Kosovën. Teza e doktoratës sime ka qenë "Reformat agrare nga viti 1945 e deri më 1963", dhe nga kjo kam nxjerrë pastaj një monografi tepër interesante, që është syzheu i gjithë kësaj se si politikat agrare shërbejnë si

instrument i shtypjes nacionale. Është një libër i mirë dhe mendoj se hap sytë për shumë e shumë çështje, të cilat kanë qenë në atë kohë të pastudiuara. Ka qenë çështja apo politika e dëbimit shqiptar në marrjen e tokës, vështirësive të mëdha për ekzistencën e tyre dhe shumëçka ia kanë arritur, sot kemi familje të tëra që janë në Turqi apo në Shqipëri, të cilat kanë emigruar dhe s'kanë pasur mundësi më të kthehen.

Cili ishte momenti apo ngjarja në jetën tuaj që shënonte për ju një pikëkthese, që pas saj ju vendosët që të merreshit me politikë dhe me kauzën kombëtare?

Unë e kam thënë edhe disa herë, nga pak edhe si në shaka, por është e vërtetë, si fëmijë, kur babai im ka qenë në burg, fëmijët e lagjes sime nuk kanë luajtur me mua. Këtë e kam tregim prej prindërve të mi, prej nënës sime, prej gjyshit. Në njëfarë mënyre ka qenë një izolim, një dëbim, thjesht nga frika, unë e besoj atë. Kjo ka ndodhur sidomos pas atyre trysnive të filluara në fillim të viteve '80, reagimet e mëdha që ndodhën me demonstratat e 1981, e posaçërisht faza e mëvonshme më 1989 dhe këndeje, shihej qartë projekti i saj. Projekti i saj ishte krijimi i një Jugosllavie serbe të madhe, luftë kundër të gjithëve, që ishte një qasje jashtëzakonisht me ogur e ogurzezë, të themi edhe për popujt e tjerë, që solli deri të lufta dhe vendimi im ka qenë që të vazhdojë atë traditë që kanë pasur prindërit e mi, që ka pasur gjyshi im, dhe natyrisht se jam inkuadruar në këto procese. Është fat i madh në këtë kohë, që karshi edhe lëvizjeve të caktuara, sepse rezistenca nuk është ndal asnjëherë, në forma të ndryshme, ajo ka



ndodhur, por është fat i madh që ka lindur ideja për të formuar mekanizma, posaçërisht në atë kohë, që do të dalin karshi apo përballen me një sfidë të re, kaq planifikuese e kaq ogurzezë për të ardhmen tonë. Unë kam pasur fatin që të njoh edhe shumë miq të mirë, në mesin e tyre edhe profesor Berishën, profesor Krasniqin dhe Xhemal Mustafën, që të jenë treni nismëtar i themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Natyrisht, ardhja në krye e presidentit Rugova, një personalitet interesant, jashtëzakonisht i guximshëm, me vlera të veçanta dhe me një urti tepër të theksuar. Unë do të fillojë asisoj dhe nga dita e parë kam marrë pjesë në Kuvendin themelues, dhe në fazat e mëvonshme, në proceset që janë organizuar, duke qenë anëtar i Këshillit të Përgjithshëm, pastaj sekretar i përgjithshëm për dy mandate, pastaj vijmë në një periudhë me thyerje të madhe që janë bërë me luftën, dhe fatkeqësisht me shkuarjen në amshim të presidentit Rugova, të më besohet udhëheqja e vendit, në një situatë jashtëzakonisht të ndjeshme me shumë kërkesa dhe prej të gjithave, që të lëvizim fuqishëm bashkë me miqtë e Kosovës, që intervenuan kundra caceve vrastare që bënë masakra në Kosovë. Ajo shtatëdhjetë e tetë ditëshja e njohur që rrallëherë përsëritet, dhe po them është nga të parat në atë mënyrë se si është bërë, të përfundohej me përmbylljen e këtij procesi politik. Natyrisht që kemi hyrë në sfida të reja, të cilat kërkojnë argatin e plotë njëzetë e katër orësh, meqë nuk është lehtë të mbahet një shtet me një qëndrueshmëri, karshi gjithë atyre që kanë pasur rrënime të shumta, pastaj pasojat e mëdha në viktme që Kosova i ka përjetuar, e që sot s'u dihet fati edhe i diku mbi 1500 njerëzve, të cilët janë të zhdukur.

Gjatë veprimtarisë suaj politike, qoftë para ose pas lufte, a e keni gjetur vetveten ndonjëherë në situatë dëshpëruese që disi t'iu kenë venitur edhe shpresat për liri e pavarësi të shtetit tonë?

Jo, unë mendoj se pavarësisht asaj që janë përballuar, pra edhe projektit politik dhe asaj që njerëzit kanë bartur, megjithatë ata kanë besuar në të ardhmen. Kjo është ajo që popullin e ka nxjerrë dhe e ka lëvizur përpara, sepse përndryshe, nëse nuk beson në atë që punon, absolutisht edhe nuk do ta kesh, nuk do ta arrish atë. Për ne është shumë me rëndësi, ta zëmë, ta marrim shembullin që është unikat, sfera e arsimit gjatë kohës së okupimit, se sa është punuar e se sa me përkushtim kanë shkuar nxënësit në klasën e parë, se sa kanë mbetur studentë dhe nuk kanë shkuar në skajet e ndryshme të botës, sikur që ka ndodhur te popujt e tjerë, se sa është ai risk i madh që të sigurohen mjete për t'i ushqyer thjesht familjet e tyre.

Çfarë mendoni se e përshpejtoi arritjen e ëndrrës sonë shekullore për pavarësi në këtë fillim shekulli?

Unë do të japë dy faktorë. E para është një homogjenizim në qëllim, apo për qëllimin kryesor të gjithë qytetarëve të vendit që kanë pasur thjesht një ambicie për të dalë nga gjendja që e kemi pasur, vrasjet, terrori, dhuna dhe gjithë ajo

që është përdorur dhe mjelja e Kosovës, në vazhdimësi minierat e Kosovës kanë punuar për Beogradin.

E dyta është faktori ndërkombëtar dhe njohja e thellë e problemit të Kosovës nga ana e tyre. Është hera e parë që është thyer ajo klisheja e dikurshme e identifikimit tonë si diçka tjetër. Ka pasur propagandë jashtëzakonisht të madhe, sikur edhe sot që Serbia e vepron, që janë diçka tjetër, janë popull, ashtu siç Çubrilloviqi që thotë, apo dhe të tjerët që kanë shkruar vepra, se janë thjesht qëllim këqija për shqiptarët, se janë me bisht që posa kanë zbritur nga malet, shqiptarët s'dinë se çka është civilizimi dhe të tjerët që janë turq. Flas në konotacionin e tyre, unë nuk duhet të fyej askënd, por që janë rrezik për Evropën dhe ata sot bëjnë politikë të tillë. Sot, serbët në vendet islamike, shkojnë dhe u thonë se këta njerëz janë me Perëndimin, te vendet e krishtera thonë se këta janë në llamburitë e Islamit radikal, dhe mund të ketë edhe pak kush që është lodhur prej këtyre, por unë thjesht them se nuk është e lodhur as Kosova e as njerëzit e saj. Mund të kemi probleme ekonomike, absolutisht, dhe është diçka që mund të na kushtojë ende si popull, pra e shohim si një derdhje të madhe këtyre viteve, sidomos tash edhe në këto fazat e fundit të ikjes së të rinjve dhe të trurit siç thuhet, të mjekëve, të inxhinierëve, të ekonomistëve të mirë, të zejtarëve të mirë, zanatçinjtë të mirë të profesioneve të ndryshme, por unë mendoj se duhet dhe duhet të ketë projekte edhe më agile në kuptim të nxitjes jashtë konkurrencës së brendshme dhe kualitetit të punës brenda. Kosova do të qëndrojë pavarësisht gjithë këtyre që i shkruajnë, flas në kuptimin e asaj që Serbia ka qejf të na shohë, se nuk do ta realizojë.

Përgjatë përpjekjeve për sensibilizim ndërkombëtar të çështjes së Kosovës qoftë para ose pas luftës së Kosovës, a e keni parë ndonjëherë si kompleks përkatësinë fetare në shumicë myslimane të popullit tonë? A mendoni se kishte kjo ndonjë efekt në vonimin e tërë procesit tonë drejt lirisë e pavarësisë?

Jo, asnjëherë. Shikoni, ne kemi pasur situata e paragjykime në fazat e mëhershme, atë që e thash se është folur ndryshe për identitetin shqiptar, për identitetin e Islamit, thjesht si besim i shumicës të shqiptarët, unë nuk dua të hyjë me shifra tash, por një fat i madh i veçantë në këtë është se pjesa e aksionit politik, që është vepruar në vitet e hershme, dhe sidomos në kohën edhe të paraluftës, se nuk jemi nga ata që ju mendoni. Në Evropë jemi edhe ne, madje jemi edhe më të hershëm se shumë popujt e tjerë, dhe ata që kanë ardhur përtej Karpateve në hapësirat tonë. E dyta që është e rëndësishme është toleranca brenda shqiptarë, flas edhe te myslimanët, edhe te të krishterët, pavarësisht sektarizmit që ekziston. Janë në një përputhje të përbashkët me projektin nacional. Një projekt që ka qenë edhe i rilindësve, shikoni se si janë ato thirrjet e tyre dhe kjo bënë që praktikisht, ne para botës, të dalim me idenë e njerëzve të një civilizimi të lashtë

e të hershëm, që ka pasur gjithmonë probleme me zaptuesit e vet, dhe problemet e tilla, apo zaptuesit e tillë kanë shkaktuar pasoja në vonesat e caktuara historike tona.

Fati historik deshi që në kohën kur Kosova shpalli pavarësinë e saj, ju ishit president i vendit, i një shteti të ri që veçse po formohej, çfarë nostalgjie ju ngjallë sot ajo ditë e 17 shkurtit 2008, ai moment dhe ato pamje, që kanë mbetur të gravuara në memorien e gjithë popullit tonë?

Po, ajo është një ditë që nuk përsëritet dhe ndodh vetëm një herë. Gjeneratat e shumta kanë shkuar dhe nuk e kanë përjetuar, flasim sidomos nga ndarja e 1912-1913, dhe është një fat shumë i madh dhe është privilegj edhe për ne që kemi qenë në procese politike vendimmarrëse. Pra edhe në ditën kur është miratuar deklarata për pavarësinë e Kosovës, që është miratuar nga Kuvendi i Republikës, por edhe në pjesën e gjithë të tjerëve që e kanë ndihmuar Kosovën. Unë në cilësinë që e kam pasur, pra nga 2006 e deri më vonë, kam pasur paralelisht barrën time që ta vazhdojë edhe atë ecje që ka pasur presidenti Rugova, sidomos me tolerancën, me dëgjimin e mendimit tjetër, me këshillimet e shumta dhe me mbajtjen e miqve të jashtëm. E di që shumëkush nga miqtë që nuk kanë as farë as fis me ne shqiptarët e kanë ndje ditë gëzimi. Unë i quaj shumë prej tyre edhe si pjesë e historisë së Kosovës, sepse janë njerëz që kanë dhënë shumë, duke filluar prej asaj që e kemi në 1992, deklaratën e presidentit Bush seniorit apo plakut, se Kosova paraqet vijë të kuqe, që s'guxon të shkelet, është kërcënim i dhjetorit të 1992, deri te intervenimi i madh që bëhet në 1999, presidenti Clinton, Wesli Klark, Solana dhe shumë të tjerë, edhe në fazën kur do të jetë "enough is enough- **mjaft është mjaft**", atë që e thotë presidenti Bush i riu dhe angazhimi i tij që Kosova të njihet si shtet i pavarur, karshi apo përballë dikujt që dyshonte të vazhdojë, thjesht me agoninë e saj, në një status të papërcaktuar dhe që do të ishte problem.

Si e vlerësoni kontributin e komuniteteve fetare, specifikisht atë të Bashkësisë Islame të Kosovës, në arritjen e ëndrrës sonë shekullore për pavarësi, dhe rolin që duhet ta kenë tani e tutje në zhvillimin e mëkëmbjen e shtetit tonë?

Unë i them dy gjëra, e para që çdo shqiptar, ka vepruar si shqiptar. Ajo është esenciale për ne dhe nuk ka pasur ndarje, si dhe projekti i pavarësisë është projekt i përbashkët i besa-besës. Çështja e besimit është liri shpirtërore dhe përcaktim

Sot, serbët në vendet islamike, shkojnë dhe u thonë se këta njerëz janë me Perëndimin, te vendet e krishtera thonë se këta janë në llamburitë e Islamit radikal, dhe mund të ketë edhe pak kush që është lodhur prej këtyre, por unë thjesht them se nuk është e lodhur as Kosova e as njerëzit e saj.

shpirtëror i secilit. Por e them që paralelisht, çdo institucion i kultit në Kosovë, përgjithësisht, apo them që nuk di që ka raste të tanishme, ndonjëherë edhe mund të ketë pasur ndonjë keqpërdorim, por gjegjësisht kanë qenë të rreshtuar mirë dhe mbarë. Kanë pasur thjesht të njëjtën qasje, sikur edhe njerëzit nga politika. Mund të themi që paralelisht kjo është një politikë e përbashkët, në njëfarë mënyrë e shkrirë në një qëllim të përbashkët, që njerëzit të jetojnë të lirë, që të kenë lirinë e feve dhe të besimit e të zhvillimit të saj, të jetë ajo që është në shtetet normale, pra me garancione të plota, dhe Kosova, po them, është një shembull i veçantë i mirë. Keni parasysh të gjithë shqiptarët dhe rrjedhat historike të mëhershme se si kanë reaguar përballë këtyre sfidave që kanë në faza të ndryshme të zhvillimit tonë.

Duke analizuar rrjedhat e sotshme politike në vend, politik bërjen tonë, a mendoni se Kosova në një periudhë afatshkurtër do e gjej vetën krah shteteve të zhvilluara dhe e anëtarësuar në të gjithë mekanizmat relevantë ndërkombëtarë?

Absolutisht po. Vonesa mund të ketë, sepse janë vonuar edhe popujt e tjerë. E keni parasysh disa nga popujt, bullgarët p.sh., rumunët, besa edhe grekët janë vonuar, kanë pasur për qëllim që të jenë pjesë e Bashkimit Evropian në momentin e anëtarësimit, që janë shikuar nëpër gishtërinj në fakt çështje e drejta, diku janë derdhur mbi tre milion e gjysmë vetëm nga dy shtetet e para që përmenda. Por realisht Evropa i kthen në shtëpinë e vet, secili prej tyre, dhe ne jemi pjesë e Evropës. Por, ajo që ne e kemi si projekt, flas njerëzit që janë në politikë aktive, Kosova është e bollshme për njerëzit e saj, sepse njerëzit e saj punojnë si duhet, ka pasuri minerare të jashtëzakonshme, ka një shtresë të qytetarëve të shkolluar, ka tokë të mrekullueshme që rrallë kush mund ta ketë për këtë popullsi që ka, dhe s'kemi nevojë me ble specia në Shkup, apo me marrë nga Turqia apo Greqia, por të punojmë tokën tonë dhe të nxjerrim bukën tonë me djersën tonë bashkë. Pasuritë minerale janë nganjëherë ndoshta edhe sherri kryesor apo shkaku kryesor i konflikteve që kemi pasur me të tjerët.

I nderuari president, a mendoni që pos gjuhës e gjakut tonë, edhe Islami, si fe e shumicës së shqiptarëve kishte rol preventiv për të pamundësuar asimilimin tonë, apo për të penguar krijimin e ndonjë lloji simbioze qytetrimore të përbashkët me Serbinë okupuese brenda këtij nënqielli?

Jo, unë them Islami ka pasur liderë të mirë, sikurse edhe besimi krishterë njësoj te shqiptarët. Tash nuk mund të bëjë një krahasim, sikur edhe më herët që thashë, që detyrë parësore islame të jetë kjo, ajo që thjesht lidhet me kontributin e tij shpirtëror dhe mendoj se është bërë drejt. Ka pasur njerëz që janë shquar në procese të lirisë kombëtare, absolutisht në faza të hershme, por edhe më vonë. Keni parasysh ta zënë edhe ato masakrat e mëdha që kanë bërë dhe kundërshtimi i tyre, sidomos në 1944-1945, edhe në fazën e mëvonshme, dhe paralelisht kësaj mund të them se porosia e mirë e njerëzve të besimit që kanë pozicione të rëndësishme është që identiteti ynë në kuptimin etnik të jetë i ndihmuar, i mbështetur edhe nga liria e plotë e besimit, absolutisht se është një apo tjetër shërbim kombëtar, që janë në shërbim të së ardhmes së përbashkët. Ka nganjëherë përpjekje që të na marrin dhe të na hedhin te pjesët, ato që ndodhën disa raste në fazën e para shtatë-tetë vjetëve, por për ne është me rëndësi ajo pjesë e bindjes së plotë, se problemet e vendit, Kosova duhet t'i zgjidh vetë. Duhet t'i zgjidh me njerëzit e saj, me kulturën e saj, me atë që e ka taban të përhershëm, natyrisht, në vështirësi të rolit të shtetit. Shteti i Kosovës është shtet sekular, dhe natyrisht se çmon dhe mbron të quajmë ato vlera, dhe si i tillë duhet të jetë i përfshirë thjesht edhe në proceset e bashkëpunimit edhe me institucionet e kultit, në mënyrë që ato në rolin e vet të ndihmojnë aq sa është e mundshme nga kuadri që kanë.

Gjatë periudhës sa keni qenë në detyra qendrore udhëheqëse, a keni vërejtur ndonjë tentativë që të trazohen ujërat e qeta të kohezionit tonë fetar në Kosovë, apo për të minuar kështu arrijtet tona shtetformuese, dhe cila do të duhej të ishte përgjigjja e duhur prej organeve tona dhe e popullit tonë ndaj tyre?

Mund të ketë individë nga mjediset tona që nuk ia qëllojnë nganjëherë, edhe që kanë deklarata të pamatura, mbase edhe te misionet. E dyta, mund të ketë të tjerë jashtë nesh që të dëshirojnë të mbajnë, të krijojnë çarje apo pyka, të jenë në unitetin nacional që kemi si popull. Andaj, për ne është e rëndësishme që vërtet të përcillet ajo që ka qenë pjesë e vlerës dhe traditës së gjeneratave të shumta që kanë kapërcyer, pavarësisht po them besimit. Natyrisht që ka përgjegjësi komuniteti islam në Kosovë, që është me shumicë në proporcion, thjesht them edhe me prezencë, të luaj rolin e vet, sikur edhe besimet e tjera që janë, në këtë rast të krishterët në Kosovës. Kjo do të krijojte atë që do të ishte përgjigjja më e mirë e gjithë atyre që dëshirojnë vërtet të na identifikojnë në diçka tjetër dhe të në qesin jashtë binarëve të normalitetit tonë.

Tani kur kaluan një çerekshkulli që nga çlirimi i vendit dhe 16 vjet nga shpallja e pavarësisë së Kosovës, a kemi arritur njëmendë ta flakim aspiratën ogurzezë të armiqve tanë, se Kosova s'bëhet dot shtet, madje edhe nëse është bërë nuk mbahet dot në këmbët e veta?

Ashtu kanë dëshiruar, ashtu dëshirojnë, natyrisht. Por, unë them se është arritur kryesorja. Kryesorja është se ekziston një qëndrueshmëri ekonomike në radhë të parë, me gjithë krejt ato që ne i kemi pasur të shkatërruara kapacitetet ekonomike të vendit, është një ringjallje, flas e përgjithshme, e qytetarëve të vendit, që me djersë ta sigurojnë, mund të ketë edhe qasje që janë anashkaluese, që nuk janë fort të shijshme, do të thonë nganjëherë deliktet ekonomike dhe format e korrupsionet dhe format e tjera, dhe e dyta është stabiliteti, pavarësisht garën që mund të reflektojë si e ashpër mes subjekteve politike. Një stabilitet i përgjithshëm politik është përgjigja për të gjithë ata që se duan Kosovën në kohë.

Nga leximet tuaja të gjera në fushën e jurisprudencës dhe shkencave të tjera humane, çfarë mendoni se ofron sot jurisprudenca islame për shoqëritë bashkëkohore, dhe cili mund të jetë përgjithësisht ndikimi i besimit në Zot në jetën e njeriut bashkëkohor!

Këtu janë dy-tri çështje që janë tema tepër të rëndësishme që të trajtohen më thellë, flas në ecjen tonë. E para është ajo pjesa e një tradite të besimit dhe të normave që kanë ekzistuar, siç quhet ajo e drejta e sheriatit apo e drejta kanonike. E dyta është e drejta zakonore, që është po ashtu një element paralel, që në njëfarë forme është në ndërdijen e qytetarëve të vendit. Unë them se çështja e besimit është diçka tjetër, çështja e normave që janë të karakterit juridik dhe që interferojnë në sistemet juridike apo në sistemin e drejtësisë së një vendi. Mendoj se shteti duhet ta bëjë, është esenciale, shteti duhet ta bëjë atë pjesën e garantimit prej të drejtave dhe lirive njerëzore fetare, racore dhe të gjitha atyre tjerave dhe ecjes më shpejt në standardet ndërkombëtare. Natyrisht, shteti duhet të jetë i kujdesshëm edhe për miratimin e ligjeve, të cilat janë të kapshme për mentalitetin tonë, por natyrisht edhe duke pasur parasysh edhe atë përputhjen me standardet evropiane, të cilave ju kemi zotuar, se do t'i respektojmë, edhe këto që kanë të bëjnë përgjithësisht me të drejtat e liritë njerëzore e kartat e Kombeve të Bashkuara, mbi të drejtat e njerëzve, që është esenciale.

Cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e revistës "Dituria Islame", dhe për bashkëkombësit tonë në përgjithësi?

Unë mendoj se janë faktorë të rëndësishëm që janë pjesë e ecjes dhe zhvillimeve historike të Kosovës për të mirën e saj, për të mirën e qytetarëve, për të mirën e brezave që vijnë. Kemi shumë punë dhe shumë përgjegjësi të gjithë së bashku, që të jetë një amanet i përçarur dhe i realizuar mirë i shumë gjeneratave që janë sakrifikuar për vendin.

Shumë faleminderit!

Intervistoi: Mr. Driton Arifi
Kryeredaktor i "Diturisë Islame"

Migrimi nga persekutimi dhe varfëria

Daut Dauti

Historia shënon se që kur është krijuar njeriu dhe më vonë grupet e njerëzve, ka ekzistuar lëvizja nga një vend në tjetrin gjatë tërë kohës. Ndërrimi i vendbanimeve, edhe pse në pamje të parë duket si diçka negative, ka ndikuar edhe pozitivisht në zhvillimin e njeriut dhe shoqërisë. Ndërrimi i vendbanimeve rëndom është bërë për dy arsye: ikja nga persekutimi dhe për shkaqe ekonomike.

Ikja e parë e rëndësishme grupeve nga persekutimi religjioz është rasti i migrimit të parë të myslimanëve, të cilët, në vitin 615, u detyruan ta lëshonin Arabinë e të shkonin në Abisini apo në Etiopinë e sotme. Ky grup i myslimanëve që besohet se përbehej nga 12 veta, përfshirë motrën dhe dhëndrin i profetit Muhamed, kërkuar dhe gjetën strehim në mbretërinë e krishterë të Abisinisë – Aksumit.

Por, është një ikje tjetër që ndikoi në ndryshimin e gjendjes ekzistuese në botë dhe që paralajmëroi ndërrime të mëdha të njerëzimit. Fjala është për Hixhretin (arratisjen) e Profetit Muhamed me përcjellësit e tij nga Meka në Medine, që ndodhi në vitin 622. Ky vit u bë aq i rëndësishëm, sa që e ndryshoi edhe kalendarin dhe myslimanët filluan ta numëronin kohën sipas mënyrës së tyre, që erdhi si rezultat i Hixhretit. Pra, viti 622, u bë viti 1 i myslimanëve. Ishte edhe vit që simbolizonte nisje të re për gjithçka.

Hixhreti ka shënuar edhe ndryshim në mentalitetin dhe praktikën e jetës së njerëzve që zbatohesh asokohe. Në shoqëritë antike të Egjiptit, Greqisë dhe Romës, tortura ka qenë e pranueshme si pjesë e sistemit ligjor. Deri në vitin 622, apo

deri në vitin 1, njerëzit kryesisht kanë qenë të bindur se persekutimi që ushtrojnë pushtetet janë të 'arsyeshme' të 'ligjshme', dhe që duhen të durohen. Ishte kështu për shkak se konsiderohej se pushteti është i shenjtë dhe i pagabueshëm. Myslimanët e parë në krye me Profetin Muhamed e sfiduan këtë realitet dhe e ndryshuan mentalitetin duke bërë me dije se persekutimi nuk duhet të durohet dhe në raste të fundit duhet larguar nga vendi. Por, në vendin e migrimit duhet punuar dhe përgatitur për t'u kthyer sërish aty nga ke ikur, siç ndodhi me Hixhretin apo me rastin e Profetit Muhamed, kur në mënyrë triumfuese u kthye në Mekë me pasuesit e tij myslimanë. Pra, këtu shembulli që ofrohet për myslimanët dhe të tjerët është se ikja nga vendi nuk duhet të jetë e përhershme. Përkundrazi, duhet kthyer në vend të origjinës për ta luftuar të keqen dhe padrejtësinë dhe për të rikthyer frymën e respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe të drejtën për ushtrim të lirë të besimit. Pra, njeriu duhet të kërkojë mundësi për kthim e jo heqje dorë nga vendlindja. Kjo është praktika islame që është themeluar me këtë rast.

Për fat të keq, persekutimet dhe ikjet apo migrimet e njerëzve, nuk janë ndalur asnjëherë për shkak se nuk janë eliminuar shkaqet që mundësojnë lindjen dhe zhvillimin e kësaj dukurie negative. Madje, persekutimet dhe ikjet kanë vazhduar të shtohen nga mesjeta e deri në ditët e sotme dhe ka pak shpresë se do të ndalen gjatë një të ardhme të afërt.

Shqiptarët janë larguar me shekuj nga vendlindja e tyre për dy arsye që u përmendën më lart. Një numër jo i vogël i tyre, rasti i arbëreshëve, kanë ikur në Itali, por para ardhjes së otomanëve. Ndoshta, kjo ka ndodhur për shkak të frikës se do të persekutoheshin si të krishterë nga sundimi mysliman. Edhe pse ka ekzistuar frika, megjithatë, nuk ka pasur raste të ikjeve masive për shkak të persekutimit pas vendosjes së pushtetit otoman në trevat shqiptare. Rast i ngjashëm ka ndodhur me myslimanët e Bosnjës, kur ky vend ra nën sundimin austro-hungarez. Me këtë rast një numër i konsiderueshëm i myslimanëve nga Bosnja kanë migruar në Kosovë, Shqipëri dhe në territoret e tjera otomane në drejtim të Stambollit. As për këtë kategori nuk bëhet fjalë për persekutim. Këta njerëz, myslimanë në këtë rast, nuk kanë dashur të jetojnë nën sundim të pushtetit të krishterë. Në aspektin islamik, kjo ikje nuk duket të ketë qenë e pranueshme kur dihet që rregullat islamike e lejojnë myslimanin të jetojë



nën sundim të krishterë nëse nuk persekutohet. Madje, e obligojnë që t'i respektojë ligjet e shtetit ku jeton edhe nëse ato nuk janë islamike.

Sidoqoftë, pas vitit 1878, ka pasur ikje masive të shqiptarëve nga Serbia dhe Mali i Zi, dy vende që u pavarësuan në Kongresin e Berlinit (1878), dhe të cilat ushtruan dhunë të egër ndaj shqiptarëve me qëllim të përzënies nga trevat e tyre. Numri i të dëbuarve, siç e dimë, ka qenë i madh dhe me pasoja të rënda që nuk janë eliminuar deri sot. Kjo situatë e rëndë është përsëritur edhe gjatë Luftërave Ballkanike (1912-13) me pasoja edhe më të rënda e deri në suazat e gjenocidit. Këto përzënie masive të shqiptarëve nga Greqia dhe Serbia janë të ngjashme me ato të palestinezëve, që kanë ndodhur pas vitit 1948, kur u formua shteti i Izraelit e deri sot. Mediat dhe diplomatët i kanë raportuar në hollësi, por shtetet nuk kanë ndërmarrë ndonjë masë për t'i penguar apo parandaluar. Kanë qenë spastrime etnike që janë heshtur nga qendrat e fuqishme. Pastaj, përzënia e shqiptarëve nga Serbia dhe Greqia ka vazhduar edhe mes dy luftërave botërore dhe më pas. Këto kanë qenë lëvizje të dhunshme dhe si rezultat i persekutimeve të egra, kurse kthimi nuk ka ndodhur asnjëherë. Ikja e shqiptarëve nga persekutimi ka vazhduar deri më 1999.

Gjatë mesjetës e deri sot, shqiptarët kanë migruar edhe për arsye ekonomike apo për shkak të varfërisë. Janë punësuar në profesione të ndryshme, që nga niveli më i ulët e deri te pozita me e lartë, ajo e kryevezirrit (kryeministrit) në Perandorinë Otomane. Kjo ka qenë kasta e njerëzve që nuk e kanë pasur lehtë. Por, këta njerëz e kanë mbajtur ekonominë familjare dhe atë të trevave të veta. Kryesisht, këta kanë qenë njerëz që janë kthyer në vendet e tyre të lindjes. Është njësoj sikur sot që ende ndodhë me shqiptarët e Kosovës që filluan të shkonin për punësim në vendet Perëndimore pas viteve të 60-ta të shekullit të kaluar dhe ata të Shqipërisë pas viteve të 90-ta. Këta janë pjesë e shoqërisë shqiptare që më së shumti kanë kontribuar në zhvillimin e vendit.

Për fat të keq, migrimet e shqiptarëve të Kosovës, por edhe të Shqipërisë për shkak të varfërisë janë shtuar gjatë dy dekadave të fundit. Kjo gjë konsiderohet brengosëse, sidomos për Kosovën për arsye se pritjet për zhvillim ekonomik kanë qenë të mëdha. Në rastin e Kosovës, kur nuk pati mundësi të ringjallëshin as ato pak fabrika që ekzistonin para çlirimit, dhe kur nuk u krijuan as kushtet për investime të jashtme, ikja nga vendi bëhet si mënyrë e vetme për ta përballuar gjendjen e rëndë ekonomike. Ikja stimulohet edhe nga disa

Në vendin e migrimit duhet punuar dhe përgatitur për t'u kthyer sërish aty nga ke ikur, siç ndodhi me Hixhretin apo me rastin e Profetit Muhamed, a.s.

faktorë të tjerë që janë të natyrës sociale, e që vijnë nga dështimi i qeverive në aplikimin e programeve që do ta përmirësonin gjendjen. Njerëzit largohen nga Kosova, sidomos tashti pas liberalizimit të sistemit të vizave, edhe për shkak se në një shoqëri të këtillë niveli arsimor është joadekuat sikur edhe ai shëndetësor. Prandaj, njerëzit dëshirojnë të jetojnë në një shoqëri perëndimore ku niveli i sigurtisë së jetës dhe kushtet për përparim të pasardhësve janë më të lehta.

Për arsyet e përmendura më lart, largimet e popullsisë nga Kosova pas çlirimit, pra pas vitit 1999, janë alarmuese. Nga viti 1999 e deri më sot konsiderohet se janë larguar diku rreth 400.000 njerëz. Sikur Kosova ta kishte nivelin e shtimit të popullsisë, siç e kishte para disa dekadave, ta zëmë deri në vitin 1990, largimi nuk do të paraqiste ndonjë problem serioz. Por, Kosova, sipas regjistrimit të vitit 2011, ka diku rreth 1.7 milionë banorë, kurse në vitin 1981 kishte 1.6 milionë banorë. Pra, pas tri dekadave shtimi është pothuaj simbolik. Kjo nuk është vetëm për shkak të rritjes së numrit të njerëzve që e lëshojnë vendin, por edhe për

shkak të rënies së shtimit të popullsisë, e cila jo moti ishte 26 promilë, kurse sot konsiderohet se ka rënë nën 10 promilë. Pra, Kosova tashti ballafaqohet me problemin e plakjes së popullsisë, e cila gjë e vështirëson zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror për shkak se fondet orientohen nga pjesa pasive e shoqërisë. Prandaj, në këto raste kërkohet intervenimi i qeverisë me programe të veçanta në mënyrë që të parandalohet ky problem.

Kthimi i popullsisë njëherë nuk është në rend dite për shkak se është duke ndodhur e kundërta. Nga praktika e vendeve të tjera, mësojmë se kthimi është i mundshëm. Ta zëmë, deri ne fillim të viteve të 90-ta, të shekullit të kaluar, në Zvicër, Gjermani, Francë dhe Britani të Madhe, kishte numër të konsiderueshëm të punëtorëve nga Spanja, Italia dhe Greqia. Por, këto vende shënuan zhvillim ekonomik dhe kjo ishte arsyeja që këta punëtorë u kthyen me të madhe. Ky është një shembull nga i cili duhet të mësojë Kosova.

Në anën tjetër, me një numër të atyre që janë larguar nga Kosova, me kalimin e kohës do të ndodhë që të mos kthehen kurrë, siç ka ndodhur me të tjerët. Por, të larguarit duhet ta kenë parasysh se e kanë për obligim kthimin duke e luftuar varfërinë. Pra, duhet ta kemi parasysh shembullin e hixhret, ku kthimi triumfal është i obligueshëm, si për shkak të luftimit ndaj persekutimit, ashtu edhe ndaj varfërisë.

Feja apo kombi – absurdi i manipulimit të panevojshëm

Hajrudin S. Muja

Ndonëse kombet lindën dhe u zhvilluan gradualisht në shekujt XVIII - XIX, si një pseudo-religjion, të cilin Perëndimi e krijoi me qëllim të plotësimit të vakumit ideologjik, paralelisht lindën edhe mitet e një të kaluarë “të largët” kombëtare, si burim kritik i problemeve të sotme. Studiuesit e kësaj fushe pohojnë se në fillet e krijimit “kombëtar”, ishte patjetër i nevojshëm miti i “armikut të përbashkët”, që për popullatën ballkanase të atij shekulli, ishin osmanët. Kjo ishte një lojë e Fuqive të Mëdha, që kombësitë i përdorte si vegla oportunitizmi për fitimin e lojës kundrejt njëra-tjetrës.

Historiografia shqiptare e periudhës pas-osmane i mori si “copy-paste” historiografitë e komb-shteteve fqinje, duke luftuar për “emancipimin kombëtar” dhe “konsolidimin e kombit” të saj, duke e përshkruar periudhën osmane si një “shtypje” rrënjësisht të huaj me perceptimin e “prapambetjes” dhe “uzurpimit”.¹ Ajo shërbehet po me ato “kujtime”

për të mbështetur një argument të tillë.² Në shkollat tona jemi mësuar për këtë pushtues të huaj që pengoi emancipimin dhe përparimin tonë. Por, shqiptarët, duke qenë me shumicë myslimane, pronarë të pasur që garonin për pozita të larta dhe karriera të suksesshme qeveritare dhe ushtarake,³ u ndjenë më të rrezikuar nga nacionalizmat fashizoide të fqinjëve, prandaj qenë më të vonshëm në këtë drejtim. Vetëm kur e kuptuan që perandoria ishte në prag të zhbërjes, ata filluan të braktisnin këto struktura, për t'u bashkuar me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare⁴ dhe për të kursyer atë që mund të kursehej.

Çështje e vërteta, në kohën e Naum Veqilharxhit (1797-1846), që shpesh konsiderohet si pararendës dhe ideolog i parë i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, identiteti fetar ishte ende me ndikim te shqiptarët dhe vendosja e identitetit kombëtar mbi atë fetar, do të ishte çështja kryesore për nacionalistët shqiptarë, gjatë gjithë shekullit XIX. Gjatë një periudhe

Gjatë një periudhe të gjatë, të qenët shqiptar apo arnaut, ishte njëkohësisht edhe të qenët mysliman, sepse shqiptarët, në shumicë e konsideronin veten si pjesë e ymetit islam.



të gjatë, të qenët shqiptar apo arnaut, ishte njëkohësisht edhe të qenët mysliman, sepse shqiptarët, në shumicë e konsideronin veten si pjesë e ymetit islam. Një elitë e konsiderueshme intelektuale, edhe sot mbron tezën, se islamizimi i shqiptarëve (pra fetarja e tyre), dalloi etnicitetin shqiptar nga ai i serbëve dhe grekëve, duke shpëtuar kështu “identitetin kombëtar”. Islami u shërbeu atyre si urë lidhëse midis dy pjesëve të të njëjtës etni, që të mos përfundonin në dy kombësi e dy kombe të ndryshme armiqësore, sikurse kanë përfunduar p.sh. kroatët katolikë me serbët ortodoksë; polakët katolikë dhe rusët ortodoksë dhe irlandezët katolikë me irlandezët protestantë, etj..⁵

Ishte një kohë që nacionalizmi dhe ideologjia nacionaliste laike depërtuan në Evropën Juglindore nga Evropa Perëndimore dhe Qendrore, kur hasi në një lidhje të pandashme midis fesë dhe identitetit. Kjo ishte një trashëgimi e sistemit të miletit “të lëshuar në një ndërthurje të nacionalizmit dhe fesë”.⁶ Përvoja historike e këtij sistemi tregon se ka ndihmuar në krijimin e një identiteti të ri integruar edhe gjatë formimit të nacionalizmit të ri, veçanërisht midis popujve myslimanë. Ky zhvillim kontradiktorë ka qenë rezultat i historisë së përbashkët në të gjitha fazat e ngjarjes.⁷ Për më tepër, marrëdhënia ndërmjet identitetit shqiptar dhe kulturës islame është e veçantë, pasi burimorja e fjalës “komb”, origjinon nga fjala arabe “kaum”, e ardhur te shqiptarët përmes osmanishtes, ku feja merrte përparësi kundrejt kulturës, gjuhës dhe racës, në përcaktimin e identitetit.⁸ Për këtë arsye Hafëz Ali Korça shpjegoi lidhjen e fesë me kombin në vargjet e tij:

“Nasionalist jam, por fetar si duhet,

Le të thonë bota ashtu si t’u thuhet,

Nasionalisti përse turp të ketë

Tek të thotë ‘e dua me shpirt’ fenë vetë?’⁹

Personalitetet më të shquara të Lëvizjeje Kombëtare, si Pashko Vasa (1825-1892), Ymer Prizreni (1820-1887), Abdyl Frashëri (1839-1892), Sami Frashëri (1850-1904), Zija Prishtina, Hasan Tahsini (1811-1881), Jani Vreto (1822-1900), Ahmet Koronica, Koto Hoxhi (1824-1895), etj., u mblodhën në Stamboll në dhjetor të 1877, duke qenë përfaqësues të gjithë trojeve shqiptare me besime të ndryshme fetare. Vargu lapidar i Pashko Vasës: “Feja e shqyptarit asht shqyptaria”, nuk ishte tjetër veç shprehje e idesë së harmonisë ndërfaqetare midis shqiptarëve, duke u bërë moto e gjithë Lëvizjes.¹⁰ Ishte koha kur serbët donin sllavizimin e

**Vargu lapidar i
Pashko Vasës:
“Feja e
shqyptarit asht
shqyptaria”,
nuk ishte tjetër
veç shprehje e
idesë së
harmonisë
ndërfaqetare
midis
shqiptarëve,
duke u bërë
moto e gjithë
Lëvizjes.**

shqiptarëve dhe kur Evropa i trajtonte si një koncept klanesh dhe familjesh të ndara në bazë të besimit të tyre fetar.¹¹

Sot çuditërisht, shumë njerëz kanë rezerva të pa arsyeshme në çështjen e përkufizimit të fesë dhe të kombit, dy nocione shoqërore, jo rrallë të ngatërruar aq tepër, sa t’i jepen kuptime kundërshtuese ndërmjet njëra-tjetrës, duke krijuar kështu një absurd të panevojshëm dhe një betejë në mes dy gjërave që nuk ndeshen fare. Në shumicën e rasteve, “kombëtarët” mbajnë pretendimin e gabueshëm të përvetësuar nga ideologjia kolonialiste dhe komuniste se “feja na lë të prapambetur”, pa aftësi të mjaftueshme për të kuptuar se problemi mund të paraqitet vetëm te mënyra e aplikimit dhe se siguria e kombit është në fe me mundësi të përshtatjes së çdo vendi e kohe, ndërsa siguria e fesë është te Zoti.

Trajtimi i raportit ndërmjet kombit dhe fesë, nuk mund të bëhet pa një njohje të raporteve të tyre, që nga koha kur lind kombi. Dihet se para shekullit XIX, faktori më i rëndësishëm identifikues dhe bashkues ishte besimi fetar. Feja nuk mund të shpjegohet nga pikëpamja e kombëtares. Thirrjet për rehabilitimin e fetares në këndvështrimin e kombëtares janë të dështuara në atë masë sa janë të dështuara edhe thirrjet e kërcënimit për ndërrimin e fesë apo largimin e Islamit nga trojet shqiptare. Sot më shumë se kurrë më parë, duhet të vlerësohet nevoja e fetares dhe e kombëtares. Përsosmëria fetare e bën një komb të vlefshëm, të nderuar e të respektuar para Zotit dhe para kombeve të tjera.

Sipas teorisë së Ernest Renanit, parimi i kombësive është një përfundim i një të kaluarë të gjatë përpjekjesh, teorish e dashurish, me lavde të përbashkëta, me të kaluar të përbashkët e me të ardhme të përbashkët.¹² Fjalori i sotëm i gjuhës shqipe e shpjegon si: “një bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në bazë të bashkësisë së gjuhës, territorit, jetës ekonomike dhe formimit psikik, që shfaqet në bashkësinë e kulturës”, ndërkohë që Louis P. Pojman i ka dhënë një përkufizim gjithëpërfshirës, sipas të cilit kombi është: “një grup njerëzish, të cilët janë të lidhur së toku përmes burimesh të përbashkëta të kuptimit dhe identitetit, përmes ngjashmërisë etnike, përmes gjuhës, letërsisë, historisë, mitit, fesë dhe elementesh të tjera kulturore”.¹³

Ne mund të pajtohemi ose të mos pajtohemi me përkufizime të këtilla, por duhet të kemi parasysh se kufijtë e shumë vendeve të paraqitura përmes vijave artificiale të demarkacionit, kanë bërë që njerëzit të tregojnë dashuri ndaj këtyre vijave të shtrembëta, të cilat fuqitë kolonizuese i kanë



tërhequr nëpër hartat e botës, duke bërë që këtë dashuri ta shndërrojnë në ideologji. Kështu njerëzit filluan ta konsiderojnë veten se i përkasin këtij vendi, duke i trajtuar si të huaj të gjithë ata që mbetën jashtë këtyre vijave. Gjuha dhe historia e përbashkët nuk janë të mjaftueshme për të ndezur zjarrin e vetëdijes kombëtare, sepse amerikanët kanë gjuhë dhe histori të përbashkët me anglezët, por u veçuan dhe u bënë “komb” i pavarur. Zvicra me ndjenja të forta kombëtare ka tre rajone dhe tri gjuhë të ndryshme. Në Indi fliten më shumë se 14 gjuhë, por anglishtja është e vetmja që kuptohet nga të gjithë, megjithëse nuk është gjuhë kombëtare. Banorët e Spanjës dhe të Amerikës Jugore flasin të njëjtën gjuhë, por nuk janë një komb. Të krishterët manoritë dhe myslimanët e Libanit flasin të njëjtën gjuhë, por luftojnë njëri-tjetrin. Dy komunitetet e krishtera të Irlandës së Veriut me gjuhë të përbashkët, luftuan njëri-tjetrin për 30 vjet.¹⁴ Megjithatë, baza e identitetit shqiptar, është kryesisht gjuha, e vetmja që bashkon të gjithë shqiptarët në një bazament mbi të cilën ata japin shembullin e bashkëjetesës me edukime të ndryshme fetare.

Ndryshe nga kombi, feja është një program i Krijuesit, që u mëson krijesave bazat e besimit dhe mënyrën e jetësimit të atij besimi, duke rregulluar raportet e njeriut me Krijuesin, me veten, me familjen, me shoqërinë dhe me kombin e tij. Në përkufizim, feja është: “Marrëdhënia e qenieve njerëzore me Zotin, ose çështje individuale ndërmjet njeriut dhe Zotit.”¹⁵ Ajo duhet t’u japë përgjigje pyetjeve themelore që kanë të bëjnë thellësisht me gjendjen e njeriut nëpërmjet marrëdhënies me të shenjtën, me të mbinatyrshmen apo

nëpërmjet perceptimit të natyrës së vërtetë të realitetit. Në kuptimin e zakonshëm, feja shfaqet përmes besimit, ritualizimit dhe përvojës religjioze, që të gjitha këto përbëjnë ushqimin e tij shpirtëror, duke mbështetur fuqishëm moralitetin dhe drejtësinë sociale.¹⁶

Në trajtën e vet të përkryer, feja është faktori më dominues në historinë njerëzore që paraqet të vërtetën, në harmoni të plotë me nevojat e shpirtit të njeriut dhe prirjeve të tij, prijës i veprimeve në jetën e përditshme, mbrojtës i lumturisë, ngushëllim në periudha mjerimi, ndihmë në çaste vuajtjesh dhe strehë e sigurt kundër kobëve e rreziqeve. Njëri nga krerët politik të shtetit, në prag të pavarësisë së Shqipërisë, për fenë thoshte se po të kuptohet mirë: “ka për qëllim zbutjen e egërsirës që quhet njeri, jo për ta egërsuar më zi se bishën, ka për qëllim për t’i shtënë në zemër dashurinë e jo mëninë. Nuk është feja shkaku i grindjes së njerëzve mes vetes. Kemi luftuem e vramë qysh prej Kabelit e Habelit, e do të vazhdojmë në atë rrugë deri në amshim edhe ndërmjet gjindësh të një feje, të një race e të një gjaku. Shkaku i vërtetë është egozmi që ka lindë bashkë me njeriun. Të gjitha të tjerat s’janë veç emra të gënjeshtar e gënjeshtar të këtij mëkati origjinal.”¹⁷

Sot, shumica e shqiptarëve anashkalojnë kohën, duke diskutuar nëse është feja më e rëndësishme apo kombi?! Një pyetje e tillë, është shtruar në kohë të ndryshme edhe te popujt e tjerë. Një filozof i njohur, i ka hequr pyetjes kuptimësinë, duke e radhitur në pyetje absurde e të pakuptimë. Ai e ka krahasuar me zemrën dhe mëlçinë, ose trupin dhe kokën (e njeriut), kur dihet se trupi nuk jeton në

mungesën e cilësdo prej tyre dhe asnjëra nuk mund të zëvendësojë tjetrën.

Pra, feja dhe kombi janë dy çështje të ndara në përmbajtje, nuk kanë tipare të njëjta, por janë pa kundërshti në mes vete, janë dy anë të pandashme të fletës së një libri. Çdo njeri që adhuron Krijuesin e Tij, pavarësisht cilit drejtim religjioz i takon – ka fe dhe çdo njeri që ka gjuhën, traditën dhe atdheun – ka komb. Në këtë vështrim janë komplementare që nuk bëjnë njëra pa tjetrën, por ndërsa feja është pjesë më e hershme e identitetit njerëzor, që për objekt ka kultin, adhurimin, Hyjin, botën tjetër dhe shpëtimin e shpirtit, kombi ka atdheun, etninë, gjuhën, historinë, kulturën. Feja nuk është e kufizuar në hapësirë dhe në kohë dhe përmban përgjithësisht botëkuptime të pandryshueshme për botën, jetën dhe njeriun, ndërsa kombi është kufizuar në hapësirë madje edhe në kohë.¹⁸

Kombin të cilit i përkasim dhe e trashëgojmë nuk e kemi përcaktuar ne, ka qenë vullneti i Zotit të lindemi të tillë, ndërkohë që fenë mund ta zgjedhim dhe ta ndryshojmë sa herë të duam, pa i bërë dëm askujt përveç vetes. Këtë e vendosim pasi të kemi hulumtuar dhe të kemi zgjedhur rrugën përmes të cilës do t'i kthehemi Krijuesit, për të dhënë llogaritë e veprimeve tona. Këtu fetarja është më e madhe se kombëtarja, sepse është alternativa ndërmjet ferrit dhe parajsës. Brenda kësaj llogarie nuk ka përparësi kombëtarja – ka vetëm mirëbërësia, që në këtë kontekst fetarja të nxitë të bëhesh kombëtar i mirë.

Për më tepër, feja si mësim mbi të vërtetën dhe vetë e vërteta, janë sinonim i së mirës dhe së drejtës. Të jesh besimtar, do të thotë të përmbash në vete të gjitha virtytet njerëzore, nga të cilat kanë dobi të gjithë, edhe kombi, gjë që nuk mund të thuhet për kombin, sepse pjesëtari i një kombi është i ndershmë dhe i pandershmë, i miri dhe i keqi, intelektual dhe injorant, hajni dhe mirëbërës, patrioti dhe tradhtari. Një thënie apo një vepër, edhe pse e shkruar me shkronja e fjalë shqipe, duhet të vlerësohet nga përmbajtja e saj, sepse fjalia, edhe shqip e shkruar, mund të shprehë një fyerje apo një të pavërtetë dhe mund të lëndojë një shpirt.¹⁹ Fetarja është ushqim shpirtërorë që nuk e servon kombëtarja. Kjo e fundit ndahet në “e imja” dhe “e jotja” që sjellin plasaritje, dhunë dhe luftëra ndërmjet popujve. Ndryshe, historia e popujve (kombeve) të zhdukur dhe të gjuhëve të zhdukura, na kujton se “asimilimi fetarë garanton asimilimin kombëtarë”.

Shqiptarët historikisht nuk janë përfshirë në konflikte fetare ndërmjet tyre. Janë armiqtë e tyre që vazhdimisht janë përpjekur për të futur përçarje në emrin e “kombëtares” dhe “fetares” për qëllime të caktuara, që nuk kanë asgjë të përbashkët as me “kombëtares” as me “fetares”. Ata i kanë gjetur “piunët” e tyre, i kanë vendosur në universitetet tona dhe në panelet televizive, të cilët përpiqen të më bindin se si

myslimanë nuk mund të jem edhe “kombëtarë”, duke më lënë “në dyshim” për konceptimin e krishterë të kombit. Sipas mendësisë së tyre “kombi” i të krishterëve nuk është njëjtë me “kombin” e myslimanëve. Kështu formësojnë modelin sllav të krijimit të kombeve, ku feja është faktori kryesor i ndarjes.

Pyetja se a është më e rëndësishme (ose e para) kombi apo feja, është absurdi i manipulimit të panevojshëm, që vjen vazhdimisht nga shtresat “intelektuale” dhe “politike”, me nuanca të tjetërsimit fetarë të kombit. Edhe pse përpiqen të fshihen pas një “patriotizmi” të tepruar, veprimi i tyre është tërësisht antikombëtar, një përpjekje sado “modeste” për të na nxjerrë para botës të ndarë e të përçarë, duke mbjellë trazira në mesin e vetë shqiptarëve. Për të tillët, Salih Gjok Dugagjini, më 1911 vjershëronte:

*“Çili kriht e bana hije,
memrrmi zojt ushqej me dije,
sod shumë korba thonë jem shqype,
si duron e kryet s’jau shtype”.*²⁰

- 1 Stefanaq Pollo & Arben Puto: “Historia e Shqipërisë - Nga origjina e tij deri në ditët e sotme”, Tiranë, 1981.
- 2 Thucydides: “History of Poloponnesian War”, Cmbridge University Press, 2010, f.156.
- 3 Misha Glenny: “The Balkans 1804-1999 – Nationalism, War, and the Great Powers 1804-1999”, New York 2012, f.22-26.
- 4 Alicia Strong: “Sorta, Kinda Muslim - The Impact of Western Hegemony on Muslim Identity Negotiation in Kosovo”, Middletown – Connecticut, 2018, f. 23.
- 5 Rimëkëmbja Kombëtare, 9 maj 2001.
- 6 Simeon Evstatiev: “Milletic Secularism in the Balkans – Christianity, Islam, and Identity in Bulgaria”, Nationalities Papers, 47(1)/2019, f.91.
- 7 Ilber Ortajllë: “Familja në shoqërinë osmane”, Shkup 2014, f.33.
- 8 Misha Glenny: “The Balkans...”, po aty, f.71.
- 9 Zani i Naltë, 4, Kallnuer 1923, f.105.
- 10 Kasem Biçoku: “Dëmtimi i muzeut historik kombëtar prej abuzuesve”, Shkup, 2022.
- 11 Ismail Hasani: “Vetëdija fetare dhe kombëtare tek shqiptarët”, Prishtinë, 2001.
- 12 Francis X. Blouin, Jr & William G. Rosenberg: “Archives, Documentation, and Institutions of Social Memory – Essays from the Sawyer Seminar”, University of Michigan, 2007.
- 13 Louis P. Pojman: “Global Political Philosophy”, McGraw Hill 2003, f.2.
- 14 Gazeta Sot, 28 prill 2009.
- 15 A. Helwa: “Secrets of Divine Love”, Naulit Publishing House, 2020.
- 16 John Esposito: “Islam – The Straight Path”, Oxford University Press, 2016.
- 17 Mustafa Kruja: “Antologji Historike” Elbasan, 2001, f.303.
- 18 Gazeta Sot, 4 qershor 2010.
- 19 Avdi Berisha: “Shatzënia e një mashtrimi”, Prishtinë, 1995.
- 20 Sipas Muhamet Pirraku: “Jo Katedrale, në emrin e shqiptarisë së imagjinuar”, Prishtinë, 2003, f.123.

“Prerja e artë” – masa hyjnore e bukurisë dhe e harmonisë

Mimoza Sinani

Të gjitha qeniet e gjalla, duke filluar nga qelizat e deri te shumëqelizorët rriten dhe zhvillohen.

Ritmi i rritjes ndjek ligjësinë e disa numrave të renditur në një varg sipas një rregulli të caktuar, që në matematikë njihen si “Vargu i Fibonaçit”, për nder të matematicienit Leonardo Fibonaçi, që e zbuloi atë: 0, 1, 1, 2, 3, 5, 8, 13, 21, 34, 55, 89, 144, 233, 377, 610, 987, 1597, 2584, 4181...

Karakteristikë e këtyre numrave, të njohur si progresioni i Fibonaçit, është se secili prej tyre është i barabartë me shumën e dy numrave paraardhës, si dhe kur pjesëtojmë një numër të vargut me numrin përpara tij, përftohen numra që janë tepër afër njëri-tjetrit dhe pas numrit të trembëdhjetë të vargut ky numër mbetet konstant 1.618. Ky numër në gjuhën e matematikës njihet si “Prerja e artë” dhe përfaqësohet prej simbolit Φ (fi).

PRERJA E ARTË DHE TRUPI I NJERIUT

Gjatë kërkimeve apo krijimtarisë së tyre, artistët, shkencëtarët dhe disenjatorët, marrin si masë të tyre trupin e njeriut, proporcionet e të cilit janë vendosur sipas prerjes së artë. Leonardo da Vinçi dhe Le Korbusier e përdorën këtë prerje në vizatimet e tyre. Trupi njerëzor, proporcional sipas prerjes së artë, merret gjithashtu si bazë në librin ‘Neufert’, një nga librat më të rëndësishëm të referencave të arkitektëve të kohëve moderne. Ndërmjet pjesëve të ndryshme të trupit njerëzor ekzistojnë relacione proporcionale “ideale”, që janë gjithmonë ekuivalent me vlerën e prerjes së artë: 1.618. Shkencëtarët dhe artistët pajtohen se këto relacione vlejnë për “formën e idealizuar njerëzore”.

DISA PROPORCIONE TË ARTA NË TRUPIN MESATAR NJERËZOR JANË:

-Largësia ndërmjet majës së gishtit dhe bërrylit / largësinë ndërmjet kyçit dhe bërrylit.

-Largësia ndërmjet vijës së supit dhe majës së kokës / gjatësinë e kokës.

-Largësia ndërmjet kërthizës dhe majës së kokës / largësinë ndërmjet vijës së supit dhe majës së kokës.

-Largësia ndërmjet kërthizës dhe gjurit / largësinë ndërmjet gjurit dhe fundit të këmbës.

- Përpjesëtimi i dy ndarjeve të para me gjatësinë e plotë të gishtit jep prerjen e artë. (Kjo sigurisht nuk vlen për gishtin e parë me dy nyje).

- Përpjesëtimi i gishtit të mesëm me gishtin e vogël është gjithashtu një prerje e artë.

- Gjerësia e plotë e dy dhëmbëve të sipërm në nofullën e sipërme përmbi lartësinë e tyre jep një prerje të artë.

- Gjerësia e dhëmbit të parë nga qendra përmbi gjerësinë e dhëmbit të dytë jep gjithashtu një prerje të artë.

-Gjatësia e fytyrës / gjerësinë e fytyrës.

-Largësia ndërmjet buzëve dhe bashkimit të vetullave / gjatësinë e hundës.

-Gjatësia e fytyrës / largësinë ndërmjet majës së nofullës dhe vendit ku bashkohen vetullat.

-Gjatësia e gojës / gjerësinë e hundës.

-Gjerësia e hundës / largësinë ndërmjet flegrave të hundës.

-Largësia ndërmjet bebeve të syrit / largësinë ndërmjet vetullave.

- Proporcioni i bronkut më të shkurtër me atë më të gjatë është gjithmonë 1/1.618.



Ky informacion tregon natyrën superiore të krijimit të Zotit tonë, i Cili krijimin e Tij e përsosi dhe e formësoi ashtu siç dëshiroi. (Kuran 82:7-8)

DREJTKËNDËSHI I ARTË DHE SPIRALET

Drejtëndëshi, brinjët e të cilit janë 1 dhe 1.618 njësi të gjata, është një drejtëndësh i artë. Le të marrim një katror që ka gjatësinë e brinjës së shkurtër të këtij drejtëndëshi dhe vizatojmë një çerek rrethi midis dy anëve të katrorit. Më pas, le të vizatojmë një katror dhe një çerek rrethi në brinjën tjetër dhe le ta bëjmë këtë për të gjitha drejtëndëshat që

Ky informacion tregon natyrën superiore të krijimit të Zotit tonë, i Cili krijimin e Tij e përsosi dhe e formësoi ashtu siç dëshiroi.

(Kuran 82:7-8)



Prandaj, si është e mundur që krijesat në fjalë kanë mundur ta dinë se kjo është mënyra më e mirë për t'u rritur? Si kanë arritur këto kafshë, që disa shkencëtarë i përshkruajnë si "primitive", të dinë se kjo është forma ideale për to? Është e pamundur që rritja e këtij lloji të ndodhë në mungesë të një vetëdijeje apo intelektit. Kjo vetëdije nuk ekziston as te molusqet, as te vetë natyra, pavarësisht se çfarë pretendojnë disa shkencëtarë.

Është plotësisht joracionale të kërkojmë që të llogaritësh një gjë të tillë në kushtet e rastësisë. Kjo strukturë mund të jetë vetëm produkt i një intelektit dhe dijeje superiore.

Forma spirale nuk kufizohet vetëm në guaskat e molusqeve. Shembujt e lakoreve që bazohen në spiralen logaritmike mund të shihen në dhëmbët e elefantëve dhe të mamuthëve tashmë të zhdukur, në dhëmbët e luanëve dhe sqepin e papagajve. Brirët e kafshëve të tilla si: antilopa, dhia e malit dhe dashi, gjithashtu rriten në spirale që bazohen mbi prerjen e artë. Merimanga Eperia gjithmonë e end rrjetën sipas një spiraleje logaritmike.

Mjaft mikroorganizma, të njohura si planktone, janë të ndërtuara sipas spiraleve.


Amonitet, të cilat sot janë zhdukur dhe gjenden vetëm në formë fosilesh, gjithashtu kanë pasur guaska që rriteshin në mënyrë logaritmike.

PRERJA E ARTË NË ADN

Molekula e ADN-së, në të cilën ruhen të gjitha tiparet fizike të qenieve të gjalla, po ashtu është krijuar në një formë që bazohet në prerjen e artë. ADN përbëhet nga dy spirale pingule të ndërthurura. Gjatësia e lakores në secilën nga këto helika është 34 angstromë dhe gjerësia është 21 angstromë (1 angstromë është një e njëqind milionta pjesë e një centimetri.) 21 dhe 34 janë dy numra të njëpasnjëshëm të Fibonaçit.

PRERJA E ARTË NË BOTANIKË

Ndonëse degët që shohim në pemët përreth nesh mund të duken në shikim të parë se janë vendosur rastësisht, ato në të vërtetë janë vendosur sipas një plani dhe llogaritjeje matematike jashtëzakonisht të ndërlikuar. Rregulli se si renditen gjethet përreth kërcellit përcaktohet sipas numrave të veçantë. Kjo renditje bazohet mbi një llogaritje mjaft të ndërlikuar. Pika ku do të shfaqet çdo degë, vijimësia e gjethëve në degë dhe madje format simetrike të luleve, të gjitha janë të vendosura sipas ligjeve të pandryshueshme dhe



mbeten në drejtëndëshin kryesor. Kur ta bëjmë këtë do të përftojmë një spirale.

Spiralet që bazohen mbi prerjen e artë përmbajnë strukturat më të pakrahasueshme që mund të gjenden në natyrë.


Shembujt e parë që mund të japim për këtë janë radhët spirale mbi lulediellin dhe boçën e pishës.

PRERJA E ARTË DHE STRUKTURA E GUASKËS SË DETIT

Format e guaskës së molusqeve të mahnitin me perfeksionin dhe leverdinë e mënyrave të përdorura për krijimin e tyre. Ideja e spirales te guaskat shprehet në formë perfekte gjeometrike, në një dizajn "të mprehtë" me bukuri mahnitëse.

Guaskat e pjesës më të madhe të molusqeve rriten në mënyrë spirale logaritmike. Rritja e këtij lloji u përshkrua si "gnomike". Rritja e një guaske bazohet mbi zgjerimin dhe shtrirjen në forma me proporcione identike dhe të pandryshueshme. Guaska rritet vazhdimisht, ndërsa forma mbetet e njëjtë.

Sigurisht, nuk ka dyshim se këto kafshë janë të pavetëdijshme madje edhe për llogaritjet më të thjeshta matematike, e jo më për spiralet logaritmike.



madhësive të mrekullueshme. Gjethet janë të renditura ashtu që të mos hedhin hije mbi njëra-tjetrën. Çdo bimë ka degëzimin e vet unik dhe ligjet e vijimësisë së gjetheve. Ekzistenca e përpjesëtimin të një vijimësie të tillë të gjetheve është dëshmi e rëndësishme se gjërat e gjalla nuk janë krijuar rastësisht, por se ato janë krijuar me një strukturë jashtëzakonisht të ndërlikuar.

Botanistët kanë identifikuar numrat e brendshëm të prerjes së artë në degëzimin e një bime që rritet. Pasi bima rritet, nga çdo syth shfaqet një degë e re dhe nga çdo degë e re shfaqet edhe një degë e re. Vargu i Fibonaçit është një çelës kyç për të kuptuar llogaritjen dhe renditjen e stërholluar të bimët.

Fakti se bimët formohen sipas një formule të veçantë matematike është një nga dëshmitë më evidente se ato janë krijuar në mënyrë të veçantë.

Dëshmi të tjera të krijimit që përfshijnë prerjen e artë gjenden edhe në disa lule, fara dhe fruta. Luledielli është një nga shembujt më të bukur për këtë temë.

Nëse fillojmë të numërojmë të gjitha farat në spirale, duke u rrotulluar nga e djathta në të majtë, do të gjejmë dy numra të njëpasnjëshëm nga vargu i Fibonaçit. Kjo sigurisht nuk kufizohet vetëm për lulediellin.

Bimët u janë përmbajtur këtyre ligjeve me përpikëri që nga momenti që u krijuan.

Luleshqerrat dhe luspat e boçave të pishave dhe të ananaseve janë të vendosura gjithashtu në spirale nga e djathta në të majtë. Nëse i numërojmë këto një nga një, do të marrim numrat që bazohen në vargun e Fibonaçit, pra në prerjen e artë.

Bimët u janë përmbajtur këtyre ligjeve me përpikëri që nga momenti që u krijuan. Me fjalë të tjera, asnjë gjethe apo lule e vetme nuk shfaqet rastësisht.

Sigurisht, nuk mund të jetë rastësia ajo që i krijon të gjitha bimët me llogaritjet e tyre unike matematike. Krijuesi i kësaj forme të bukur dhe të përsosur është Zoti i Gjithëditur, i cili krijoi çdo gjë, duke e përsosur në mënyrë të qartë. (Kuran, 25:2).

Është Zoti i Gjithëfuqishëm dhe i Gjithëditur që e kodoi një proporcion të tillë në strukturën gjenetike të gjërave të gjalla dhe i krijoi ato me këtë informacion.

PRERJA E ARTË NË FORMAT GJEOMETRIKE

Format gjeometrike nuk janë aspak të kufizuara për trekëndëshat, katrorët, pesëkëndëshat apo gjashtëkëndëshat. Këto forma mund të bashkohen në mënyra të ndryshme dhe të prodhojnë forma të reja gjeometrike tredimensionale.

Kubi dhe piramida janë shembujt e parë që mund të përmenden.

Format tredimensionale që përmbajnë prerjen e artë janë shumë të përhapura te mikroorganizmat. Shumë viruse kanë formën e njëzetfaqëshit.

Dymbëdhjetëfaqëshi dhe njëzetfaqëshi shfaqen edhe në strukturën e silicit të radiolarianëve, organizmave detare njëqelizore. Strukturat që bazohen mbi këto dy forma geometrike përbëjnë trupat e bukur dhe të larmishëm të radiolarianëve.

PRERJA E ARTË NË FJOLLAT E BORËS

Prerja e artë manifestohet edhe në strukturat kristalore.

Pjesa më e madhe e tyre janë në struktura tepër të vogla për t'u parë me sy të lirë. Por ne mund ta shohim prerjen e artë të fjollat e borës.

Llojshmëritë e ndryshme të gjata dhe të shkurtra dhe zgjatimet që përbëjnë fjollat e borës japin që të gjitha prerjen e artë.

PRERJA E ARTË NË FIZIKË

Vargun e Fibonaçit dhe prerjen e artë e hasim edhe në fushat që hyjnë në sferën e fizikës.

Kur mbi dy shtresa qelqi të ngjitura mbahet një dritë, një pjesë e kësaj drite depërton, një pjesë thithet dhe pjesa tjetër reflektohet. Ajo që ndodh është një "pasqyrim i shumëfishtë". Numri i rrugëve që merr rrezja brenda qelqit, përpara se të shfaqet sërish, varet nga numri i pasqyrimeve që ajo i nënshtrohet. Si përfundim, kur përcaktojmë numrin e rrezeve që rishfaqen, zbulojmë se ato janë të përputhshme me numrat e Fibonaçit.

PRERJA E ARTË DHE MEKA

Edhe raporti i distancës së Mekës në rruzullin tokësor ndërmjet dy poleve i përgjigjet prerjes së artë. Largësia e Mekës nga Poli i Jugut/ Largësinë e Mekës nga Poli i Veriut = $12348.32 \text{ km} / 7631.68 \text{ km} = 1.618$.

PRERJA E ARTË - MASA E BUKURISË E KRIJUAR NGA ZOTI

Fakti se një pjesë e madhe e strukturave të gjalla apo jo të gjalla janë formuar sipas një formule specifike matematike, është një nga dëshmitë më të qarta se këto janë krijuar në mënyrë të veçantë dhe tregon natyrën superiore të krijimit të Zotit tonë.

Planetët, galaktikat, mikroorganizmat, kristalet dhe gjërat e gjalla të krijuara sipas këtij rregulli, janë dëshmi se Zoti i ka krijuar të gjitha gjërat me një masë të caktuar. (Kuran, 65:3; dhe 13:8).

PRERJA E ARTË NË ARKITEKTURË DHE ART

Ligji i prerjes së artë është studiuar thellësisht në shkollat e antikitetit grek, sidomos në të Pitagorës dhe u përdor



gjerësisht në projektimin e komplekseve arkitekturore, të tilla si tempuj, amfiteatre, stadione etj.

"Prerja e Artë" është zbatuar në krijimin e veprave të bukura dhe mbresëlënëse, si: në ndërtimin e piramidave të Egjiptit, në ndërtimin e Partenonit të lashtë në Athinë, në statujën e Apollonit, në ndërtimin e Notre-Dame de Paris dhe në objekte të tjera që janë kryevepra të arkitekturës së vjetër, që demonstrojnë një harmoni të mahnitshme në bazë të rregullsisë së tyre matematikore, si edhe në arkitekturën e sotme moderne, si p.sh. në Muzeun e Luvrit, ndërtesën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork etj.. Ky raport i artë i ka shërbyer Mikelanxhelos dhe Leonardo da Vinçit, i cili e ka përdorur këtë prerje në pikturën e tij të mirënjohur "Mona Lisa" dhe të "Njeriu Vitruvian". Ky përpjesëtim i artë gjendet edhe në strukturën e sonatave të Moxartit, të "Simfonia e Pestë" e Bethovenit dhe të kompozitorë të tjerë si Shubert dhe Debussy, si dhe e ka ndihmuar Stradivarin të përcaktonte saktë pozicionin e çelësave në violinat e tij perfekte. Veprat e artit që bazohen mbi këtë prerje paraqesin perfeksion estetik. Ky rregull i mirënjohur estetik është studiuar dhe vazhdon të studiohet me kureshtje nga shkencëtarët, matematicienët, biologët, fizikantët, kimistët, arkitektët, artistët etj..

Literatura:

1. Scott Olsen, The Golden Section: Nature's Greatest Secret, Bloomsbury USA, 2006
2. Ernst Neufert, Architects' Data, Publisher Wiley-Blackwell, 2019
3. D'Arcy Wentworth Thompson, On Growth and Form, Publisher: Dover Publications, 1992
4. Steven L. Griffing, The Golden Section: An Ancient Egyptian and Grecian Proportion, Xlibris US, 2007
5. Mario Livio, The Golden Ratio: The Story of Phi, the World's Most Astonishing Number, Publisher: Headline Review, 2002
6. Anne Hamilton, The Singing Silence: What the Design of the Universe Tells Us about God, 2007
7. Gary B. Meisner, The Golden Ratio: The Divine Beauty of Mathematics, Race Point Publishing, 2018
8. Kimberly Elam, Geometry of Design: Studies in Proportion and Composition, Publisher: Princeton Architectural, 2001
9. H. E. Huntley, The Divine Proportion, Publisher: Dover Publications, 1970
10. Dr. Alfred S. Posamentier, The Glorious Golden Ratio, Publisher: Prometheus Books, 2011
11. Trudi Hammel Garland, Fascinating Fibonacci – Mystery and Magic in Numbers, Publisher D. Seymour Publications, 1987
12. Robert D. Friedman, Matthew K. Cross, The Golden Ratio & Fibonacci Sequence: Golden Keys to Your Genius, Health, Wealth & Excellence, Publisher Hoshin Media, 2013
13. Theodore Andrea Cook, The Curves of Life, Dover publications INC., New York, 1979



Kaptina Keuther – Njëshmëria e Zotit (Teuhidi)

Dr. Valmire Batatina – Krasniqi

Për nga natyra e krijimtarisë së tij, njeriu është krijesë me aftësi për të përzgjedhur në mes të mirës dhe të keqes. Për shkak të kësaj aftësie, historia njerëzore, në përputhje me rrethanat dhe rrjedhën e jetës shoqërore, tregon ndryshime periodike në luftën midis monoteizmit dhe politeizmit. Përderisa gjatë kohës kur vinin profetët me shpallje, mbizotëronte e mira në aspektin e monoteizmit, moralit dhe sjelljes, pas një kohe, me fillimin e lënies anash të mësimave të shpalljes, fillonte kthimi mbrapa në shumë aspekte, si politeizëm, skllavëri, imoralitet dhe vepra të liga në përgjithësi. Në një gjendje të këtillë ishte edhe besimi i arabëve kur filloi zbritja e Kuranit, që duke i vënë theks të veçantë monteizmit (teuhidit) filloi të kthejë gjithçka në origjinën dhe fisnikërinë e tij, rregulloi besimin e devijuar dhe jetën shoqërore. Në lidhje me këtë parim si dhe me parimin e bujarisë, na flet kaptina Keuther, ku shprehet begatia dhe të mirat e pakufishme që Zoti i dhuroi të dërguarit të Tij, Muhamedit

a.s. në të dy botët, i kërkoi që të bëjë mirë nga mirësitë që i ishin dhënë, dhe që t'i lutej Atij sinqerisht. Kjo kaptinë, e zbritur në Mekë,¹ pas kaptinës El Adijat, përbëhet nga tri ajete të shkurtra, që janë në harmoni me njëra-tjetrën, me një përmbajtje të pasur dhe të larmishme. Është emërtuar “Suret ul-Kevtheri” - kaptina e Keutherit, e të gjitha të mirave.

LIDHMËRIA E KËSAJ KAPTINË ME KAPTINAT E TJERA

Sa i përket lidhmërisë së kaptinës Keuther me kaptinat e tjera kuranore, kjo kaptinë, përkundër numrit të vogël e të shkurtër të ajeteve që ka, përmbajtja e saj është si një plotësim për të gjitha kaptinat e tjera paraardhëse dhe si një gurthemel për kaptinat që vijnë pas saj. Si rrjedhojë, burimet, më së shumti e përmendin lidhjen e fuqishme që përmban kjo kaptinë me kaptinën paraardhëse në renditjen kuranore, kaptinën El Maun, ngase, përderisa në kaptinën El Maun, flitet për dy grupe njerëzish, për jobesimtarin mohues të të mirave të Zotit dhe të Ditës së Gjykimit në botën tjetër, dhe për hipokritin, që veprat e tij nuk kanë si qëllim kënaqësinë e Allahut, por, si në vepra ashtu edhe në adhurime është artificial – muraijj, kaptina El Keuther, flet rreth besimit në jetën tjetër dhe cilësive pozitive, si lëmosha, ndihma, bamirësia. Kuptimet që rrjedhin nga shprehja “keuther” theksojnë faktin se Allahu i Madhërishëm, përballë cilësive të hipokritëve dhe jobesimtarëve, manifeston bujarinë dhe të mirat e Tij ndaj të Dërguarit dhe pasuesve të tij. Përderisa në kaptinën El Maun, qortohet falja e namazit për syfaqësi, si një cilësi tjetër negative e hipokritëve, kaptina El Keuther, udhëzon besimtarin të mos adhurojë të mirat që i jepen, të mos jepet pas tyre, por përkundrazi të orientohet nga Dhuruesi i tyre, nga Zoti i Madhëruar duke i bërë të gjitha adhurimet dhe flijimet vetëm për hir të Tij.² Njashtu theksi i monoteizmit sikur në kaptinën Keuther përfshihet edhe në kaptinën pasuese El Kafirun, e cila vërteton njëherë e përgjithmonë se adhurimi është meritë vetëm e një Zotit, dhe



se propozimi i idhujtarëve që Muhamedi a.s., t'i adhurojë një vit zotat e tyre, kurse vitin tjetër ata të adhuronin Zotin e Muhamedit a.s., është i papranueshëm për sa të jetë jeta.³

SHPREHJA “KEUTHER” DHE KUPTIMI I SAJ

Kjo kaptinë kuranore fillon me një fjali përgëzuese për Muhamedin a.s. nga ana e Krijuesit duke thënë: “Ne, vërtet, të dhamë ty shumë të mira.”⁴ Ky ajet, aq sa përmban kuptim domethënës, po aq është edhe gjithëpërfshirës. Shprehja “keuther”, e cila në aspektin linguistik shpreh “bollëk, bereqet”⁵ në kuptim të përgjithshëm përdoret për objekte që janë të mëdha në numër dhe konsiderohen me vlerë dhe rëndësi në këndvështrimin e njerëzve.⁶ Ndërsa, sipas komentatorit të njohur, Kurtubiut, me shprehjen “keuther”, arabët përshkruajnë çdo gjë që është me vlerë dhe rëndësi për ta dhe ka një sasi ose numër të madh.⁷ Megjithatë, në kuptimin kuranor të kësaj shprehjeje, në mesin e dijetarëve ekzistojnë shumë mendime, ndër to: Keuther mund të jetë një lum në Xhenet, që kush pi prej tij nuk e kap më etja, ose një krua i posaçëm për Muhamedin a.s. dhe ymetin e tij, por më gjithëpërfshirësi nga këto mendime mund të konsiderohet qëndrimi i Ibën Abbasit, sipas të cilit “keuther” janë të mirat e shumta që iu dhanë Pejgamberit, si: grada pejgamber, libri, urtësia e përsosur, shefati, kroi, pozita e lavdishme (mekami mahmudi), shumë ymet, shumë çlirime të vendeve etj..⁸

NJËSHMËRIA E ZOTIT NË KONTEKSTIN E KËSAJ KAPTINË

Zoti i Madhërishtëm pas përgëzimit të Pejgamberit a.s. për të mirat dhe për bujarinë ndaj tij, në versetin e dytë të po kësaj kaptine duke urdhëruar: “Prandaj ti falu dhe prej kurban për hir të Zotit tënd!”⁹ vë në theks faktin se namazi, sakrifica, flijimet dhe çdo adhurim tjetër, duhet të jenë thjesht vetëm për hir të Zotit të Lartësuar për të përfituar kënaqësinë e Tij.¹⁰ Komentatorët e Kuranit japin disa mendime rreth qëllimit të shprehjes “fesal-li” – “fal namazin”. Thuhet se në këtë ajet ka për qëllim namazin e falënderimit ndaj ndonjë mirësie (salatu’s-shukr),¹¹ pesë kohët e namazit, namazin e sabahut ose namazin e bajramit, namazin e falur në Hudejbije.¹² Megjithatë rrjedhimisht kuptohet e shprehja “fesal-li” nuk nënkupton një namaz të veçantë, por ibadetin e namazit në

Përderisa në kaptinën El Maun, qortohet falja e namazit për syfaqësi, si një cilësi tjetër negative e hipokritëve, kaptina El Keuther, udhëzon besimtarin të mos adhurojë të mirat që i jepen, të mos jepet pas tyre, por përkundrazi të orientohet nga Dhuruesi i tyre, nga Zoti i Madhëruar duke i bërë të gjitha adhurimet dhe flijimet vetëm për hir të Tij.

përgjithësi (adhurimin e namazit).¹³ Në këtë këndvështrim thuhet se në këtë ajet kuranor nuk është për qëllim specifikimi i ndonjë namazi apo adhurimi, por sjell në pah qëllimin që duhet të ketë një besimtar gjatë kryerjes së një veprë, ku besimtari bashkon sinqeritetin me besimin, duke besuar bindshëm se Allahu është Një dhe i pashoq, dhe se vetëm Ai meriton flijimet e tij. Në këtë kontekst, kuptimi i ajetit do të ishte: “Kur t'i veproni këto, veproni për hir të Zotit”¹⁴, ngase është i njohur fakti se para shpalljes së fundit hyjnore, ishte traditë e idhujtarëve që gjatë tavafit rreth Qabesë t'u luteshin idhujve duke fishkëlluar dhe duke ecur lakuriq. Pastaj për hir të tyre flijonin kurbanë të ndryshëm që gjoja të arrinin bekimin e tyre.

Vënia e shprehjes “li Rabbike” në mes shprehjes “fesal-li dhe ve'nhar” po ashtu përforcon faktin se adhurimi duhet t'i përkushtohet vetëm Krijuesit, larg politeizmit dhe hipokrizisë. Në këtë kontekst komentatori Er Raziu, shprehet se: “Namazi është bindja e trupit, ndërsa zekati bindja e mallit. Ndërsa bindja e zemrës është që të gjitha këto vepra të bëhen për hir të Allahut.”¹⁵ Po ashtu me përgëzime dhe paralajmërime shpreh edukimin dhe zhvillimin e njeriut në drejtim të besimit në Njëshmërinë e Zotit, dhe largimin e tij nga veprat e liga e të kota për në përsosmëri duke thënë: “Përqendro veten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote...”¹⁶ Kaptina Keuther urdhëron faljen e namazit dhe flijimin për hir të Zotit duke iu bindur Njëshmërisë së Tij, kundër mentalitetit politeist që adhuronin idhuj të bërë në emër të disa “shenjtorëve” përveç Allahut dhe mendonin se ata do të jenë ndërmjetësues në praninë e Tij. Njëkohësisht në këtë ajet kuranor, vihet re një nxitje për seriozitet,

përkushtim dhe vendosmëri në faljen e namazeve të detyrueshme dhe atyre vullnetare. Akoma më tej, ky ajet sinjalizon për të mos u vetëmjaftuar me falënderim vetëm në namaz, por falënderimet të shprehen edhe duke bërë sakrifica materiale, siç është therja e kurbanit. Në fund, të gjitha këto porosi hyjnore kurorëzohen ashtu siç urdhërohet në kaptinën En'am: “Thuaj: “Namazi im, kurbanit im, jeta ime dhe vdekja ime janë thjesht për Allahun, Zotin e botëve, Ai nuk ka shok (nuk adhuroj tjetër). Me këtë (thjeshtësi të adhurimit vetëm për Zotin) jam i urdhëruar dhe jam i pari i myslimanëve (i pari që pranoj dhe bindem)!”¹⁷



Rrëfimi në këtë kaptinë vazhdon me mbështetje dhe përkrahje nga ana e Krijuesit të Lartëmadhëruar ndaj të Dërguarit a.s.: “E s’ka dyshim se urrejtësi yt është farësosur.”¹⁸ Transmetohet se njëri nga idhujtarët i quajtur As bin Vaili, armik i përbetuar i Muhamedit a.s., kur Pejgamberit a.s., sipas vetë urtësisë së Allahut xh.sh., i vdisnin djemtë, të ketë thënë: “Largohuni prej atij, se ai është farë e sosur!” E Zoti i Madhërishëm pasi ia rikujton të Dërguarit të tij se ia ka dhënë të gjitha të mirat, ia rikujton edhe atë se armiku i tij është i pa përkujtuar, farësosur. Kurse djemtë e tij (Pejgamberit a.s.) janë i gjithë ymeti dhe se djemtë e armiqve do ta përkujtojnë atë e jo baballarët e vet, si rasti i djalit të Ebu Xhehlit e shumë të tjerë. Pra, përkujtimi ndaj të Dërguarit do të vazhdojë sa të vazhdojë jeta në këtë tokë, kurse armiku i tij nuk do të përkujtohet, as prej djemve të vet, pra ai është farësosur, i harruar ose do të përkujtohet emri i tij vetëm si sinonim i së keqes dhe i errësirës. Në këtë rast shprehja “ebter” nuk përshkruan vetëm humbjen e trashëgimitarit, por përmban edhe kuptimin e shuarjes së kujtesës, famës dhe kauzës së një individi.

REFLEKTIMI I HARMONISË KURANORE NË PËRFUNDIMIN E AJETEVE TË KAPTINËS KEUTHER

Harmonia në mes vargjeve, renditja, uniteti i formulimit dhe kuptimit, si dhe qëndrueshmëria në mesazhet e dhëna brenda fjalive nuk gjenden në asnjë fjalë tjetër përveç se në Kuranin fisnik. Përmbajtja dhe tematika që trajton ai, janë të një natyre të tillë që mahnitë lexuesit dhe e bën të pamundur krijimin e diçkaje të ngjashme me të. Të këtilla janë edhe përfundimet e ajeteve të kaptinës Keuther me shprehjet “keuther”, “ve’nhar” dhe “ebter”, të cilat kanë një harmoni të fuqishme me njëra-tjetrën sa i përket tingullit dhe përmbajtjes

Komentatori Er Razi, shprehjet se: “Namazi është bindja e trupit, ndërsa zekati bindja e mallit. Ndërsa bindja e zemrës është që të gjitha këto vepra të bëhen për hir të Allahut.

koncize. Këto shprehje në një mënyrë shumë të fuqishme dhe harmonike përcjellin mesazhin e teuhidit, i cili synohet t’u jepet ndërgjegjeve të verbuara nga politeizmi. Shprehja “keuther”, për sa i përket tingullit dhe kuptimit, është plot me konotacione lajmesh të mira që ngrenë moralin e atyre që besojnë në njëshmërinë e Allahut. Ashtu si pellgu i Keutherit, që shpreh kuptimin e një lumi me një gjerësi të caktuar, por që rrjedh në pafundësi, dhe kaptina “Keuther” ofron një kuptim të shkurtër shpirtëror, i cili përqendron besimtarin

drejt mirësisë dhe bukurisë së pafund. Shprehja “ve’nhar” ashtu siç është një urdhër që ndërpret lidhjen e politeizmit me Teuhidin, ngjashëm si një mjet i mprehtë apo një thikë kurbani, e drejton njeriun të arrijë bekimin e Keutherit, duke e pastruar atë nga elementet e politeizmit. Nga ana tjetër, ky urdhër thekson faktin se ata që nuk shkëputen nga politeizmi, do të mbeten në ngërçin e “ebterit”.

Tematika e kaptinës Keuther është në harmoni me procesin e largimit nga politeizmi dhe të jetuarit në monoteizëm, si e vetmja rrugë e shpëtimit. Kjo rrugë arrihet me adhurim të sinqertë dhe me përkushtim ndaj Zotit të Madhërishëm, si dhe falënderim ndaj Tij për të gjitha mirësitë e panumërta që i dhuroi njeriut.

- 1 Në anën tjetër, Hasan el Basriu, Ikrimja, Muxhahidi dhe Katadeja, janë të mendimit se kjo kaptinë ka zbritur në Medinë. këtë mendim e përkrah edhe Ibën Kethiri. (Ez-Zuhajli, Et-Tefsiru’l -Munir, XXX/428).
- 2 Razi, *Et Tefsiru’l-Kebir*, I/4851.
- 3 Razi, *Et Tefsiru’l-Kebir*, I/4852, 4867.
- 4 Keuther, 108/1.
- 5 Ibën Durejd, *Xhevheretu’l-Xhemhere*, II/1174.
- 6 Shevkani, *Fethu’l-Kadir*, V/614.
- 7 Kurtubi, *El Xhami li Ahkami’l-Kur’an*, XX/216.
- 8 Taberi, *Xhamiu’l-Bejan*, XXIV/647; Begavi, *Mealimu’t-Tenzil*, VIII/554.
- 9 Keuther, 108/2.
- 10 Taberi, *Xhamiu’l-Bejan*, XXIV/654.
- 11 Ibën Abbas, *Tenviru’l-Mikās*, I/520.
- 12 Ibën Abbas, *Tenviru’l-Mikās*, I/520; Taberi, *Xhamiu’l-Bejan*, XXIV/653.
- 13 Tahavi, *Ahkamu’l-Kur’an*, I/183-184.
- 14 Maturidi, *Tevilat*, XVII/ 346.
- 15 Razi, *Et Tefsiru’l-Kebir*, I/4864.
- 16 Rrum, 30/30.
- 17 En’am 6/162-163.
- 18 Keuther, 108/3.

Përvetësimi i virtyteve të moralit

Dr. Sadat Islami

Bindjet dhe besimi kanë ndikim të pakrah-asueshëm në sjelljet dhe veprimet e njeriut. Në fakt, sjellja, është komplet produkt i bindjeve të njeriut.

Çështje e përvetësimit të tipareve dhe virtyteve nuk debatohet vetëm në rrethet e ambiente filozofike por edhe në ato fetare. Shkollarët myslimanë, duke iu referuar teksteve të ndryshme fetare, nga Kurani dhe Suneti, kanë arritur në përfundim se nga tiparet dhe virtytet, ka të atilla me të cilat lind njeriu, por edhe të tjera, që përfitohen e përvetësohen. Pejgamberi a.s., i kishte thënë Eshexh Abdul Kajsit: *“Vërtet, ti dallohesh për dy tipare të cilat i do Allahu: vetëpërmbajtjen (gjatë hidhërimit) dhe maturinë.”* “A i kam tipare të përvetësuar apo Allahu më ka krijuar me to?” – e pyeti Eshexhi. “Jo, Allahu të ka formësuar (krijuar) me ato...” – iu përgjigj Pejgamberi a.s..¹

Siç mund të vërehet në këtë hadith, njeriu lind edhe me tipare e virtyte.² Por kjo nuk nënkupton pamundësinë e përvetësimit të tyre, veçmas nëse merret parasysh roli dhe misioni fetar në formësimin e tipareve dhe gdhendjen e tyre. Kjo ka shtyrë Imam Gazaliun që të konstatojë se “sikur të mos parashihej ndryshimi i moralit, këshillat,

porositë dhe disiplinimi do të ishin pa ndonjë efekt...”³ Pra, thirrjet fetare për edukim dhe masat e ndërmarra disiplinore, në rast se morali nuk do të ndryshohej, nuk do të kishin pasur asnjë kuptim. Tutje, shton Imam Gazaliu, “si mund të mohohet kjo në raport me njeriun kur është dëshmuar në raport me kafshët...”⁴, pra, si nuk mund të ndryshojë sjellje njeriu, kjo qenie e dalluar për intelekt e arsye, ndërsa te krijesat e tjera, kafshët, që nuk janë në nivelin e njeriut, është dëshmuar ndryshimi i sjelljeve?! Në fakt, edhe tekstualisht, është konfirmuar mundësia e përvetësimit. Pejgamberi a.s., ka thënë: “Dituria është me të mësuar, mençuria (në reagime ndaj provokimeve)⁵) me vetëpërmbajtje...”⁶, pra nëse mëson e përvetëson diturinë, nëse vetëpërmbahesh gjatë hidhërimit, e fiton butësinë.

Në vazhdim do të përmendim disa rrugë dhe mënyra⁷ që dijetarë e shkollarë myslimanë i kanë përmendur si të suksesshme në ndryshimin pozitiv të moralit dhe sjelljeve.



KORRIGJIMI I KONCEPTIT PËR BESIMIN

Bindjet dhe besimi kanë ndikim të pakrahasueshëm në sjelljet dhe veprimet e njeriut. Në fakt, sjellja, është komplet produkt i bindjeve të njeriut. Nëse një besimtar ndreq konceptin e besimit, respektivisht thellohet në besimin në Zotin, në besimin në engjëjt, në ditën e fundit, në llogarinë, në Xhenet e Xhehenem, ai duhet të ketë moral të mirë. Këtu mbase qëndron arsyeja se pse Pejgamberi a.s., moralin e shihte si tregues të besimit kur thoshte: “Besimtari me imanin më të kompletuar është ai me moralin më të mirë”⁸

FUNKSIONALIZIMI I ROLIT TË ADHURIMEVE

Adhurimet në Islam nuk janë rituale enigmatike të cilat njeriu nuk mund t'i deshifrojë. Adhurimet kanë synime e objektiva edukative. P.sh., namazi të cilin e falim pesë herë në ditë ka mision të përsosjes morale. Kështu e përshkuan Allahu në Kuran: “...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar...” (El Ankebut, 45). Kështu, namazi i vërtetë reflekton në sjelljet dhe veprimet e besimtarit duke e bërë të largohet nga çdo gjë e shëmtuar. Kështu qëndron puna edhe për zekatin, qëllim i të cilit, sipas Kuranit, është dëlirësia shpirtërore.⁹ Me këtë efekt edukativ janë përshkruar edhe agjërimi¹⁰ dhe haxhillëku.¹¹

LIDHJA SERIOZE ME KURANIN

Kurani është libri të cilin Allahu i Madhëruar ia shpalli njerëzimit që të jetë libër udhëzues e orientues. Nga kjo perspektivë, ai paraqet udhëzimin më të mirë të mundshëm, atë që vetëm dituria e paskajshme e Zotit mund ta përshkruajë. Allahu i Madhëruar, duke na folur për këtë thotë: “Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira, se ata do të kenë shpërblim të madh.” (El Isra, 9). Po kështu ka thënë: “...Ne ta zbritëm ty Librin, si shpjegim për çdo çështje, si udhërrëfyes, si mëshirë dhe si lajm të mirë për myslimanët.” (En Nahl, 89); “O njerëz, ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për

besimtarët.” (Junus, 57). Ibën Kethiri vetinë këshilluese të Kuranit e shpjegon si frenuese dhe zmbapse nga të këqijat.¹²

ANGAZHIMI DHE USHTRIMI PRAKTIK PËR VLERA DHE VIRTUTE

Përvetësimi i moralit të mirë ndodhë edhe nëpërmjet angazhimit konkret. Që ta fitosh një tipar të çmuar duhet një lloj përpjekje dhe angazhimi. Këtë mësim e nxjerrim edhe nga hadithi i Pejgamberit a.s., në të cilin qëndron: “...kush tregohet i virtytshëm, Allahu do ta bëjë të virtytshëm; kush nuk ua shtron dorën njerëzve, Allahu do ta pasurojë; kush mbahet për durimtar, Allahu do t'i jep durim...”¹³

MEDITIMI RRETH MIRËSIVE TË MORALIT TË MIRË DHE PASOJAVE TË MORALIT TË KEQ

Një nga mënyrat se si një besimtar mund të përvetësojë virtytet është edhe duke medituar rreth mirësive të tyre dhe shpërblimit të paraparë për to. Po përmendim sa për ilustrim dy hadithe të Pejgamberit a.s.: “Gjëja që peshon më së rëndi në peshore (në Ditën e Llogarisë) është morali i mirë.”¹⁴, “Besimtari me imanin më të kompletuar është ai me moralin më të mirë. Vërtet, morali i mirë do të arrijë gradat e agjëritimit dhe namazit (vullnetar).”¹⁵

Nëse meditimi rreth mirësive të virtyteve na nxit që të fisnikërohemi me to, atëherë efekt të ngjashëm ka edhe meditimi rreth pasojave të moralit të keq. Pejgamberi a.s., për gruan që falej, agjëronte e jepte lëmoshë por që kishte

Kurani është libri të cilin Allahu i Madhëruar ia shpalli njerëzimit që të jetë libër udhëzues e orientues. Nga kjo perspektivë, ai paraqet udhëzimin më të mirë të mundshëm.



fjalor të pahijshëm e që bartte fjalë tha se do të përfundojë në zjarrin e xhehenemit.¹⁶

DURIMI DHE PËRPJEKJA

Përvetësimi i virtyteve kërkon angazhim dhe durim të madh. Ibën Kajimi, konsideronte se nuk mund të paramendohet godina e moralit të mirë vetëm se e mbështetur në katër shtylla: durim, ndershmëri, guxim dhe drejtësi.¹⁷ Maverdi po kështu konsideronte se durimi i paktë privon njeriun nga ndreqja dhe përmirësimi i vetvetes.¹⁸ Për këtë shkak, Allahu i Madhëruar, ka premtuar shpërblim të madh për ata që durojnë në rrugën e Tij: “...Vërtet, Ne do t'i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë.” (En Nahl, 96).

SHOQËRIMI ME NJERËZ TË MIRË DHE QËNDRIMI NË AMBIENTE TË MIRA


Njeriu ka fenë dhe moralin e atij që e shoqëron.¹⁹ Kështu na ka mësuar Pejgamberi a.s.. Kjo nënkupton se morali bartet nga njëri në tjetrin, prandaj, nëse shokët janë të mirë, morali gdhendet e ndreqet, nëse shokët janë të këqij, morali prishet. Sa bukur e ka përshkruar Pejgamberi a.s., në mënyrë figurative këtë ndikim, ka thënë se shembulli i shokut të mirë është sikur i shitësit të parfumeve që, edhe po nuk bleve, fiton aromë të mirë, ndërsa ai i shokut të keq si shembulli i farkëtarit që, nëse nuk të djeg rrobat, të paktën erë të keq të jep.²⁰

Këtu qëndron arsyeja pse Allahu i Madhëruar na urdhëron të përzgjedhim shokë të mirë: “O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe bëhuni me ata që janë të sinqertë (në fjalë dhe në vepra)!” (Et Teube, 119).

SHËMBËLLTYRA E MIRË DHE PËRFITIMI NGA MODELI MË I PËRSOSUR I NJERËZIMIT

Mënyrë tjetër e suksesshme se si përvetësohen vlerat është dhe duke marrë për model ndonjë personalitet të caktuar. E kë mund ta kemi ne myslimanët model më të mirë se Pejgamberin Muhamed, të cilin Allahu i Madhëruar e cilësoi të këtillë, shembull të përkryer: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (El Ahzab, 21). Sa bukur ka folur Ibën Hazmi kur atij që kërkon të mirën e ahiretit dhe urtësinë e dynjasë; që kërkon biografi të pastër e të drejtë, vlera e virtytet të rralla, ia propozoi ndjekjen e shembullit dhe modelit të Pejgamberit Muhamed a.s..²¹ Njohja me tiparet e tij, besimtarit ia ndihmon të përvetësojë virtytet, e nxit dhe stimulon për to.

Lexues të nderuar! Siç mund të shohim, virtytet janë të arritshme. Ky fakt sa është motivues, është edhe kundër argumentues. Pra, askush nga ne nuk do të mund të justifikohemi para Allahut për pamundësi të përvetësimit të



virtyteve. Të nxitojmë e të stolisemi me moral të mirë që të shpëtojmë në këtë dhe botën tjetër!

- 1 Sunen Ebi Davudi, nr. 5225. Shuajb Arnauti në “*Tahrirhu Rijadi es salihine*”, 1/217, konsiderojnë se hadithi ka varg të saktë transmetuesish. Version të shkurtuar të hadithit ka sjellë edhe Imam Muslimi në *Sahihun* e tij, nr. 18.
- 2 Këtë hadith e ka marrë si argument për ndarjen e moralit në të natyrshëm dhe të përvetësuar edhe autori i enciklopedisë së moralit, Halid Harrazi. Shih: Halid bin Xhumuah bin Uthman Harraz, “*Meusuatu el ahlak*”, (Kuvajt: Mektebetu Ehli el ether li en neshri ve et teuzië, 2009), f. 47-48.
- 3 Imam Gazaliu, “*Ihjau ulumi ed din*”, (Bejrut: Dar el ma’rifeh), 3/55-56.
- 4 Po aty.
- 5 Në hadith është përdorur shprehja *hilm*, e cila, siç kanë shpjeguar dijetarët ka kuptimin e mençurisë dhe moskthimin e një të keqeje me të keqe, ose faljen e të keqes. Shih: Munavi, “*Fejdu el Kadir sherhu Xhami es sagir*”, (Egjypt: El mektebetu et tixharijetu el kubra, 1356 h.), 2/473.
- 6 Hadith hasen. Shih: “*Sahih el Xhami*”, nr. 2328.
- 7 Për mënyrat dhe metodat e përvetësimit të tipareve të çmuara të moralit jemi mbështetur në: Halid Harrazi. Shih: Halid bin Xhumuah bin Uthman Harraz, “*Meusuatu el ahlak*”, vep. cit., f. 58-91 & versioni elektronik i Enciklopedisë së moralit <https://dorar.net/alakhlaq/23/>.
- 8 *Suneni i Ebu Davudit*, nr. 4682; *Suneni i Tirmidhiut*, nr. 1162; *Musnedi i Ahmedit*, nr. 7402, etj. Hadithi është i saktë. Shih: *Sahihu Suneni Ebi Davud*, nr. 4682 & *Sahih el Xhami*, nr. 1230.
- 9 Teube, 103.
- 10 Bekare, 183.
- 11 Haxh, 197.
- 12 Shih: Ibën Kethiri, “*Tefsiru el Kur’ani el adhim*”, (Rijad: Dar Tajjibe li en neshr, ed. 2, 1999), 4/247.
- 13 *Sahihu i Buhariut*, nr. 1427; *Sahihu i Muslimit*, nr. 1053.
- 14 Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Suneni Ebi Davud*, nr. 4799.
- 15 Hadith i saktë. Shih: *Sahihu Suneni et Tirmidhiut*, nr. 2003.
- 16 Hadith i saktë. Shih: *Sahihu et Tergib*, nr. 2560.
- 17 Shih: “*Medarixh es salikine*”, 2/294.
- 18 Shih: *Edebu ed dunja ve eddin*, f. 454.
- 19 Hadith hasen. Shih: *Sahihu Suneni Ebi Davud*, nr. 4833.
- 20 Shih: *Sahihu i Buhariut*, nr. 2101.
- 21 Shih: Ibën Hazmi, “*El ahlak ve essijer*”, f. 91.



Israja dhe Miraxhi - mrekulli unike

Mr. Muharrem Bryma

Nëse mrekullia si dukuri është ndryshim i proceseve natyrore ose ligjeve të gjithësisë gjatë së cilës ato ligje fizike mposhten, pezullohen, apo tjetërsohen, e gjithë kjo ndodhë nga ndërhyrja, të cilën e bën Allahu i Lartësuar në krijimtarinë dhe vendimet e Tij. E në këtë rend, sigurisht se Israja dhe Miraxhi, konsiderohet mrekulli unike, e pa realizuar ndonjëherë, as para Muhamedit a.s., e as pas tij. Kjo mrekulli e veçantë për nga lloji i saj, i dedikohet njeriut më të veçantë në mbarë njerëzimin, personit më të shkëlqyer që pati bota ndonjëherë, Muhamedit a.s..

Historia e njerëzimit është e tej mbushur me ngjarje e raste të ndryshme, të cilat janë konsideruar mrekulli në mesin e atyre që i kanë përjetuar dhe janë përcjellë gjeneratë pas gjenerate. Secili popull, pavarësisht besimit dhe bindjeve të tyre, kanë përcjellë te gjeneratat e tjera ngjarje, të bëra nga profetët

Kjo mrekulli e veçantë për nga lloji i saj, i dedikohet njeriut më të veçantë në mbarë njerëzimin, personit më të shkëlqyer që pati bota ndonjëherë, Muhamedit a.s..

dhe prijësit e tyre shpirtëror, të cilat janë konsideruar mrekulli.

Në historinë islame, rrjedhimisht Kurani fisnik dhe hadithi, përshkruajnë mrekulli të ndryshme e të shumta. Duke filluar me njeriun e parë, Ademin, i cili njëherësh ishte edhe i dërguari i parë, filluan edhe mrekullitë, të cilat Allahu ua dhuroi të dërguarave të Tij. Me këtë, Ai xh.sh., i përforcoi pejgamberët, për t'i bindur njerëzit se ata janë të dërguarit e Tij, të cilët kanë përkrahje dhe ndihmohen nga qielli, si dhe t'u tregojë se kur qielli të ndihmon dhe të përkrahë, aty pezullohen të gjitha ligjet njerëzore, sepse ato janë të paafta dhe nuk mund të veprojnë kundër vullnetit të Zotit.¹

Allahu i Lartësuar ia mësoi Ademit emrat e gjërave, e më pas, atij i ranë në sexhde melaqet. Nuhut a.s. ia ofroi shpëtimin në anije për të dhe besimtarët. Ibrahim a.s. nuk u dogj nga zjarri, edhe pse ata e hodhën në të për ta



dënuar, kinse për atë çfarë u bëri zotave të tyre. Ibrahimin a.s. e përgëzoi edhe me fëmijë në moshë të shtyrë. Mirësia nga Allahu për të nuk u ndal me kaq, por u përgëzua edhe me pejgamberllëkun e tyre, kuptohet Ismaili dhe Ishaku a.s.. Të njëjtën e përjetoi edhe Zekerijai a.s., duke ia dhuruar Jahjain a.s.. Ndërsa Musai a.s., Haruni a.s. dhe pasuesit e tyre u shpëtuan me një tjetër mrekulli, hapja e rrugës në mes të detit. Musai a.s. kishte gjithashtu shkopin që transformohej në gjarpër dhe dorën që shndriste. Isai a.s. foli sa ishte foshnje, gjithashtu shëroi të sëmurët. Të Dërguarit të fundit, Muhamedit a.s., përveç mrekullive të shumta, ju dha Kurani që është kurora e mrekullive dhe dallon nga të tjerat për shumë arsye.

Israja dhe Miraxhi, kjo ngjarje madhështore përmban dobi të shumta, disa janë enkas për Pejgamberin a.s., disa të tjera për besimtarët që jetuan me të dhe për të gjithë pasuesit e tij deri në ditën e fundit të kësaj dynjaje. Nëse ju referohemi të dhënave historike të jetës së Muhamedit dhe nga ajo që është e njohur në mesin e njerëzve, tregohet se Israja dhe Miraxhi ka ndodhur në natën e 27 të muajit hënor Rexheb, të vitit 12 të pejgamberisë së tij, rrjedhimisht në vitin 621.²

Mrekullia e Israsë dhe Miraxhit vjen nderim për Muhamedin a.s., përforcim dhe konfirmim i shpalljes hyjnore. Kjo mbështetje vije pas një kohe jo të gjatë që i vdiq bashkëshortja, Hatixheja dhe mbështetësi i pa kompromis, axha i tij, Ebu Talibi. Gjithashtu kjo vije edhe pas mohimit dhe kundërshtimit që i bëri populli i Taifit. Ky popull reagoi edhe më keq se sa banorët e Mekës kundër të Dërguarit. Ata e penguan, e nënçmuan dhe nuk e pranuan thirrjen e tij. Në këtë gjendje mërzie e pikëllimi që kishte Muhamedi, paqja e Zotit qoftë mbi të, në këtë gjendje pengese e luftimi ndaj misionit të tij, në këtë gjendje “triumfi” që pretendonin kundërshtarët e Mekës, për Muhamedin a.s. u hap porta e qiellit, erdhi lajmëtari nga Allahu dhe e mori Pejgamberin a.s. mysafir me nderimet më të mëdha dhe respektin maksimal nga banorët e qiellit, melaqe e pejgamberë, derisa kaloi shtatë qiejt. E gjithë kjo ndodhi brenda një nate. Kjo ishte e paperceptueshme për njerëzit e asaj kohe, andaj shumica edhe e mohuan. Filluan si çdoherë me akuza, tallje, përbuzje e nënçmime. Këtë e përshkruan edhe Allahu në Kuran ku thotë: “Pasha yllin kur ai bie (prej së larti poshtë)! Shoku juaj (Muhamedi që ju e njihni) as nuk është njeri që ka humbur, as që ka devijuar (nga e vërteta).

**Të qëndrosh
në namaz,
thënë ndryshe,
në këtë
adhurim të
obliguar në
qiell, do të
ndjesh se të
është dhuruar
liria e ngritjes
tënde në qiell,
aty ku i
drejtohesh
Allahut pa
ndërmjetësim.**

Dhe ai nuk flet nga mendja e tij. Ai (Kurani) nuk është tjetër pos shpallje që i shpallet. Atë ia mësoi, Ai fuqiforti, (Xhibrili). Që ka mendje precize dhe që u përqendrua në formën e vet (reale). Dhe ai (Xhibrili) ishte në horizontin e lartë (nga lindja). Pastaj u lëshua dhe iu afrua. E ishte afër sa dy harqe (dy kuti) apo edhe më afër. Dhe i shpalli robit të Tij atë që ia shpalli. Zemra nuk e mohoi atë që e pa (me sy). A po i bëni polemikë atij për atë që ka parë? Atë (Xhibrilin) e ka parë edhe herën tjetër. (E ka parë) te Sidretul Munteha. Që pranë saj është Xhenetul Me’va (kopsht strehimi i...) Atëherë kur Sidrën e mbuloi çka e mbuloi. Shikimi (i Muhamedit) as nuk lakoi e as nuk tejkaloi. Ai (Muhamedi) vërtet, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.” (En Nexhm, 1-18).

Në citatet sheriatike përshkruhet kjo ndodhi gjerë e gjatë.³ Kjo mrekulli filloi me hapjen e tavanit të shtëpisë ku ishte Muhamedi a.s., me paraqitjen e melaqeve, hapjen e gjoksit dhe pastrimin e zemrës, burakun – mjetin transportues, udhëtimin nga Meka në Mesxhidi Aksa – Jerusalem, faljen e namazit xhaminë Aksa me pejgamberët e tjerë, imam i të cilëve u bë i Dërguari, Muhamedi a.s.. Një pjesë të kësaj, Allahu e përshkruan në Kuran duke thënë: “I dëlirë dhe i pa të meta është Lartmadhëria e Atij që robin e Tij e barti natën nga Mesxhidi-Harami (Qabeja në Mekë) deri në Mesxhidi-Aksa (në Jerusalem), rrethinën e së cilës Ne e kemi bekuar, për t’ia treguar disa nga argumentet (mrekullitë) tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon dhe sheh çdo gjë!” (Isra, 1).

Pas kësaj fillon Miraxhi, ngritja, udhëtimi i Pejgamberit a.s. nga toka drejt horizontit qiellor, deri në Sidretul-Munteha, atje ku asnjë tjetër, përveç Muhamedit a.s. nuk ka arritur. Gjatë udhëtimit në horizontet qiellore është takuar me pejgamberë të shumtë. Gjithashtu ka parë forma të ndryshme shpërblimi për vepra të caktuara, por edhe forma të ndryshme ndëshkimi, ka parë Xhenetin, Xhehenemin, burimin Keuther, shtëpinë e adhurimit, mekamin e Muhamedit, e shumë detaje të tjera që kanë ndodhur atë natë.

Kurora e këtij udhëtimi ka qenë të folurit me Allahun e Lartësuar. Vallë çfarë përjetimi mund të jetë ai moment?! Çfarë privilegji? A nuk është unike kjo ngjarje, kjo mrekulli? Padyshim se është e tillë, sepse asnjë njeriu nuk iu është dhënë diçka si kjo, e as e ngjashme me të. Kjo ndodhi nuk mjafton me kaq. Kjo mrekulli edhe pse ngërthen pas saj shumë mirësi, dobi, përfitime e mësim, një gjë nuk harrohet

kurrë, saqë konsiderohet edhe si zemra e kësaj mrekullie, e ajo është obligueshmëria e namazit.

Mesazhi kryesor i kësaj mrekullie unike është namazi, i cili konsiderohet edhe dhurata e Krijuesit për krijesën e Tij, njeriun. Namazi origjinën e ka në këtë udhëtim unik, saktësisht mbi shtatë palë qiej. Kjo dhuratë për besimtarin padyshim është dritë që shndrit jetën e secilit, është paqe që shëron frikën e mërzinë, është shpresë për orientim të drejtë në jetë, është portë e sigurt që freskohesh me erërat e mirësive të Allahut. Të qëndrosh në namaz, thënë ndryshe, në këtë adhurim të obliguar në qiell, do të ndjesh se të është dhuruar liria e ngritjes tënde në qiell, aty ku i drejtohesh Allahut pa ndërmjetësim. Kështu do të jesh dora e parë e përfitimit prej të Madhëruarit, e që mirësitë e Tij nuk shteren asnjëherë. Nëse je në namaz, gjegjësisht në këtë adhurim, që u bë obligim gjatë kësaj mrekullie unike, e pamundura shkrihet, shkunden të gjitha ngarkesat, si dhe vendosen tek i Gjithëmëshirshmi e Mëshirëploti, aty shqetësimi humb dhe qetësia shpirtërore zotëron gjithçka. Me namaz përfiton krahë me të cilët largohesh nga pellgjet e shqetësimeve dhe brengave. Dyert e qiellit hapen për mikpritje të atyre momenteve vezulluese, e keqja fshihet nga shkëlqimi i fortë, kurse zemrat dhe sytë drejtohen nga

**Me namaz
përfiton krahë
me të cilët
largohesh nga
pellgjet e
shqetësimeve
dhe brengave.
Dyert e qiellit
hapen për
mikpritje të
atyre
momenteve
vezulluese, e
keqja fshihet
nga shkëlqimi
i fortë, kurse
zemrat dhe
sytë drejtohen
nga qielli dhe
shpirtrat
ushqehen nga
mirësia
hyjnore.**

qielli dhe shpirtrat ushqehen nga mirësia hyjnore.⁴

Muhamedi a.s. në këtë udhëtim privilegji dhe nderimi mori garanci për suksesin që do të ketë ai dhe besimtarët. Andaj kjo ngjarje e pazakontë për shumë njerëz, për pasuesit e Muhamedit a.s. ishte e lehtë, ngase e besuan dhe se kjo mrekulli u bë burim dhe energji orientuese për punën e tyre. Jobsimtarët si çdoherë vazhduan me mohimin, talljet dhe nënçmimet e tyre, por përfunduan në humbje, shkak i veprimeve të tyre.

Myslimanët, rregullisht, çdo vit rikujtojnë këtë mrekulli unike anekënd botës. Gjithashtu edhe ne në trojet tona, padyshim se i rikujtojmë argumentet e shumta që Pejgamberi a.s. na ka informuar rreth tyre në këtë ndodhi. Rikujtojmë dhe përjetojmë shpirtin e kësaj mrekullie – namazin, rikujtojmë kurorën e të gjitha mrekullive – Kuranin, si dhe rikujtojmë madhësitinë e Krijuesit, të lavdëruarin – Muhamedin a.s..

1 Muhamed Muteveli esh Sharavi, *Mrekullia e Kuranit* (Prishtinë, Shtypi: FOCUS, 2001), 16.

2 Halid Sejid Alij, *El Isra vel Miraxh Muxhize Hakaik Esrar ve Fevaïd* (Bejrut, Dar Aljemame, 2005), 37-40.

3 Muamed Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*. (Rijad, Dar Es-Selm, 1999), 75^Y-73^Y, Muslim b. el-Haxhaxh el-Kushejri, *Sahihul Muslim* (Shkup, Aj-Graf Matbaa, 2022), I/144-147.

4 Islam Gamal, *Namazi, më iku!* (Podujevë, Mozaiku, 2022), 147-151.



Ixhtihadi kolektiv bashkëkohor, rëndësia dhe nevoja

Dr. Selatin Mehani

“Të shpenzuarit e tërë forcës dhe potencialit intelektual të muxhtehidit, në përpilimin e dispozitës fetare racionale, qoftë ajo tekstuale, e prerë apo hipotetike.”

El Kemal ibën el Humam

HYRJE


Prej veçorive të fesë islame janë gjithëpërfshirja e mbarë njerëzimit dhe përshtatshmëria me rrethanat e tyre në çdo kohë dhe vend. Kjo për faktin se burimi i saj është Krijuesi i njeriut dhe kohëvendit. Por, pasi koha e revelatës qiellore ka përfunduar, ndërsa ndodhitë dhe situatat rrjedhin vazhdimisht dhe nuk përfundojnë, rruga e ixhtihadit qe dera e hapur para logjikës së shëndoshë, për të nxjerrë dispozitat në përputhje me shpalljen dhe qëllimet e saj. Për t'i trajtuar çështjet dhe sfidat bashkëkohore i është dhënë rëndësi të merituar ixhtihadit kolektiv, i strukturuar në institucione për studime dhe hulumtime të kohës, zhvillimet dhe sfidat e të cilit duhen vlerësuar në mënyrë kritike. Ky punim vë në pah vlerën dhe rëndësinë e ixhtihadit kolektiv, për të sqaruar dhe trajtuar situatat e reja të krijuara, si dhe nevojën e strukturimit të tij në mënyrë metodike, për t'ju përgjigjur nevojave të kohës.

KUPTIMI I IXHTIHADIT

Fjala ixhtihad në etimologji rrjedh nga fjala arabe (مُجَاهِدَة), që nënkupton forcën, përpjekjen dhe aftësinë, apo edhe (مُجَاهِدَة) - me vokalin “e” mbi shkronjën “xh”, që nënkupton përballje me vështirësitë.¹ Të dyja këto kuptime sikur i referohen një force dhe aftësie, që zotëron njeriu, në përballje me vështirësitë dhe pengesat të cilat mund të hasen.

Ndërsa, ixhtihadin në terminologji, usulistët e kanë përkufizuar me përkufizime të shumta, që të gjitha ato synojnë të njëjtin botëkuptim. Kështu dijetari El Kemal ibën el Humam, për ixhtihadin ka thënë: “Të shpenzuarit e tërë forcës dhe potencialit intelektual të muxhtehidit, në përpilimin e dispozitës fetare racionale, qoftë ajo tekstuale, e prerë apo hipotetike.”² Që nënkupton se, kur muxhtehidi³ (juristi i kualifikuar dhe jo dikush tjetër), pasi t'i ketë zotëruar mekanizmat shkencorë të studim-hulumtimit, bën më të mirën e tij, duke u angazhuar maksimalisht nëpërmjet përpjekjeve të tij, së bashku me konsultimin e burimeve të fesë, për të nxjerrë një vendim ligjor, i cili do të konsiderohej një mendim me peshë, edhe nëse i nënshtrohet gabimit dhe rishikimit. Kjo po ashtu nënkupton se fushëveprimi i ixhtihadit është aspekti praktik që ndërlidhet me praktikën e fikhut në lëmin dytësor (fikh el furu), ndërsa aspektet thelbësore të besimit islam (usul ed din), mbeten të vazhdueshme dhe të pandryshueshme, pavarësisht nga koha dhe vendi.

Ndërsa, ixhtihadi kolektiv, edhe pse në praktikë ishte i njohur qysh në kohët e dijetarëve të hershëm, megjithatë ata nuk e kishin përkufizuar atë me definicion të



veçantë, duke u mjaftuar me përkufizimin e përgjithshëm të tij. Prandaj, si përkufizim teorik, konsiderohet modern, i cili daton nga mesi i shekullit të kaluar, pas shfaqjes së nevojës në studimin e hipotezave dhe ngjarjeve të paparashikuara dhe situatave të reja, gjë që bëri dijetarët e mëvonshëm të shtojnë angazhimet e tyre në këtë drejtim. Kështu Abdurmexhid es Sevseve esh Sherefi, duke definuar ixhtihadin kolektiv, ka thënë: “Harxhimi i mundit të shumicës së juristëve, në përfitim të një gjykimi fetar të presupozuar përmes argumentimit, dhe pajtimi i tyre, pasi të jenë konsultuar, rreth një dispozite të caktuar.”⁴

Juristët bashkëkohorë e përkufizojnë ixhtihadin kolektiv si proces të bashkërenduar, për zbulimin e një vendimi të ri mbi bazën e një grupi të caktuar parimesh dhe teorish juridike pasi të jenë ushtruar në masën më të madhe të mundshme. Kjo ndërmarrje është e kufizuar në atë fushë në të cilën asnjë vendim i qartë nuk mund të nxirret nga tekstet e qarta burimore dhe përdoret vetëm për të ofruar zgjidhje që janë shumë të mundshme, të cilat rrisin sigurinë si rezultat i përpjekjeve kolektive, për dallim nga ixhtihadi vetanak, siguria e të cilit është në nivel më të vogël për shkak të mundësisë më të madhe të rënies në gabim. Prandaj, “ixhtihadi kolektiv tradicional është të shpenzuarit e tërë energjisë metodike shkencore në mënyrë shumë precize, të cilën e aplikojnë një grup njerëzish që kanë arritur shkallë të lartë shkencore dhe intelektuale, në një kohë të caktuar, rreth në çështje të caktuar, për të ardhur deri te një vendim përfundimtar, i cili do të kishte karakter të përgjithshëm që prek jetën e banorëve të një vendi e më gjerë.”⁵

Ixhtihadi kolektiv bashkëkohor përpiket të trajtojë sfidat bashkëkohore duke thirrur në ndihmë maksima ligjore dhe mjete juridike, duke marrë për bazë precedentët analogë në burimet e shpallura ose në epokën paramoderne, edhe nëse këto janë inekzistente, për t’ju përgjigjur nevojës së kohës në përshtatje me etikën e përgjithshme.

Së këndejmi, ixhtihadi kolektiv bashkëkohor ndërtohet mbi një mori pikëpamjesh bazuar në atë se çdo jurist i kualifikuar bën më të mirën e tij, nëpërmjet përpjekjeve të tij pas konsultimit të burimeve të ndryshme si dhe mësuesve dhe juristëve të tjerë të shquar, për të nxjerrë së bashku një vendim ligjor që do të mbetej një mendim me peshë, por që i nënshtrohet gabimit dhe rishikimit.

Kështu, përveç fushës së veprimit, që është aspekti praktik që ndërlihet me praktikën e fikhut në lëmin dytësor (fikh el furu), ai duhet të kufizohet në një grup njerëzish, ata janë juristët fetarë (muxhtehidët), të cilët zotërojnë mekanizmat dhe aftësitë e kërkuara për studim dhe hulumtim.

LIGJËSIMI I IXHTIHADIT

Ixhtihadi si proces dhe veprimtari është i ligjësuar me argumente kuranore, të qarta por edhe ato sinjalizuese, ndër to ajo që qëndron në suren En Nisa, ajeti 83, ku thuhet: “E, kur u vjen atyre ndonjë lajm qetësues ose shqetësues, ata e përhapin atë, e sikur t’ia linin atë (përhapjen e lajmit) të Dërguarit dhe përgjegjësve të tyre, ata do dinin të nxjerrin përfundime...”, i cili flet për gjendjen e luftës, dhe përhapjen e lajmit, qoftë ai në të mirë të besimtarëve apo në dëm të tyre, praktikë kjo e hipokritëve të asaj kohe, ndërsa lavdëron metodën e përpunimit të fakteve nga ana e atyre që janë përgjegjës, në rastin në fjalë të Dërguarit e Zotit, ndërsa pas tij bartësit e dijës së tij. Ngjashëm qëndron në ajetin 59 në po të njëjtën sure: “O ju që besuat, binduni Allahut, të Dërguarit dhe të ngarkuarve me çështjen tuaj. E, nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë atë drejtojuani Allahut dhe të Dërguarit nëse i besoni Allahut dhe ditës së fundit...”, ku qartë përcaktohen burimet e argumentimit dhe rëndësia e dijetarëve, të cilët na mbajnë të informuar për vendimet fetare pas vdekjes së Dërguarit të Zotit.

Për vlefshmërinë e ixhtihadit dëshmojnë edhe shumë hadithe profetike, ndër to ajo që transmeton Amër ibën Asi r.a., i cili e kishte dëgjuar të Dërguarin e Zotit të thoshte: “Kur vendimmarrësi të gjykojë duke aplikuar ixhtihadin, ai meriton dy shpërblime nëse ia qëllon, dhe një shpërblim nëse gabon (për shkak të përpjekjes së tij).”⁶

Ngjashëm dëshmohet me hadithin e Muadhrit, të cilin kur i Dërguari e kishte dërguar në Jemen, ai e kishte pyetur: “Me çka do të gjykoshe?” Muadhi qe përgjigjur: “Me atë që është në librit e Zotit. Po nëse nuk gjen në librin e Zotit?” - e pyeti i Dërguari? Ai tha: “Bazohem në gjykimet e të Dërguarit të Zotit.” “Po nëse edhe aty nuk gjen?” Muadhi i tha: “Bëj ixhtihad sipas mendimit tim dhe nuk anashkaloj.” I Dërguari i Allahut falënderoi Zotin, që kishte inspiruar Muadhin të krijonte një koncept të tillë.”⁷

Për ligjësimin e ixhtihadit kishin qenë të pajtimit të gjithë shokët e të Dërguarit të Zotit, ashtu siç edhe dijetarët myslimanë pas tyre. Ndërsa, ajo që argumenton ixhtihadin përgjithësisht, e njëjta vlen edhe për atë kolektiv bashkëkohor, pasi imperativi i përmendur në citatë është i përgjithshëm duke qenë se në konsideratë merret përgjithësimi i tekstit dhe jo specifikimi i shkakut, siç përmendin usulistët.

DISPOZITA FETARE E IXHTIHADIT

Parimet themelore islame i japin një rol të rëndësishëm arsyes njerëzore duke i dhënë hapësirë për mendim dhe kreativitet, ashtu siç qortojnë ngurtësinë dhe parazitizmin. Në raportin e argumentit dhe përpunimit të tij, Kurani thotë: “Vërtet, në gjithë këtë ka fakte për njerëzit që thellë mendojnë.” (El Xhathije, 13). Ashtu siç vlerëson përdorimin e mendjes “...pra merrni mësim (duke bërë krahasime) o ju të zotët e mendjes.” (El Hashr 2), deri në emërtimin e argumenteve “...udhëzim dhe përkujtim për të zotët e mendjes.” (40:54). Argumenti tekstual nuk do të kuptohej pa logjikën, ashtu siç edhe logjika pa argumentin tekstual nuk mjafton për përcaktimin e dispozitave. Dr. Jusuf Kardavi, në lidhje me këtë qe shprehur: “Muxhtehidi i vërtetë është ai që sheh argumentet tekstuale me një sy, dhe me syrin tjetër analizon aktualitetin dhe modernitetin, dhe përputhë në mes ngarkesës fetare dhe kërkesës aktuale, duke i dhënë secilës nga to gjykimin, të përshtatshëm me vendin, situatën dhe kohën.”⁸

Duke parë rëndësinë e kësaj, shumë juristë dhe usulistë mendojnë se, nuk duhet lënë hapësirë të ketë mungesë të ixhtihadit dhe muxhtehidëve në asnjë kohë. Madje disa mendojnë se çdo vend është i obliguar të aftësojë muxhtehidë, ashtu siç aftëson pronarë të profesioneve dhe zanateve të tjera, duke e konsideruar këtë si detyrë kolektive (farz kifaje).⁹

Dhe, nëse kaq i rëndësishëm është ixhtihadi në jetën praktike, strukturimi kolektiv i tij në formë moderne, bëhet edhe më i vlefshëm dhe i domosdoshëm, sidomos në kohën bashkëkohore, atëherë kur gjërat kanë pësuar ndryshim nga kohët e kaluara, veçanërisht pas progresivitetit teknologjik dhe problematikave që lindin në kohë. Ligjet e Sheriatit janë çdoherë në shërbim të njeriut, duke garantuar vazhdimin e jetës dhe lehtësimin e saj, andaj ato duhet trajtuar mbi këtë parim, çdoherë duke i vënë ato në shërbim të jetës sipas kushteve dhe parimeve të përgjithshme sheriatike. Përveç kësaj, gabimi i mundshëm në ixhtihadin kolektiv është më pak i ngjarë, për arsye se “në mesin e shumë mendimeve të kundërta, zakonisht e sakta është ajo e shumicës.”¹⁰

SHKAQET DHE KUSHTET E IXHTIHADIT

Moskuptimi i mirë i teksteve fetare, argumentimi me to dhe nxjerrja e dispozitave nga to, dhënia kahje e atyre që në shikim të parë dhe për syrin e njeriut mund të duken si të kundërta, pastaj zbritja e gjykimit mbi çështjet bashkëkohore dhe situatat e paparashikuara, dhe shkaqe tjera të ngjashme, kanë bërë të nevojshme mbase edhe të domosdoshme gjetjen e një komande strukturore dhe ideore, që së bashku me konsultimin e burimeve të fesë, do të shërbente si referencë për shoqërinë islame në orientimin e njerëzve drejt objektivave të fesë dhe dëshirës së Zotit.

Dhe, që ixhtihadi të jetë i saktë, i vlefshëm dhe i detyrueshëm, ai duhet të plotësojë disa kushte, të cilat përgjithësisht janë të definuar në përkufizimin e ixhtihadit. Kështu, përveç fushës së veprimit, që është aspekti praktik që ndërlidhet me praktikën e fikhut në lëmin dytësor (fikh el furu), ai duhet të kufizohet në një grup njerëzish, ata janë juristët fetarë (muxhtehidët), të cilët zotërojnë mekanizmat dhe aftësitë e kërkuara për studim dhe hulumtim. Vetëm të tillët mund të ushtrojnë këtë detyrë, pasi ata janë të informuar në hollësi me citatat e teksteve fetare (Kuranin dhe Synein), domethënien e tyre, shkaqet e zbritjes dhe historinë e abrogimit, pastaj njohin parimet themelore (usul), etikën e teologjisë, rregullat e gjuhësisë, praktikën zakonore (urf), mirëqenien publike (maslaha), rregullat e domosdoshmërisë (darurah), urgjencën (idtirar), shmangien e vështirësisë (el usr ve et tejsir), shkakun efektiv të analogjisë (il-let el kijas), pastaj objektivat e Sheriatit, njohin mirë konsensusin dhe llojet e tij (ixhma), dhe kushte të tjera, të cilat janë të detajuara në librat e usulit. Këto tipare, dhe të tjera të ngjashme, kanë bërë që “nga njerëzit, vërtet vetëm dijetarët denjësisht t'i frikohen Zotit.” (Kuran, 35:28), që është kushti bazë dhe themelor.

FORMAT E IXHTIHADIT KOLEKTIV BASHKËKOHOR

Ixhtihadi kolektiv bashkëkohor organizohet dhe manifestohet në forma të ndryshme, dhe kjo në bazë të institucionit organizativ apo sipas programit dhe metodës së ndjekur në hulumtim. Megjithatë barrierat dhe ngecjet mbesin sfidë përpara zhvillimit dhe progresit, gjë që bën të domosdoshëm paraqitjen e ideve të përshtatshme në tejkalimin e këtyre barrierave, në mënyrë që rezultati i ixhtihadit bashkëkohor të japë frytet e tij bazuar në qëllimet fisnike të këtij organizimi.

DISA NGA FORMAT E IXHTIHADIT KOLEKTIV BASHKËKOHOR:¹¹

Ixhtihadi kolektiv bashkëkohor, i strukturuar nga këndvështrimi i ndërmarrjes që e organizon atë, dhe i cili është katër llojesh:

Ixhtihadi kolektiv i drejtuar nga organizata ndërkombëtare. Këto organizata përbëhen nga grup dijetarësh të zgjedhur dhe të kualifikuar, nga të gjitha vendet dhe medhhebet, të cilët mblidhen për të diskutuar në çështjet dhe problematikat bashkëkohore, të cilët pas konsultimit me burimet fetare, me unanimitet apo shumicë nxjerrin gjykime fetare. Disa nga këto organizata janë: Akademia Islame e Fikhut, me seli në Meke të bekuar, dhe ajo e fikhut islam, me seli në Xhide të Arabisë Saudite, Këshilli Evropian për Fetva dhe Gjurmime.

Ixhtihadi kolektiv i drejtuar nga grup dijetarësh të një vendi. Këto janë organizatat të cilat kufizohen me



pjesëmarrjen e një numri të caktuar dijetarësh të një vendi, apo një medhhebi, siç janë këshillat për dhënie fetva rajonale medhhebo, të përhapura në të gjitha vendet e botës islame. Barrierë dhe sfidë përpara këtyre organizatave mbetet të kufizuarit e tyre në vende dhe medhhebe të caktuara, gjë që bën verdiktet të papranuara për vendet dhe medhhebet e tjera, ashtu siç bën të lehtë refuzimin nëse ato administrohen nga qeveritë e vendeve përkatëse apo dijetarë të emëruar nga qeveritë, gjë që nga disa mund të shihet si jo transparente.

Ixhtihadi kolektiv i organizuar nga një grup dijetarësh. Është kur një grup dijetarësh të kualifikuar, nga një ose më shumë vende, mbledhen në mënyrë josistematike, për të hulumtuar në ndonjë çështje apo problematikë, duke dhënë verdiktin e tyre për to, siç ndodh në shumë konferenca dhe simpoziume shkencore të organizuar nga universitetet dhe institucione të ndryshme shkencore. Ky lloj ixhtihadi kolektiv, sado që mund të jetë në shërbim të hulumtimit dhe gjurmimit, përveçse dobia e tij mbetet i kufizuar dhe pasimi i tij jo i detyruar.

Ixhtihadi kolektiv i jashtëzakonshëm. Ky lloj ixhtihadi është i përafërt me atë paraprak, përveçse ixhtihadi kolektiv i jashtëzakonshëm fillon si individual, ku një dijetar kryen hulumtimet e tij rreth një çështje të caktuar bashkëkohore, pastaj atë e paraqet para një grupi dijetarësh, dhe ata pas konsultimit me burimet e fesë, bëjnë miratimin e tij duke firmosur secili nga ta dhe kështu merr formën e ixhtihadit kolektiv.

Ixhtihadi kolektiv bashkëkohor, i strukturuar nga këndvështrimi i metodikës së ndjekur në hulumtim, i cili është tre llojesh:

2.1. Ixhtihadi kolektiv normativ, i cili organizohet në formë teknike normative, duke vënë verdiktet fikhore në formë ligjesh. Kjo metodologji për herë të parë qe përdorë në kohën e shtetit osman, i cili pati ngarkuar dijetarët e mëdhenj të kohës të përpilonin një legjislacion në fushën e marrëdhënieve mes njerëzve (muamelat), të bazuar kryesisht në medhhebin hanefi. Legjislacionin e përpunuar e quajtën (mexhelet el

ahkam el adlije), i cili u përpunua në vitin 1286h., ndërsa në vitin 1292h., u nxor urdhri dekret që ngarkon të punuarit me të. Një organizim i njëjtë, por i përgjithshëm që mbush hapësirën e situatave të reja dhe bashkëkohore, i mungon sot shoqërive myslimane.

2.2. Ixhtihadi kolektiv verdiktdhënës, i kufizuar në dhënie të fetvave në raste kur drejtohen pyetjet dhe parashirohen problematikat, dhe me këtë lloj ixhtihadi merren komisionet e ngarkuara me fetva, fetvatë e revistave dhe buletinet periodike fetare.

2.3. Ixhtihad kolektiv për studime dhe gjurmime shkencore, i cili manifestohet përmes punimeve apo studimeve të cilat prezantohen nëpër simpoziume të veçanta shkencore, enciklopedi apo disertacione, të cilat prezantohen para komisioneve vlerësues nëpër fakultete dhe universitete islame, të përbërë nga një grup dijetarësh, të cilët pas diskutimit dhe hulumtimit vlerësohen dhe aprovojnë.

Për fund, ixhtihadi kolektiv bashkëkohor është domosdoshmëri e kohës, ndërsa strukturimi i tij nga institucionet përgjegjëse është ngarkesë jetike fetare. Ixhtihadi që është në përdorim aktual për t'u marrë me sfidat e sotme, sado që mund të ketë arritur majat e tij, me strukturimin e tij ai është në gjendje të trajtojë situatat e paparashikuara bashkëkohore dhe moderne, duke bërë të jetë ilaçi që me sukses i përgjigjet sfidave të bashkëkohores dhe modernitetit.

- 1 Muhamed bin Mukerrem bin Mendhur, *Lisan el arab*, (Bejrut, boton Shtëpia Botuese "Sadir", 1992). B. 1, lënda ٣٣٥, v. 3, f. 133-134. Muhamed bin Muhamed ez Zubejdi, *Taxh el arus el munteka min xhevahir el kamus*, (Kairo, boton Shtëpia Botuese "El hidaje"), v. 7, f. 534.
- 2 Emir Padishah, *Tejsir et tahrir*, 4/178.
- 3 Ai që aplikon ixhtihadin.
- 4 Shih Es Sevse, Abdumexhid Es Sevseve Esh Sherefi, *El ixhtihad El xhami fi Et teshri El islamij*, f. 46.
- 5 Shih Kutub Sanu, *lexim analitik në definicionin e ixhtihadit të kërkuar kolektiv*, (revista Kulijet Ed Dirasat el islamije ve el arabije, Dubai), nr. 21, 2001. F. 209.
- 6 E ka regjistruar Buhari, Muslimi, Ahmedi dhe autorët e suneneve, përpos Tirmidhiut nga hadithi i Amër bin Asit dhe të tjerëve. Është hadith mutevatir kuptimor, *Xhamiul usul*, 10/548; *Xhamiul feva'id*, 1/683; *Mexhmea ez zeva'id*, 4/195; *Telhisu el habir*, 2/180; *Nasbu err Rrajeti*, 4/63.
- 7 Muhamed bin Ismail el Buhari, *Sahih el Buhari*, (Damask-Bejrut, boton Shtëpia Botuese "Ibën Kethir"), 2002, nr. 7352.
- 8 Kardavi, Jusuf Abdullah el Kardavi, *El ixhtihad fi esh sheriati el islamije mea nedharat tahlilje fi el ixhtihad el muasir*, (boton "El Kalem", Kuvajt), 1996. Botimi i parë, f. 5.
- 9 Shevkani, Muhamed bin Ali, *Irshad el fuhul ila tahkik el hakk min ilm el usul*, 2/211. Sujutiu, Xhelaludin es Sujuti, *Takrir el istinad fi tefsir el ixhtihad*, 1/29 (boton "Ed Dave", Iskenderije), Botimi 1. Esh Sheherestani, Muhamed bin Abdilkerim, *El milel ve en nihal*, (boton "Muesseset el Halebi"), 2/10.
- 10 Shih Muhamed bin Ali ebu el Husejn el Basri, *El mutemed fi usul el fikh*, (boton "El Kutub el Ilmije", Bejrut) b.1, vell.2, fq. 182.
- 11 Shih më hollësisht: Ahmed er Rejsuni, *Hulumtim në ixhtihadin kolektiv*, në kuadër të studimeve të simpoziumit "Fetvaja dhe kriteret", të organizuar nga Këshilli Fikhor, degë e Ligës Botërore Islame, i organizuar në vitin 2009, f. 8.

Dispozitat e huadhënies dhe dhuratës në të drejtën islame

Dr. Flamur Sofiu

Në të drejtën islame, ekziston dallimi në mes borxhit dhe huadhënies. Dallimi është se borxhi mund të kthehet në vlerën e mallit, ndërsa huaja është që të kthehet malli i njëjtë që është dhënë.

Huadhënia (لعارية) konsiderohet dhënia e ndonjë malli për t'u shfrytëzuar pa kurrfarë kompensimi.¹ Huadhënia mund të realizohet me këto shprehje: “po ta jap në shfrytëzim ty këtë”; “po ta jap ty këtë rrobë për ta shfrytëzuar”, e të ngjashme. Në të drejtën islame, ekziston dallimi në mes borxhit dhe huadhënies. Dallimi është se borxhi mund të kthehet në vlerën e mallit, ndërsa huaja është që të kthehet malli i njëjtë që është dhënë.

Ligjshmërinë e huas e gjejmë në ajete kuranore, në hadithe dhe në konsensusin e dijetarëve (ixhma). Allahu i Lartësuar ka thënë: “O besimtarë, kur merrni hua prej njëritjetrit për një afat të caktuar, shkruajeni atë. Dhe nga gjiri juaj le të shkruajë një shkruar ashtu siç e ka mësuar Allahu. Le të shkruajë, e atij le t'i diktojë ai që pranon borxhin, le t'i frikësohet Allahut, Zotit të tij, e të mos lërë mangët asnjë send nga ai. E në qoftë se ai që ngarkohet me borxh është i paafte mentalisht, është i mitur ose nuk është në gjendje të diktojë, atëherë le të diktojë drejt kujdestari i tij. Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burrë e dy gra, nga dëshmitarët që i pëlqeni. (Dy gra në vend të një burri) Për atë se nëse njëra prej tyre gabon, t'ia rikujtojë tjetra. Dëshmitarët të mos refuzojnë kur të thirren. Dhe mos përtoni për ta shkruar atë dhe afatin e tij, i vogël qoftë ose i madh, sepse kjo është më e drejtë tek Allahu, më e fortë për dëshmi dhe më afër mos dyshimit. Vetëm nëse është tregti e menjëhershme (dora-doras) që e praktikoni midis jush, atëherë nuk është ndonjë mëkat të mos e shënoni. Por, kur bëni shitblerje, dëshmojeni. E ai (pronari i pasurisë) nuk

dëmton as shkruesit as dëshmitarët, e nëse bëni (dëmtimin), ai është mos respekt juaji (ndaj dispozitave të Allahut). Kini frikë Allahun se Allahu ju dhuron dituri (të jashtëzakonshme), Allahu është i gjithëdijsëm për çdo send.” (El Bekare, 282), dhe në ajetin: “Huazoni (jepni sadaka) për hir të Allahut hua të mirë.” (El Muzemil, 20). I Dërguari a.s. ka thënë: “Në natën e Israsë e kam pa në derë të Xhenetit ku shkruante: lëmosha shpërblehet me dhjetëfish, ndërsa dhënia e huas (borxhit) shpërblehet me tetëmbëdhjetëfish, e unë i thash Xhibrilit a.s.: “Për çfarë arsye huaja është më e vlefshme se lëmosha?” Ai më tha: “Arsyeja është se lypësi lypen edhe kur ka, ndërsa ai që kërkon hua kërkon vetëm atëherë kur është i nevojshëm.” Ndërsa sa i përket ixhmait (konsensusit të dijetarëve) është se të gjithë janë të mendimit se lejohet marrja e huas dhe se shoqëria do të veprojë duke marrë hua prej kohës së të Dërguarit a.s. e deri në fundin e kësaj jete. Pra, të gjithë myslimanët janë të pajtimit për ligjshmërinë e huas, se lejohet të kërkojë hua dhe se nuk ka kurrfarë mëkati ai



i cili kërkon hua. Dhënia e huas konsiderohet vepër e rekomanduar për atë që e jep dhe lejohet ta marrë huamarrës për nevojat e jetës së tij.

NORMA E HUADHËNIES

Huadhënia është vepër e lejuar në shariatin islam.² Ky lejim bazohet në hadithin e të Dërguarit a.s., i cili transmetohet nga Safvan bin Jala, e ky nga babai i tij, se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Kur të vijnë tek ti të dërguarit e mi jepi atyre tridhjetë mburoja dhe tridhjetë deve.” Ai tha: unë thash: “O i Dërguari i Allahut, a është kjo hua që duhet pasur kompensim apo hua që nuk duhet kërkuar kompensim?” Ai tha: “Hua pa kompensim.”³

Huadhënia nëse nuk ka kohën e caktuar është një marrëveshje e rekomanduar, si ndihmë vullnetare dhe huadhënësi e ka të drejtë që të kërkojë kthimin e mallit kur të dëshirojë.

Malli i dhënë hua është amanet në dorën a atij që e ka kërkuar mallin hua dhe nëse shkatërrohet ky mall nga ndonjë shkak, por jo nga moskujdesi i huamarrësit nuk duhet të kompensohet.

Llojet e huadhënies

Huadhënia ndahet në dy lloje:⁴

Huadhënie e pakushtëzuar,

Huadhënie e kushtëzuar,

Huadhënie e pakushtëzuar është atëherë kur jepet ndonjë gjë që ta përdor tjetri pa i kushtëzuar ndonjë kusht për përdorimin e saj dhe as që i shpjegohet mënyra se si të përdoret ajo gjë. Norma e kësaj huadhënie është se lejohet dhe përdorimi i saj bëhet lirshëm, sikur që mund ta përdor vetë pronari i saj, si p.sh. nëse dikush e merr hua për ta përdorur veturën, atij i lejohet ta përdore atë sikur që e përdor vetë pronari, dhe po ashtu mund të ngarkojë me mall veturën nëse nuk e dëmton atë.

Huadhënie e kushtëzuar konsiderohet dhënia hua e ndonjë gjëje me kushtëzime të cilin kusht duhet respektuar ai i cili e merr mallin apo atë gjë hua. Po që se ndodh që huamarrësi nuk e respekton kushtin dhe e dëmton atë që e ka marr hua duhet ta bëjë kompensimin.⁵ Si p.sh. nëse dikush e merr lapsin për një orë e më pastaj kalon ora dhe nuk e kthen ngase e ka humbur apo thyer, atëherë marrësi e ka për obligim ta kthejë të ngjashëm ose të paguaj vlerën e tij. Ose tjetra, nëse dikush e merr hua veturën, por i kushtëzohet që të mos barte dru me të, atëherë atij nuk i lejohet ta thyejë këtë kusht.⁶

Huadhënia
nëse nuk ka
kohën e
caktuar është
një
marrëveshje e
rekomanduar,
si ndihmë
vullnetare dhe
huadhënësi e
ka të drejtë që
të kërkojë
kthimin e
mallit kur të
dëshirojë.

DHURATA NË RASTIN E DHËNIES SË HUAS

Sipas hanefitëve, nëse kushtëzohet dhënia e dhuratës është vepër shumë e urryer (mekruhi tahrimen), e nëse nuk kushtëzohet, atëherë lejohet. Ndërsa malikitët janë të mendimit se është e ndaluar rreptësisht të jepet dhuratë huadhënësit. Këta, mendimin e tyre e mbështesin në hadithin e të Dërguarit a.s., i cili ka thënë: “Kur ndokush prej jush jep hua, mos të marr dhuratë.” Po ashtu, shënohet se i Dërguari a.s., e ka ndaluar që të merret dhuratë në rastin e dhënies së borxhit, ngase veprimi i tillë është i afërt me kamatën. Umer bin Abdulazizi, dhënien e dhuratës huadhënësit e ka konsideruar si rryshfet.

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR HUAN

1. Nuk lejohet që malli i dhënë hua t'i jepet dikujt tjetër me qira apo të lihet peng. Nëse ndodhë që huamarrësi e bën një veprim të tillë dhe malli dëmtohet, atëherë huamarrësi është i detyruar për të bërë kompensimin.

2. Nuk i lejohet huamarrësit që t'ia jep dikujt tjetër mallin që e ka marrë hua nëse i është ndaluar një veprim i tillë nga huadhënësi. E po që se nuk i është kushtëzuar që të mos e japë hua, atëherë lejohet t'i jepet tjetrit hua me kusht që përdorimi të jetë i njëjtë sikur që e përdor vetë ai apo pronari i mallit. Si p.sh. nëse e merr veturën hua, atëherë mund t'i jepet tjetrit ta përdor me kushte që edhe ai të

ketë kujdes sikurse huamarrësi, ngase vozitja dallon prej njëri-tjetrit. E po që se e jep librin e marrë hua tjetrit lejohet.

3. Po që se merret toka në formë të huas për të ndërtuar në të apo për të mbjell atë, lejohet. Nëse ndodh që në atë tokë që është ndërtuar apo është mbjell, atëherë huadhënësi dëshiron ta rikthejë, atëherë lejohet të rikthehet. Në këtë rast, huadhënësi mund të urdhërojë për shkatërrimin e asaj që është ndërtuar apo mbjell dhe nuk bënë kurrfarë kompensimi. E nëse ndodh që toka e dhënë hua e ka afatin e caktuar, atëherë huadhënësi po që se shkatërrohet para afatit së caktuar, atëherë është i detyruar të bëjë kompensimin.

4. Gjësendet e çmuara duhet t'i kthehen personalisht huamarrësit, se nëse kthehet gjësendi i çmuar deri te shtëpia e huadhënësit pa iu dorëzuar atij në dorë, nëse ndodh që humbet apo shkatërrohet gjësendi, atëherë duhet bërë kompensimi nga huamarrësi.

5. Kur ndodh që të merret si hua shtaza dhe huamarrësi e kthen atë në ahur të pronarit, nëse ndodhë që të dëmtohet

apo ngordh shtaza, në këtë rast nuk obligohet huamarrësi për ta kompensuar.⁷

Shënim: Pagesa e shërbimit për rikthimin e huas është obligimi i huamarrësit.

DHURATA DHE DISPOZITAT E SAJ

Dhuratë konsiderohet pronësimi i një gjëje pa kurrfarë kompensimi. Shtyllat kryesore të dhuratës janë dy:⁸ oferta dhe pranimi. P.sh. nëse ndodhë që dhuruesi i dhuratës thotë: “unë po ta dhuroj këtë dhuratë”, ndërsa marrësi e pranon, atëherë dhurata është e pranuar dhe marrësi e merr në posedimin e vet edhe pa lejen e dhënësit, por nëse ndahen dhuruesi dhe marrësi i dhuratës, atëherë marrësit nuk i lejohet ta posedojë dhuratën, pos me lejen e dhuruesit.

KUSHTET E VLEFSHMËRISË SË DHURATËS

Për t’u konsideruar dhuratë legale, duhet të plotësohen këto kushte:

1. Që dhuruesi të jetë i mençur, në moshën madhore dhe pronar i dhuratës. Nuk konsiderohet e vlefshme dhurata e dhënë nga fëmija, i çmenduri dhe ai që nuk e posedon dhuratën.

Nuk konsiderohet e vlefshme dhurata e dhënë nga fëmija, i çmenduri dhe ai që nuk e posedon dhuratën.

2. Që marrësi i dhuratës të marrë dhuratën, ngase nuk konsiderohet pronë e tij përderisa të fus në dorë.

3. Që dhurata të jetë e ndarë, nëse ajo është mall që duhet të përpjesëtohet me të tjerët si p.sh., toka është pronë që përpjesëtohet, atëherë duhet të caktohet se cila pjesë është dhuratë. E po që se ndodhë që dhurata nuk pranon përpjesëtim si p.sh. pusi, shtëpia që është shumë e vogël e të ngjashme, në këtë rast nuk ka nevojë përpjesëtim, por dhurata i takon atij që i është dhuruar.

4. Që malli i dhuruar të mos ketë kurrfarë lidhje me dhuruesin. Si p.sh., nuk është e vlefshme të jepet lisi i pemës dhuratë ku frutat janë pronë e dhuruesit. Po ashtu konsiderohet e pavlefshme dhënia dhuratë vetëm e frutave e jo edhe e lisit, apo dhënia dhuratë e të mbjellave, por jo edhe e tokës. Po ashtu nëse jepet dhuratë shtëpia, por orenditë shtëpiake janë të dhuruesit, atëherë atij që i është dhënë dhurata nuk i lejohet marrja e tyre, ngase pasuria ende është në pronësi të dhuruesit.

5. Dhurata duhet që të jetë prezentë. Po që se ndodh të jepet mielli duke qenë ende në kallinj apo vaji i lulediellit ende pa u përpunuar, kjo dhuratë është e pavlefshme për arsye se dhurata ende nuk është prezentë.⁹





Shënim: Nëse ndodhë që babai i jep birit tij dhuratë, ku vetë prindi në këtë rast është pronar i asaj që i jepet të birit, në këtë rast mjafton vetëm oferta pa kërkuar që i biri ta pranojë dhuratën. E po që se ndodh që një i huaj i jep diçka dhuratë fëmijës, atëherë dhurata duhet të merret nga kujdestari i fëmijës apo dikush i familjes së tij. E nëse ndodh që fëmija vetë e merr dhuratën, atëherë nëse fëmija është i mençur, dhurata konsiderohet legale, e përndryshe duhet ta marrë dhuratën ai cili kujdeset për fëmijën.

NORMA E DHURATËS

Vërtetohet pronësia e atij që është dhënë dhurata si pasuri jo e domosdoshme që d.m.th. është legale që të rikthehet apo anulohet dhënia e dhuratës nëse i është dhënë të huajit, por rikthimi nga dhënia e dhuratës konsiderohet veprim shumë i urryer (mekruhi tahrimen). Për këtë, i Dërguari a.s. ka thënë: “Ai që kërkon të rikthejë dhuratën është i njëjtë me atë që e rikthen vjelljen e tij.”¹⁰

Nuk lejohet rikthimi i dhuratës pasi që është dhënë dhe e ka pronësuar marrësi, përveç me dy kushte: nëse të dy palët si dhënësi dhe si marrësi janë dakord ose me vendim të gjykatësit.

SHËNIM:

Dhënësi i dhuratës nuk mund të marrë kompensim nga personi që i ka dhënë dhuratën.

Nuk mund të revokohet dhurata nëse ndodhë që në pasurinë e dhënë dhuratë është bërë ndonjë shtesë si p.sh. të bëhet ndërtim në tokë, apo të shtohet si ndërtim diçka në shtëpi, e të ngjashme.

Nëse ndodh që dhurata është shitur apo i është dhuruar dikujt tjetër, atëherë nuk ka mundësinë e revokimit të saj.

Po që se ndodh që i jepet dhurata dikujt që është i afërm, atëherë nuk lejohet revokimi i saj, si p.sh. nëse i jepet dhuratë babait, vëllait etj.

Po ashtu nëse jepet dhuratë në mes të bashkëshorteve, atëherë nuk ka revokim të dhuratës.

Nuk pengohet revokimi i dhuratës nëse ndodh që është bërë ndonjë shtesë jashtë bazës së dhuratës si p.sh. fryti që është në lisin e dhënë dhuratë.

Po që se ndodh që të jepet dhurata me kushte të pavlefshme në aspektin juridik islam, atëherë dhurata nuk mund të revokohet si p.sh., të thuhet po ta japë dhuratë këtë shtëpi me kusht që t'u kthehet pas vdekjes së tij trashëgimtarëve të dhuruesit. Në këtë rast dhurata është legale, por kushti është i pavlefshëm dhe se nuk duhet t'u rikthehet trashëgimtarëve të dhuruesit.

Kur ndodhë që dhuruesi e jep një copë ari me kusht që për t'ia shitur pastaj prapë atij, në këtë rast dhurata është e vlefshme, ndërsa kushti i pavlefshëm.

Kur ndodh që të jepet delja apo lopa si dhuratë, por jo edhe i vogli i tyre, në këtë rast dhurata është e vlefshme dhe nuk merret parasysh përjashtimi.

Nuk konsiderohet e vlefshme dhurata nëse i jepet mundësia e zgjedhjes së marrjes apo mos marrjes, pos nëse e vendos marrjen e dhuratës para se të ndahen mes vete.¹¹

1 Es Serhasiu, “*Kitabul Mabsut*”, Darul Mearifeti, Liban-Bejrut, pa vit botimi, vol XI fq. 133, Ibnul Humam el Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, boton Darul Kutub el Ilmijjeti, Liban-Bejrut, 1424 h 2003 m, vol. V fq. 99. El Kasani, “*Bedaiu-s-Sana’i*”, Darul Kutub el Ilmijjeti, Bejrut, 1424 h 2003m, vël. VI fq. 214.

2 Ibnul Humam el Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, vël. V, fq. 117. El Kasani, “*Bedaiu-s-Sana’i*”, Darul Kutub el Ilmijjeti, Bejrut, 1424 h 2003m, vël. IX fq. 6.

3 Transmeton Ebu Davudi (3568).

4 Ibnul Humam el Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, vël. V, fq. 117.

5 Maxhid el-Itr, El Mufasssal fil Fikhil Hanefij el Emval, boton, Mektebetu Daril Mustakbel, Halep, pa vit botimi fq. 69.

6 Po aty.

7 Maxhid el Itr, El Mufasssal fil Fikhil Hanefij el Emval, boton, Mektebetu Daril Mustakbel, Halep, pa vit botimi fq. 67.

8 Ibnul Humam el-Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, vël. V, fq. 113.

9 Ibnul Humam el-Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, vël. V, fq. 121.

10 Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

11 Ibnul Humam el Hanefij, “*Fet’hul Kadir*”, vël. VII, fq. 121. El Kasani, “*Bedaiu-s-Sana’i*”, vël. IX, fq. 6. Maxhid el Itr, El Mufasssal fil Fikhil Hanefij el Emval, fq. 79.

Doracakët më të njohur të fikhut hanefi (4)

EL KAFI I HAKIM SHEHIDIT

Hazir D. Selmani

Shejbani është autor i njërit prej muhtesarëve më të rëndësishëm të medhhebit hanefi dhe quhej si “Dijetari i Mervit”.

HYRJE

Shejbani, librin e parë që e shkroi ishte El Asël. Sipas gjetjeve të dr. Bujunkallënit, ai këtë vepër e pati shkruar diku në mes periudhës 152-166 hixhri. Edhe pse, pastaj pas shpërnguljes së tij në Bagdad dhe më pas në Rakah, ai disa libra (kapituj) të kësaj vepre i rishkroi edhe një herë. Ky rishkrimi i dytë pati vijuar deri në vdekjen e tij në vitin 189 hixhri. Në fillim, kapitujt e kësaj vepre ishin libra të ndarë, pastaj u bashkuan në një libër të madh me titullin El Asël. Numri i këtyre librave-kapituj është 64 (57 ekzistues dhe 7 të humbur).¹ Këto ishin mijëra fletë në qindra fletore dorëshkrimore, e që sigurimi i

një kopjeje të plotë, mbartja, ruajtja, mësimi dhe referimi prej tyre ishin sfidë shumë e madhe për shumë mexhlise diturie të asaj kohe. Nevoja e një libri të ri më të shkurtër që do të përfshinte tërë fikhun e shkruar të librave të Shejbanit vetëm se shtoej. Kësaj pune gjigante iu rrek Hakim Shehidi dhe rezultati që doracaku fenomenal i fikhut hanefi me titullin El Kafi.

KUSH ËSHTË HAKIM SHEHIDI?

Afërisht në të njëjtën kohë kur Tahaviu vepronte në Egjipt dhe Kerhiu në Bagdad, Ebu'l-Fadël Muhamed b. Ahmed, i njohur më shumë si Hakim Shehid Mervezi Belhiu, veproi në disa qytete të Transoksianës, sidomos në Buhara, Merv dhe Belh. Ai është autor i njërit prej muhtesarëve më të rëndësishëm të medhhebit hanefi dhe ishte Dijetari i Mervit. Për jetën e tij nuk ka shumë të dhëna. Viti i tij i lindjes nuk dihet. Lindi në qytetin e lashtë Merv, prandaj është i njohur

me nofken Mervezi. Në jetë ndërmori shumë udhëtime diturie. Fillimisht mësoi nga imamët e Horasanit dhe pastaj vizitoi qendrat islame, si: Buhara, Nisabur, Raj, Bagdad, Kufe dhe Meke. Më pas udhëtoi për në Fustat (Egjipt) dhe në fund fare u kthye në vendlindjen e tij. Pas një kohe u caktua kadi i Buharës. Gjatë kësaj periudhe ai ndante kohë për t'ia mësuar fikhun princit të ri samanid, El Hamid, birit të guvernatorit Nasër b. Ahmedit. Në vitin 331 hixhri, vdiq guvernatori në fjalë dhe vendin e tij e zuri i biri, princi El Hamid, i cili kompetencat e tija dhe administrimin e mbretërimit të tij i la në dorën e mësuesit të tij Ebu'l-Fadël Muhamed b. Ahmed Hakimit.² Mësuesi fillimisht refuzoi postin e vezirllëkut, mirëpo me insistim të guvernatorit u detyrua ta pranojë atë, e që më vonë i kushtoi me jetën e tij. Shkak i postit të lartë udhëheqës që kishte, filloi të njihet me nofken El Hakim (shq.: pushtetari). Pastaj si shkak i postit u transferua në Belh, ku jetoi pjesën e mbetur të jetës së tij, prandaj njihet edhe me nofken Belhi. Sipas asaj që shënon Sem'ani, Hakimi nuk i kushtonte fare rëndësi vezirllëkut. Sigurisht meqë atë e pranoi i detyruar si dhe në zyrën e tij merrej me shkrime e lexime dhe pranë mbante shportën (me fletë), librat dhe shishen e bojës e ndërsa palët që vinin aty qëndronin në këmbë duke pritur e ai nuk merrej fare me to. Madje, shkoi edhe me larg, saqë ai pati urdhëruar rojet që në zyrën e tij mos lejonin hyrjen e pasanikëve e as kalorësit fisnikë, ndërsa të mos pengonin hyrjen e studentëve fukara dhe vizitorëve kurbetçi.³ Dhehebiu shënon se Hakimi nuk angazhohej me përgjegjësitë e vezirllëkut, ngase dëshira e zjarrtë e tij dhe ëndja ishin në dituri dhe në nxënësit nevojtarë.⁴ Këto gjëra, si dhe trazirat e mëdha politike dhe vonimi i pagave e shujtave të ushtarëve, çuan në një revoltë të madhe të ushtarëve kundër vezirit dhe u vra nga ana e rebelëve. Për vitin e kësaj ndodhie në shumicën absolute të burimeve përmendet viti 334 hixhri edhe pse Ibën Ethiri shënon se kjo gjë ngjau në muajin rabiu'l-aahir të vitit 335 hixhri dhe se fillimisht princi nuk e dorëzonte Hakimin në duart e rebelëve, mirëpo pasi ata kërcënuan me bashkimin e tyre me ushtrinë e axhës rebel të princit, ai e dorëzoi atë.⁵ Detajet e kësaj nate të kobshme i jep Sema'ani, i cili shënon se, Hakimi kur dëgjoi nga tenda e tij

britmat e asqerëve që ishin tubuar rreth saj dhe mori vesh se ata kishin ardhur për ta vlarë, ai tha: “Allah falje!”. Pastaj, me një brisk rroi kokën dhe bëri gusull si dhe veshi qefnin dhe tërë natën e kaloi duke bërë namaz. Në sabah, sultani kishte dërguar dikë për t’i ndaluar, porse ata nuk pranuan dhe kur e gjetën Hakimin, e mbytën atë gjersa ai ndodhej në sexhde, i larë e me qefin, e ndërsa librat dhe qiririn i kishte aty pranë. Kjo ngjau në rabi’l-aahir të vitit 334 hixhri.⁶ Ibën Xheuzi shënon se shehidllëku ishte lutje të cilën gjithnjë e bënte Hakimi.⁷ Rruga studimore e kadiut dhe vezirit, Hakim Shehid që u përmend më lartë, minimalisht ka rreth 12 mijë km vajtje-ardhje dhe kjo dëshmon vullnetin e tij të çeliktë në kërkimin e dijes. Krahas njohjes së thellë të fikhut hanefi, e që ishte edhe prijësi i hanefive të Transokianës, ai njihte shkëlqyeshëm edhe shkencën e hadithit dhe dinte përmendsh me rrugë të ndryshme rreth 60 mijë hadithe. Ai është njëri prej mësuesve të Hakimit, autorit të veprës së hadithore El Mustedrak. Sema’ani e cilëson me fjalët dijetari i Mervit dhe imami i hanefive në vaktin e tij.⁸ Gjithnjë agjëronte të hënave dhe të enjteve. Namazin e natës nuk e linte as si rezident e as në udhëtim. Shkrimin nuk e linte as rrugës e as në shtëpi. Kur ishte vezir, rreth tij në zyrë mbante shportën (me fletë), librat dhe shishen e bojës dhe vazhdimisht merrej me shkrime.⁹ Dihet se ai pas vetes la disa libra shumë të rëndësishëm.

GJURMËT E HAKIMIT

Sema’ani, që ishte një dijetar shafi, deklaroi se veprat e Hakim Shehidit dëshmojnë se sa i përkryer që ishte ai, e sidomos veprat El Kafi, El Munteka, Sherhu’l-xhami dhe Usulu’l-fikh. Në shumë burime të tjera, atij i atribuohen edhe disa vepra tjera si: El Gurar, El Mustehles mine’l-xhami’ si dhe vepra El Isharaat.¹⁰ Tani për tani, tërë veprat e Hakimit llogariten të humbura me përjashtim të El Kafi. Para se të flitet pak më gjerësisht për këtë vepër, është e udhës të thuhet edhe ca fjalë kalimthi për veprën El Munteka. Hakim Shehidi krahas veprave fikhore të llojit dhahiru’r-rivajeh, ai rreth vetes tuboi 300 libërtha të vegjël (ar.:xhuz’) fikhor të llojit el emali dhe të atyre el nevadir dhe e pa më se të nevojshëm përpilimin e një veprë të vetme që do të ngërthente vetëm ajkën e këtyre librave pa përsëritje dhe me fjali të ngjeshura mirë. Rezultati ishte vepra El Munteka. Libri përmbledhte meseletë e dhahiru’r-rivajes plus edhe meseletë e nevadirëve. Libri ka disa shekuj që është humbur dhe s’ka më gjurmë prej tij.¹¹ Kjo vepër citohet me të madhe në disa burime fikhu të periudhës së mesme të medhhebit, sidomos në veprën El Muhit të Ibën Mases. Sikur t’i kishte mbijetuar zhdokjes padyshim se do të ishte një perlë në vete dhe një vlerë e madhe për medhhebin hanefi, i cili do të ishte edhe më i pasur me opinione fikhore si të llojit dhahiru’r-rivajeh, ashtu edhe të llojit nevadir. Ibën Abdini për el Muntekanë shënon: “Prej librave të medhhebit është edhe vepra El Munteka, e po të njëjtit autor (Hakim Shehidit). Vetëm se në këtë libër ka edhe ca mesele të llojit nevadir.”¹²

MUHTESARI I HAKIMIT

Vepra El Kafi është muhtesari dhe doracaku i famshëm fikhor i Hakim Shehidit. Ajo citohet shumë në literaturën fikhore hanefite. U shkrua duke pakësuar vëllimin e shkresave fikhore të Shejbanit, me heqje të përsëritjeve dhe duke përdorur terma të ngjeshur e shumë kuptimplotë. Shkakun e shkrimit të kësaj veprë e jep vetë Hakimi në hyrje kur thotë (shënimet në kllapa janë shtesa nga ne): “...me këtë librin tim kam përfshirë kuptimet e Muhamed b. Hasen Shejbanit në librat e tij të zgjeruar si dhe atë që ndodhet në koleksionet e shkruar, (dhe këtë e kam bërë) me pakësim të fjalëve të tija si dhe heqje të asaj që i përsëriten meselet e saja. Tërë këtë duke synuar për një lehtësim të udhës së atyre që kanë interes në memorizimin e tij si dhe pakësim të ngarkesave (ulje të shpenzimeve) të tyre në shkrim, lexim dhe mbartje të tij si në shtëpi ashtu edhe në udhëtim.”¹³ Pra, arsyeja kryesore e shkrimit të kësaj veprë ishte lehtësimi për hifz si dhe pakësimi i shpenzimeve të majme që merrte sigurimi i kopjes origjinale të veprës El Asël. Në bazë të ca dorëshkrimeve të kësaj veprë, mund të thuhet se Hakimi këtë libër e pati shkruar dy herë. Versioni i parë ishte pak më i gjatë, ndërsa i dyti më i shkurtë dhe këtë të fundit e pati komentuar Serahsiu¹⁴ nga bunari nëntokësor, ku vuante padrejtësisht burgimin e tij të gjatë. Botërisht deri shumë vonë është besuar se vepra El Kafi e Hakim Shehidit është version i shkurtuar i tërë veprave të Shejbanit, që i takonin zhanrit dhahiru’r-rivajeh, e që sipas disave janë pesë libra dhe sipas ca tjerëve gjashtë. Mirëpo, disa studiues bashkëkohorë hedhin një tezë tjetër interesante që thotë se, vepra El Kafi e Hakim Shehidit është rishkrim dhe version i shkurtër i vetëm një libri të llojit dhahiru’r-rivajeh të Shejbanit dhe ai libër është El Asël, i njohur edhe si El Mabsut. Ndërsa fjalët e Hakimit në hyrjen e lartëcituar “në



librat e tij të zgjeruar si dhe atë që ndodhet në koleksionet e shkruar” kanë për qëllim kapitujt e El Asël, e që fillimisht ishin libra të ndarë, siç u theksua në fillim. Këta studiues tezën e tyre e mbështesin në shumë dorëshkrime. Argumentet e tyre janë mjaftë të fuqishme. Për çudi po këtë gjë e deklaroi edhe Kënallëzadeja në biografinë e Hakimit, kur thotë se në veprën El Kafi shkuroi veprën El Mebsut të Shejbanit.¹⁵ Doracak El Kafi i Hakimit është ndër veprat më të çmuara të medhhebit hanefi. Pas shek. IV hixhri, u kthye në një ndër muhtesarët më të besueshëm për citimin dhe bartjen e veprave të Shejbanit dhe asaj që do të njihet si dhahiru’r-rivajeh. Ky libër vlerësohet me konsideratën më të lartë (ar.: el-mu’etemed) në citimin e medhhebit. Ibën Abidini deklaroi: “Dijeni se prej veprave që kanë shënuar meseletë burimore është edhe libri El Kafi i Hakim Shehidit. Ky libër është me konsideratë të lartë në transmetimin e medhhebit.”¹⁶ Ky doracak citohet me të madhe, sidomos në librat e zgjeruar të fikhut hanefi si dhe në librat e llojit shuruh, havashi dhe fetava. Me gjithë vlerën e madhe që ka, akoma nuk është botuar, edhe pse si tema masteri-doktorate është analizuar në disa universitete me dhjetëra teza. Në qarqet shkencore të botueseve islamë, përfillet se së shpejti do të botohet. Personalisht, posedojmë një fotokopje të kësaj vepre, origjinali i së cilës ruhet me numrin 580 në Bibliotekën Sulejmanije të Stambollit. Kopja ka një shkrim të lexueshëm lehtë. Viti i shkrimit të tij në fotokopje nuk figuron. Përbëhet nga 1328 faqe të ngjeshura, me afër 31 rreshta në secilën faqe dhe ka 66 kapituj. Ky doracak i lashtë i fikhut hanefi nuk duhet ngatërruar me komentarin fikhor El Kafi të Nesefiut e as me librin fikhor El Kafi të Vehbi Gavoçit që mbajnë të njëjtin emër. Është doracak i plotë që është komentuar nën-mesatarisht si dhe për burim duket se pati veprën El Asël të Shejbanit. Prej tij momentalisht në shqip nuk ka diç të përkthyer.

KOMENTET (EL SHURUH) TË MUHTESARIT TË HAKIM SHEHIDIT

Për Muhtesarin e Hakimit, numri i komentarëve bie në 5 dhe të paktën deri më tani njëri është i botuar dhe dy tjerë ekzistojnë pjesërisht si dorëshkrime. Komentet¹⁷ e këtij doracaku janë:

1. Komenti i apologjetit Ebu’l-Hasen Enbarit (vdiq 331 hixhri). Çelebiu e cilëson si libër shumë të dobishëm. Mirëpo që herët llogaritet i humbur, ngase prej tij s’gjenet asnjë citim.¹⁸

2. Komenti i Halvanit (vdiq 448 hixhri). Pjesa e dytë e këtij komenti ndodhet në Turqi.¹⁹

3. Komenti i Dameganit (vdiq 478 hixhri). Edhe ky koment llogaritet i humbur.²⁰

4. Komenti i Ispixhabit të Madh (vdiq 481 hixhri). Thuhet se një kopje e tij ndodhet dorëshkrim në Turqi.²¹

5. Komenti El Mebsut, i diktuar gojarisht nga Serahsiu (vdiq 483 hixhri), që ndodhej i burgosur në bunar, e ndërsa nxënësit e tij shkruanin rreth qafës së bunarit atë që thoshte mësuesi i tyre nga thellësia e tokës. Ky koment është ndër librat më të përkryer për fikhun hanefi dhe është botuar para disa dekadave në 30 vëllime.²² Në shumicën absolute të komenteve të El Hidajes, kur përmendet El Mebsuti synohet mu ky koment i Serahsiut. Tjetra, sigurisht se ky koment fenomenal dhe i përkryer ishte shkak edhe i ruajtjes së El Kafit, por edhe që më vonë nuk pati më komente të tjera të rëndësishme, ngase kush guxonte pas Serahsiut ta bënte më këtë gjë! (Vijon)

- 1 Mehmet Bojnukallën, Hyrja studimore e veprës El Asël. (Doha: Ministria e Vakëfit, bot. i parë, 2012), vëll. 1, fq. 138-139; Po aty, vëll. 1, fq. 105; Po aty, vëll. 1, fq. 115.
- 2 Ibën Ethir, El Kamilu fi’t-Tarih. (Bejrut: daru’l-ktabi’l-arabij, botimi i parë, 1997). Vëll. 7, fq. 121.
- 3 Sema’ani, El Ensab. (Hajderabad: mexhlisu dairati’l-meaarifi’l-uthmanijeh, botimi i parë, 1962), vëll. 8, fq. 188-190.
- 4 Dhehebi, Tarihu’l-islam ve vefejatu’l-meshahiri ve’l-ealam. (Bejrut: daru’l-garbi’l-islamij, botimi i parë, 2003). Vëll. 7, fq. 685.
- 5 El Kamilu fi’t-Tarih, vëll. 7, fq. 165.
- 6 El Ensab. Vëll. 8, fq. 191.
- 7 Ibën el Xheuzij, el-Muntedham fi tarihi’l-muluki ve’l-umem. (Bejrut: daru’s-Sadir, botimi i parë, 1979), vëll. 6, fq. 346.
- 8 El Ensab. Vëll. 8, fq. 187.
- 9 El Ensab. Vëll. 8, fq. 189; Ibën Kethir, El Bidajeh ve’n Nihajeh. (Rijad: daru’l-hexhër, botimi i parë, 1997), vëll. 15, fq. 209.
- 10 Për titujt e veprave të tija shiko: El Ensab. Vëll. 8, fq. 191; Keshfu’dh-dhunun. (Londër: Al-Furqan Foundation, 2021), vëll. 5, fq. 95, lib. nr. 11459; Po aty, vëll. 1, fq. 439, lib. nr. 1027; Hedijetu’l-arifin, vëll. 2, fq. 37; Ibën Abidin, Sherhu Ukudi’r-rasmi’l-muftij. (Ankara: ISAM, botimi i dytë, 2022). Fq. 102.
- 11 Keshfu’dh-dhunun, vëll. 7, fq. 200, lib. nr. 18543; Hamevi, Gamzu Ujuni’l-Besair. (Bejrut: DKI, bot. 1, 1985), vëll. 4, fq. 321.
- 12 Ibën Abidin, Radu’l-Muhtar ale’d-durri’l-muhtar. (Damask: daru’l-fikër, botimi i tretë, 1979), vëll. 1, fq. 70.
- 13 Hakim Shehidi, El Kafi. (Stamboll: dorëshkrim me numër 508 në bibl. Sulejmanije). Fq. 1a.
- 14 Orhan Enxhekar & Abdulkadir Jëllmaz në analizën e tyre mbi veprën: Merxhani, Nadhuratu’l-Hak. (Aman: daru’l-fet’h, bot. i parë, 2012), fq. 172-173.
- 15 Për më gjerësisht shiko: Alaudin Ibën el Hinaij, Tabekat el-Hanefijeh. (Bagdad: Divanu’l-vakfi’s-sunij, botimi i parë, 2005), vëll. 2, fq. 24, bio. 59; Nadhuratu’l-Hak, fq. 170-171, fusnota nr. 1; Luej el-Halili, Esbabu Uduli’l-hanefijeh ani’l-futjai bi dhahiri’r-rivajeh. (Aman: daru’l-fet’h, bot. i dytë, 2016), fq. 58, fusnota nr. 1.
- 16 Radu’l-Muhtar ale’d-durri’l-muhtar, vëll. 1, fq. 69.
- 17 Për komentet e Muhtesarit të Hakimit shiko: Abdullah el Habeshi, Xhamiu’sh-shuruh ve’l-havashi. (Xhide: daru’l-minhaxh, botimi i parë, 2017), vëll. 1, fq. 291; Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh, (Bejrut: DKI, 2020) vëll. 1, fq. 126, 199, 201, 210, dhe 211.
- 18 Keshfu’dh-dhunun, vëll. 5, fq. 448, lib. nr. 13047; Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh, vëll. 1, fq. 122 dhe fq. 126.
- 19 Hyrja studimore e veprës El Asël. fq. 117 dhe 122.
- 20 Hedijetu’l-arifin, vëll. 2, fq. 74; Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh, vëll. 1, fq. 199.
- 21 Keshfu’dh-dhunun an esamij el-kutubi ve’l-funun, vëll. 5, fq. 448, lib. nr. 13045; Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh, vëll. 1, fq. 201.
- 22 Mesadiru’d-Dirasati’l-islamijeh, vëll. 1, fq. 210-211.

Bullizmi nga këndvështrimi islam

Mr. Jakup Çunaku

Islami është një sistem i përkryer normash, i cili përfshin të gjitha aspektet e jetës, individuale qofshin ato apo edhe kolektive. Islami paraqet një qasje të balancuar të adresimit të çështjeve thelbësore të një shoqërie, të drejtave dhe përgjegjësisë, privilegjeve dhe detyrimeve, etj.. Etika islame merret me standardet e së drejtës, vlerave, të mirës, por edhe me sjelljet e gabuara të njerëzve; dhe përshkruan sjelljen e mirë njerëzore për t'u përmbajtur nga qëndrimet imorale. Të gjithë njerëzit janë të krijuar nga e njëjta bazë. Zoti në Kuran thotë: *"O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëjmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."* (El Huxhurat,13).

Allahu e bëri devotshmërinë kriter të dallimit ndërmjet njerëzve. Askush nuk ka të drejtë të krenohet ndaj tjetrit, të pretendojë epërsi ndaj tjetrit, ta nënçmojë, ta ofendojë, e aq më pak t'i shkaktojë dëm të çfarëdo lloji qoftë, fizik, verbal, moral apo psikologjik.

Përkundër gjithë kësaj, etiketimi, ngacmimi dhe bullizmi, në të shumtën e rasteve vijnë nga njerëzit të cilët kanë besim të dobët, moral të zbehtë dhe edukimi i tyre lë shumë për të dëshiruar. Ky fenomen i rrezikshëm është përhapur gjithandej në botë, e që në media dhe në gjuhën shkencore njihet si fenomeni i bullizmit. Ndikimi i tij është zgjeruar aq shumë, sa që e keqja e saj është përhapur deri në atë pikë sa e ka pësuar thuajse çdo shtresë të shoqërisë.

Në gjuhën e Kuranit (atë arabe), fenomeni i bullizimit – ngacmimit, njihet me nocionin Et Tenemmur, që paraqet personin që sulmon të tjerët duke humbur njerëzoren e tij dhe duke u zhveshur nga natyra e tij humane. Sjellja, stili dhe mënyra e sjelljes së tij me të tjerët, është me e afërt me një kafshë

grabitqare, siç është tigri, që në gjuhën arabe njihet "En nemiru - النمر", nga rrjedh edhe ky nocion.

Kurse në gjuhën shqipe për këtë fenomen përdoret fjala me prejardhje angleze "bully"- bullizëm, që ka për qëllim ngacmimin, nënçmimin, kërcënimin verbal apo fizik, etj..

Në aspektin terminologjik është definuar si: "Një dëshirë për të dëmtuar tjetrin, një veprim që lëndon, një disbalancë në forcë midis personave, një përsëritje (në mënyrë tipike), një përdorim i padrejtë i forcës, një kënaqësi e dukshme e agresorit, si dhe një ndjenjë e përgjithshme e të qenit mbizotërues ndaj viktimës." (Ken Rigby, 2002).

Nuk ka dyshim se çdo shkelje ndaj tjetrit nuk mund të konsiderohet si ngacmim ose të marrë këtë epitet që në fillim. Përkundrazi, standardet duhet të jenë të disponueshme në mënyrë që të mund të bëjmë dallimin midis ngacmimit, shakasë, seriozitetit, dhe ato mund të kufizohen në këto parametra:

E qëllimshme – nëse dëmi është shkaktuar nga dikush, duhet të bëhet dallimi nëse ky dëm vjen si shkak i gabimit apo me qëllim;



Allahu e bëri devotshmërinë kriter të dallimit ndërmjet njerëzve. Askush nuk ka të drejtë të krenohet ndaj tjetrit, të pretendojë epërsi ndaj tjetrit, ta nënçmojë, ta ofendojë, e aq më pak t'i shkaktojë dëm të çfarëdo lloji qoftë, fizik, verbal, moral apo psikologjik.

Përsëritja – është e nevojshme që të dimë nëse ky veprim ka ndodhur vetëm njëherë apo është veprim i përsëritur;

Mosbalancimi i fuqisë – nuk ka dyshim se shfaqja e dëmit i të fortit ndaj të dobët, nëse është i qëllimshëm dhe i përsëritur, është vetëm ngacmim, por nëse ka dëm nga i dobëti ndaj të fortit, shpeshherë nuk interpretohet si ngacmim.

TË DHËNAT RRETH BULLIZMIT

Statistikat dhe studimet që trajtojnë këtë fenomen janë të shumta dhe të larmishme. Që të gjitha ato janë në pajtim se përmasat e bullizmit janë të mëdha dhe shtrijnë ndikimin e keq te individët dhe shoqëria.

Statistikat e fundit nga UNESCO - Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë - zbuluan se një çerek miliardë fëmijë në shkolla janë të ekspozuar ndaj bullizmit në shkollat e tyre, nga gjithsej një miliard fëmijë që studiojnë në mbarë botën. Studimi ishte kryer në 19 vende, dhe rezultatet e tij zbuluan përqindje trishtuese, duke përfshirë 34% të studentëve, të cilët iu nënshtruan një trajtimi të ashpër dhe 8% e tyre i qenë ekspozuar bullizmit çdo ditë.¹

Sipas hulumtimit të kryer nga “Pyper”, në raportin e tyre ndër të tjera paraqitet se:

“Prej të gjitha institucioneve arsimore, pjesëmarrësit konsiderojnë se dukuria e bullizmit më së shumti është e pranishme në shkollat e mesme (58.31%) dhe shkollat fillore (31.94%), si dhe në një përqindje më të vogël në universitet-kolegj (4.37%). Po ashtu, vlen të theksohet se prej të gjitha llojeve të pranishme të bullizmit në Kosovë, bullizmi verbal (55.79%) është konsideruar si lloji më prezent i bullizmit nga pjesëmarrësit, duke lënë pas atë kibernetik (25.16%), si dhe fizik (17.91%).”²

HISTORIA E FENOMENIT TË BULLIZMIT NGA KËNDVËSHTRIMI FETAR

Kushdo që mendon historinë njerëzore nga fillimet e saj e deri në kohën e sotme, përfshirë këtu edhe librat e shenjtë, sidomos Kuranin e shenjtë dhe Sunetin e pastër të Profetit a.s., do të vërejë se marrëdhëniet apo raportet e njerëzve njëri me tjetrin, ose me krijesat e tjera, nuk kanë qenë pa shkelje.

Nëse hulumtojmë dhe gjurmojmë fenomenin e bullizmit, do të zbulonim se ai filloi në kohët e lashta, nga Ademi a.s.. Kurani na tregoi se çfarë ndodhi midis dy djemve të Ademit, Habilit dhe Kabilit, ku Kabili ngacmoi vëllain e tij Habilin, që e kishte zili, e kërcënoi se do ta vriste, pastaj e vrau, dhe Zoti e përshkruan këtë krim në librin e Tij fisnik duke thënë: “Lexoju (Muhamed) atyre (jehudive e të tjerëve) ngjarjen e vërtetë të dy djemve të Ademit, kur të dy flijuan

Prej të gjitha institucioneve arsimore, pjesëmarrësit konsiderojnë se dukuria e bullizmit më së shumti është e pranishme në shkollat e mesme (58.31%) dhe shkollat fillore (31.94%), si dhe në një përqindje më të vogël në universitet-kolegj (4.37%).

kurbanë, nga të cilët njërit iu pranua. Ai (që nuk iu pranua) tha: “Unë do të të mbys ty” (Kabili i tha Habilit). E ai (që iu pranua) tha: “Allahu pranon vetëm prej të sinqertëve.” (El Maide, 27).

Pastaj vëllezërit e Jusufit a.s., gjithashtu e ngacmuan atë, kishin zili dhe në fund vendosën për ta hequr qafe, duke e hedhur në pus/bunar, siç na e përshkruan këtë ngjarje Kurani famëlartë: “Kur ata (vëllezërit) thanë: “Pasha Zotin, Jusufi dhe vëllai i tij, janë më të dashur te babai ynë se sa ne, ndërsa ne jemi grup (i fortë). Vërtet, babai ynë është në gabim sheshazi. Mbyteni Jusufin ose hidheni diku larg në një vend, e babai juaj t’ju dojë juve, e pas asaj (pendohuni), bëheni njerëz të mirë. Njëri prej tyre tha: “Mos e mbytni Jusufin, e në qoftë se jeni për të bërë diç, lëshoni atë në fund të bunarit, do ta marrë atë dikush prej udhëtarëve.” (Jusuf, 8-10).

Në përgjithësi, ndaj të dërguarve të Zotit kishte ngacmime nga njerëzit te të cilët ata ishin dërguar. Ata i përgënjeshtroan, i nënçmuan, i keqtrajtojnë dhe i sulmuan me fyerje, rrahje, shpërngulje dhe ndonjëherë edhe vrasje. Me një fjalë, ishin të bullizuar nga ata që nuk i besuan Zotin. Një sërë ajetesh nga Kurani na i përshkruan këto situata.

Edhe në kohën e injorancës, para se të shpallej Kurani, kishte ngacmime nga më të ndryshmet në raport me njerëzit e kategorive të ndryshme. Por, kulmi i këtij ngacmimi nga politeistët e Mekës ishte ndaj Profetit fisnik, Muhamedit a.s.. Pasi atij iu kumtua shpallja, ata e mohuan profetësinë e tij, ngase të qenët i varfër, jetim, i pashkolluar, i pa krahë (fuqi), në sytë e tyre (mushrikëve) nuk shihej i denjë për të qenë peygamber. Ja se si i përshkruan në Kuran Zoti i Madh fjalët e tyre: “Pastaj thanë: “Përse të mos ketë zbritur ky Kuran një njeriu të madh nga dy qytete?” (Ez Zuhraf, 31).

Ngacmimi e bullizimi ndaj Muhamedit a.s. dhe shokëve të tij vazhdoi edhe pas shpërnguljes së tij në Medinë. Veçse, në këtë periudhë, që të ofendonin, ngacmonin e bullizonin Profetin a.s. dhe shokët e tij, mushrikëvë, iu bashkuan edhe çifutët e Medinës dhe hipokritët. Këta nuk kursyen as jetën e tij, duke komplotuar vrasjen e tij, siç bën çifutët e Benu Nadirit, apo etiketimet e ulëta për familjen e Muhamedit a.s., siç ishte ngjarje e shpifjes (Ifkut), apo atë që bënte Ibën Seluli dhe të tjerët në raport me të Dërguarin a.s. dhe shokët e tij.

Andaj, bullizmi në format dhe ngjyrat e veta të ndryshme vazhdon edhe sot e kësaj dite midis individëve, grupeve, popujve dhe vendeve, duke u zvogëluar herë pas here dhe duke u intensifikuar herë pas here. Ajo që e bën atë edhe më të shëmtuar dhe të neveritshëm është se ende ekziston mes atyre që pretendojnë qytetërim, emancipim kulturor, përparimin, e mbi të gjitha edhe në mesin e shoqërisë

myslimane, të cilët përpiqen të punojnë në dritën e mësimave të Kuranit famëlartë dhe Sunetit të ndritshëm.

SHKAQET E BULLIZMIT

Pa dyshim nuk ka asnjë dukuri e fenomen shoqërorë e që të mos ketë arsye pse është shfaqur dhe pse është përhapur. Për ta njohur më mirë këtë fenomen, për t'i kuptuar përmasat e tij, e për të arritur trajtimin e duhur, është e nevojshme të zbulohen shkaqet dhe faktorët e përhapjes së tij, e që më pas mund edhe të mendohet zgjidhja më e mirë për të. Shkaktarët e ngacmimit mund t'i përmbledhim në disa më kryesore dhe jo të vetme, e të cilat janë:

DEFICITI I VLERAVE SHPIRTËRORE, FETARE DHE EDUKATIVE

Kushdo që gjurmon brendësinë dhe karakterin e ngacmuesve, do të zbulojë se shumica prej tyre janë të paditur, pak të informuar me mësimet fisnike fetare, nuk kanë aspak bagazh të virtyteve morale, të cilat do t'i pengonin ata nga kjo sjellje e turpshme. Në anën tjetër, kushdo që është i brumosur me mësimet fetare, moral të mirë, ose ka një nivel arsimor të ngritur, i vjen turp t'i etiketojë të tjerët dhe t'i ngacmojë ata. Muhamedi a.s. shpjegoi se besimi e pengon besimtarin që të ofendojë të tjerët dhe t'i ulë ata. Transmetohet nga Ebu Hurejra r.a., se i Dërguari a.s., ka thënë: "Kush beson Zotin dhe botën tjetër, të mos e dëmtojë fqinjin e tij. E kush beson Zotin dhe botën tjetër, le ta nderojë mysafirin e tij, e kush beson Zotin dhe botën tjetër, le të thotë diçka të mirë, ose të hesht." (Buhariu).

DALLIMI NË KRIJIMIN E TYRE

Ndonjëherë ndryshimet në ngjyrën e lëkurës, formës, tiparet dhe disa karakteristika fizike, si gjatësia, shkurtësia, handikapët, sëmundjet etj., mund të jenë arsye për bullizëm, dhe detajet e tyre janë si më poshtë:

DALLIMI NË NGJYRË

Pabarazia në ngjyrë (racizmi) shumë herë çon në ngacmime, dhe kjo ndodh shpesh midis personit të lëkurë të hapur (bardhë) ndaj personit me lëkurë të mbylltë (zezë). Kjo arsye është sa e lashtë, aq edhe moderne. Ka ndodhur para epokës së Pejgamberi a.s. dhe gjatë jetës së tij dhe deri më sot. Rasti më konkret është ai gjatë çlirimit të Mekës, kur ngjyra e zezë e Bilalit r.a., ishte shkak i ngacmimeve nga disa politeistë dhe ata që ishin të freskët në Islam, ku përçmuan dhe u tallën me ngjyrën e tij. Zoti Fuqiplotë zbriti ajetin kuranor: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijat), e Allahu është i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë." (El Huxhurat, 13).

DALLIMI NË FORMË DHE VEÇORI

Dallimi i një personi nga pjesa tjetër e shoqërisë në vendin ku ndodhet, mund të jetë një arsye për ngacmim nga të tjerët.



Prania e disa karakteristikave fizike të spikatura, si: gjatësia, shkurtësia, dobësia, obeziteti, paaftësia, sëmundja etj., bëhen shkaqe që ai të bëhet i pambrojtur ndaj bullizmit. Diç e ngjashme kishte ndodhur në kohën e Muhamedit a.s., kur ia kishte kërkuar Ibën Mesudit r.a. të hipte në një pemë, e të pranishmit kishin filluar të qeshnin me këmbët e tij. E i Dërguari a.s., iu tha: "Pse po qeshni?! Njëra këmbë e Allahut është më e rëndë në peshore sesa kodra e Uhudit." (Transmeton Ahmed).

Ngjashëm me këtë është ajo që kishte ndodhur nga Aisheja r.a., ndaj Safijes r.a., të cilën e përshkroi si të shkurtër. Atëherë i Dërguari a.s. i tha: "Ke thënë një fjalë, që po të përzihej me ujin e detit do ta kishte trazuar të tërin." (Transmeton Ebu Davudi).

DALLIMET NË RACE, NË PASURI, PUSHTET DHE FORCË

Dallimet në racë dhe dallimet në prejardhje mund t'i shtojnë individët dhe grupet që të ngacmojnë të tjerët, t'i ekspozojnë ata ndaj dëmeve dhe të jenë arrogantë. Por, edhe pasuria e një personi dhe forca e pushtetit është një arsye për të ngacmuar të tjerët dhe kjo çështje mund të shtrihet përtej individëve në vende dhe grupe.

Muhamedi a.s. ka thënë: "Arabi ndaj jo arabit nuk ka kurrfarë përparësie, e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të kuqit dhe për të kuqin ndaj të ziut, përveç në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhësit e Ademit, ndërsa Ademi e ka prejardhjen nga dheu." (Buhariu).

DALLIMI NË BINDJE FETARE DHE FRAKSION - MEDHHEB

Dallimet në fe, fraksion ose opinion mund të jenë një arsye për disa që të ngacmojnë të tjerët, dhe me të, ne gjejmë shpeshherë se gjuha e përçmimit dhe akuzës shkon deri aty ku në disa raste besimtarin e vendosin në kufër, e shpeshherë edhe si fasik, mynafik, renegat, etj.. Kjo dukuri në kohën e fundit është në rritje e sipër, sidomos kur një grup militantësh i rrjeteve sociale, të cilët nuk kanë përgatitje fetare adekuate, pa asnjë hezitimi marrin të drejtën e nxjerrjes së verdiktit për shumë çështje fetare, duke ngacmuar e bullizuar me personat

kompetent, e që janë të thirrur për të komunikuar, trasuar e sqaruar mësimet fetare islame.

BËRJA E NDONJË MËKATI APO LËSHIMI NË NDONJË KËRKESË HYJNORE

Një person i thjeshtë mund të bëjë një gabim ose një neglizhencë, dhe të tjerët do ta kritikojnë atë, do ta shajnë duke e nënçmuar, ofenduar e në raste duke e sulmuar fizikisht. Në disa raste kur Muhamedi a.s. kishte praktikuar normat sheriatike në raport me ndonjë besimtar, që kishte thyer kodin etik-sheriatik, të pranishmit kishin ofenduar e mallkuar, e i Dërguari i këshillonte ata të jenë të përbajtur në fjalorin e tyre.

LLOJET E NGACMIMEVE – BULLIZMIT

Bullizmi është dy llojesh: direkt dhe indirekt.

NGACMIMI – BULLIZMI I DREJTPËRDREJTË (DIREKT)

Ngacmimi i drejtpërdrejtë është një sulm i hapur që mund të jetë fizik dhe verbal (Dan Olueus, 1993). Shpesh kategorizohet në dy lloje:

Ngacmimi – bullizmi fizik

Ngacmimi fizik përfshinë sulme fizike, si goditja, shtytja, shkelmimi, therja me thikë, kafshimi, shtrëngimi, shkulja e flokëve, pështymja, shkelja në gishtin e këmbës së dikujt, mbyllja në një hapësirë të mbyllur, kërcënimi me armë etj.. Përfshinë gjithashtu veprime që e privojnë dikë nga sendet e tij personale, të tilla si marrja e sendeve pa leje, vjedhja, dëmtimi i qëllimshëm i një sendi etj., (Sally, 2012). Sheriati islam dekurajon çdo praktikë shtypjeje, sulmi fizik dhe kërcënimi. Islami nuk toleron asnjë formë bullizmi, pasi është një formë shtypjeje.

Kurani famëlartë thotë: “Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.” (En Nahl, 90).

Muhamedi a.s. ka thënë: “Pa dyshim, gjaku juaj, pronat tuaja dhe nderi janë të shenjta për njëri-tjetrin, sikurse shenjtëria e kësaj dite, në këtë qytet të shenjtë (Mekën) tuajën, në këtë muajin tuaj.” (Buhariu).

1.2. NGACMIMI – BULLIZMI VERBAL

Ngacmimi verbal përfshinë thirrjen, abuzimin, çnderimin, mallkimin, talljen, ngacmimin dhe kërcënimet verbale, etj., (Goodstein, 2013). Agresioni verbal është kur një ngacmues ngacmon dikë. Mund të përfshijë gjithashtu një ngacmues që bën kërcënime verbale për dhunë ndaj pronës personale të dikujt. Transmetohet nga Sa'id bin Zejd, se i Dërguari ka

“Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna. Ju këshillon ashtu që të merrni mësim.”

(En Nahl, 90)

thënë: “Lloji më i përhapur i kamatës është të flasësh pa të drejtë kundër nderit të një myslimani.” (Ebu Davud).

2. NGACMIMI – BULLIZMI INDIREKT

Ngacmimi indirekt është më delikat dhe përfshinë një ose më shumë forma agresioni, tjetërsim social, thashetheme, turpshëm, përjashtim të qëllimshëm, përhapje thashethemesh, duke bërë fytyra ose gje të turpshme pas shpinës së dikujt, duke dëmtuar reputacionin e dikujt dhe duke manipuluar rendin shoqëror, ndarjen ose distancimin e njerëzve nga njëri-tjetri.

Ebu Ejub el Ensariu transmeton se i Dërguari i Allahut a.s., ka thënë: “Nuk i lejohet myslimanit të ketë shkëputje të raporteve me vëllain e tij përtej tri netëve.” (Muslimi).

3. Ngacmimi – bullizmi social (p.sh., duke lënë një ose disa individ jashtë aktiviteteve sociale, duke i shpërfillur apo duke mos i ftuar në festat e ndryshme, prishja e miqësisë etj.).

4. Ngacmimi – bullizmi intim (p.sh. sjellje intime e padëshiruar fizike ose verbale, që përfshinë pohime intime eksplicite dashakeqe ose kontakte të padëshirueshme fizike që bëhen nga dikush në një mjedisi edukativ, që janë fyese dhe të pakëndshme dhe që e bëjnë që ai të ndjehet i turpëruar ose në siklet, etj.).

5. Ngacmimi – bullizmi virtual/ kibernetik, i cili është bullizëm që ndodh nëpërmjet dërgimit të mesazheve të bezdisshme, shqetësuese dhe kërcënuese përmes telefonit



apo internetit, nëpërmjet shërbimeve të rrjeteve sociale, nëpërmjet blogjeve e të tjera mjeteve të fushës kibernetike.

TRAJTIMI I NGACMIMIT – BULLIZMIT NËN DRITËN E ISLAMIT

Mësimet islame që derivojnë nga Kurani dhe Suneti, sugjerojnë një strategji për të reduktuar pasojat negative dhe shpeshhtësinë e bullizmit. Fillimisht Zoti në Kuran thotë: “O ju që besuat, nuk bën të tallet një popull me një popull tjetër, meqë të përqeshurit mund të jenë më të mirë nga ata të cilët përqeshin dikë tjetër, e as gratë me gratë e tjera, sepse mund të ndodhë që gratë e tjera të jenë më të mira se ato që përqeshin (duke nënçmuar njëri-tjetrin) dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me llagape. Pas besimit është keq të përhapet llagapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mizorë.” (El Huxhurat, 11).

Kurse i Dërguari a.s., në hutben lamtumirëse, ndër të tjera pati porositur: “...Vërtet gjaku juaj, nderi juaj dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj, ashtu siç është e shenjtë kjo ditë në këtë muaj dhe në këtë vend.” (Buhariu).

Po ashtu, Muhamedi a.s., ka thënë: “Myslimani është ai që të tjerët janë të qetë prej gjuhës dhe dorës së tij.” (Mutefekun alejhi).

Eliminimi i fenomenit të bullizmit kërkon socializimin e duhur të fëmijës që në moshë të vogël, krahas rolit të medias dhe shoqërisë në përballje me këtë fenomen të papranueshëm. Krahas rolit të shkollës, universitetit dhe të gjitha institucioneve brenda vendit për të ndërgjegjësuar njerëzit dhe për të tërhequr vëmendjen e tyre për ashpërsinë e këtij akti, ajo që duhet bërë është të fillohet që nga mosha e mitur.

Rritja e fëmijëve duhet të bëhet sipas parimeve etike dhe edukimin e tyre, në mënyrë që të kenë sjellje korrekte në raport me të tjerët. Edukatori ynë më i çmuar, Muhamedi a.s., i këshillonte kështu fëmijët, të rinjtë, burrat dhe gratë: “Askush nuk e përul veten për Zotin, vetëm se Allahu e lartëson atë”, duke flakosur vesin e mendjemadhësisë dhe krenarisë; “Nuk është nga ne ai që nuk mëshiron të vegjlit tanë dhe që nuk nderon të moshuarit tanë”, duke shpalosur solidaritetin dhe respektin ndaj të tjerëve; “Mirësia nuk gjendet te çdo gjë përveç se e zbukuron atë dhe nuk hiqet nga asgjë përveç se e shtrembëron atë”, duke mësuar së butësia është virtyti më i çmuar për të korrigjuar sjelljet; “I fortë nuk është ai që godet, por i fortë është ai që kontrollon veten kur zemërohet”, duke shpalosur se forca qëndron në vetëkontrollin tonë dhe të qenët i durueshëm kur përballesh me keqbërës.

Në anën tjetër, jemi të vetëdijshëm se në asnjë rrethanë nuk mund të konkludojmë se do të arrijmë të çrrënjoshim këtë dukuri nga shoqëria ku jetojmë. Por, me siguri se me një plan dhe politika të mirëfillta nga institucionet përkatëse shtetërore, dhe duke i involvuar edhe ato fetare, do të arrihet në kufizimin e saj dhe reduktimin maksimal. Andaj, pa vullnet të shoqërisë, e aq më shumë të politikës, dhe pa

involvimin e prijesve fetarë, që edukojnë shpirtin e individit, nuk mund të mendohet në sukses përballë këtij fenomeni. Në anën tjetër, institucionet përkatëse do të duhej të ndërmarrin edhe këta hapa:

- Monitorimin e vazhdueshëm të sjelljeve të bullizuesëve;
- Organizmin e seminareve edukative brenda shkollave, universiteteve;
- Domosdoshmëria e vëzhgimit të të rinjve në të gjitha nivelet arsimore nëpërmjet specialistëve të psikologjisë dhe sociologjisë;
- Qeveritë duhet të vendosin ligje strikte për këdo që praktikon bullizmin në të gjitha format e tij ndaj të tjerëve;
- Të inkorporohet brenda korikulës së arsimit para universitar lënda e Edukimit Fetar në të gjitha nivelit, dhe kjo të bëhet pas asnjë vonesë dhe në koordinim me bashkësitë fetare;
- Lejimi i organizatave të të drejtave të njeriut dhe institucioneve të ndryshme që të publikojnë programet e tyre ndërgjegjësuere për çdo fazë – moshë, sipas asaj që u përshtatet atyre.

PËRFUNDIM

Islami nuk toleron asnjë formë bullizmi. Mësimet fetare trajtojnë drejt atë që dinjiteti i njeriut është i shenjtë dhe nuk guxon të cenohet e degradohet nga askush. Andaj, të gjithë njerëzit janë të thirrur të jenë të respektueshëm ndaj njëri-tjetrit, pa marrë parasysh ngjyrën, gjuhën, besimin, pozitën dhe pushtetin që mund ta kenë. Mësimet islame tregojnë se një nga karakteristikat themelore të një myslimani është që të tjerët të jenë të sigurt nga dëmi i tij. Bile përkundrazi, Muhamedi a.s., e bëri këtë karakteristikë pjesë të përkufizimit të myslimanit, që nuk mund të ndahet prej tij, përndryshe ai nuk do ta meritonte epitetin mysli-man. I Dërguari i Allahut, pagja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Mysli-man është ai, nga gjuha dhe dora e të cilit janë të sigurt mysli-manët e tjerë.”

Literatura:

1. Kurani Fisnik, përkthim i kuptimeve të tij nga H. Sherif Ahmeti.
2. Sire En Nebevij, Ibni Hisham, Botues: Mustafa El Babij, Egjipt, Botimi i dytë, 1955.
3. Ahmed bin Ali el Bejhekiju, Shu'ab el Iman, Riad, 2003, Botues: Mektebeh El Rushd.
4. Olweus, Dan. (1993). Bullying at School: What we know and what we can do. USA: Black Well.
5. Goodstein, Phylliss Kaufman. (2013). How to Stop Bullying in Classrooms and Schools. NY: Routledge
6. Sally, Kuykendall. (2012). Bullying. California: ABC-CLIO LLC.
7. <https://www.akhbarona.com/religion/336953.html>
8. <https://islamonline.net/رمنتللأقرصأاحم-يفمألسإلأاقبس>
9. <https://www.seekerspath.co.uk/question-bank/character-moral/q-id0638-what-is-the-islamic-perspective-on-bullying/>
10. UNESCO (2017). “School violence and bullying” Published by the United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization. ISBN 978-92-3-100197-0. Online: <http://unesdoc.unesco.org/images/0024/002469/246970e.pdf>
11. <https://pikepamja.net/bullizmi-si-pjese%CC%88-e-shoqe%CC%88rise%CC%88-pasojat-dhe-lufta-kunde%CC%88-tij/>

“15 janari, në kujtesën time ringjall ndjenjat e trishtimit, dhimbjes dhe të tmerrit”

RRËFIMI I HOXHËS ISA EF. TËRSHANI PËR PËRBALLJEN E TIJ ME POLICINË SERBE DHE RRËFIMI I TIJ PËR MASAKRËN E REÇAKUT

Isa ef. Tërshani ishte imami që organizoi varrimin e 45 viktimave të masakrës së Reçakut, e cila tronditi mbarë botën. Kjo masakër ishte kryer nga regjimi i atëhershëm serb, më 15 janar të vitit 1999. 25 vjet më pas, përmes një rrëfimi, Isa Tërshani, tregon për atë periudhë të rënd për vendin, e sidomos për banorët e fshatit Reçak.

“Sa herë vije 15 janari, në kujtesën time ringjallen ndjenjat e trishtimit, ndjenjat e dhimbjes dhe ndjenjat e tmerrit nga ish-okupatori serb, i cili pamëshirshëm masakroi mbi 40 viktima, qytetarë apo banorë të fshatit Reçak. Sa herë flas për këtë ngjarje tragjike, si duket fillon zemra të më rrah më shpejtë, sikur gjaku fillon të më qarkullojë më shpejtë në damarët apo enët e trupit tim dhe më dridhet zëri kur kujtoj ato ditë të tmerrit, ato ditë të dhimbjes, por njëkohësisht edhe ditët e krenarisë se ata burra dhe ato gra heroikisht sakrifkuan jetën e tyre për mbrojtjen e nderit, për mbrojtjen e vatanit dhe për mbrojtjen e fesë.”

Nderi i xhamisë e familjarëve thyhet sërish pas krimit makabër. Afërsisht për një muaj viktimat nuk u varrosën, ndërkohë policia serbe pretendonte se nuk e kishte kryer këtë krim.

“Pasi është bërë masakra dhe trupat e tyre pasi janë larguar nga forcat paramilitare dhe ushtarake policore serbe, ushtarët dhe banorët e Reçakut i kanë sjellë kufomat në xhami, mandej si është e njohur beteja për kufomat është zhvilluar dy ditë. Është bërë një luftë e rreptë mes ushtrisë çlirimtare të Kosovës dhe forcave policore e ushtarake të Serbisë. Masakrën e dytë ata e bëjnë kur i marrin kufomat nga xhamia me pretekstin kinse për ekspertizë, për obduksion, sepse trillimet e tyre, propaganda e tyre ishin që ata nuk e kishin kryer këtë masakër, por masakra ishte kryer prej të tjerëve. Realisht me marrjen e kufomave shkelet apo thyhet nderi edhe i xhamisë edhe të masakruarve edhe i familjarëve.”

Në objektin ku atëkohë ishte stacioni i policisë, hoxhë Isa Tërshani, tregon se u përballë me presion të vazhdueshëm nga regjimi i atëhershëm serb. Ai, për tri ditë radhazi me orë

të tëra përmes formave të ndryshme të dhunës nga ana e policisë u tentua të bindej për diçka që nuk ishte e vërtetë. Po qëndrimi i tij karshi tyre ishte i vendosur dhe i qartë.

“Ditën e parë e kishim një varrim dhe ishim duke e përcjellë një kufomë për te varrezat. Erdhi një kompanjollë e policisë dhe afrohet e më thotë: “Hoxho duhet me ardh me neve në stacionin policor”, i them pse, më thonë: “kemi një bisedë me juve”. Them “iu kërkoj falje, por duhet ta kryej ceremoninë e varrimit, pastaj vij.” Pasi e përfunduam ceremoninë e varrimit, policia prisnin te varrezat, më morën në veturë dhe erdha këtu. Takimin e parë me policinë, me komandantin e atëhershëm, biseda e parë ishte: “Hoxho, a e di për rastin e Reçakut, për viktimat e tyre, kush i ka bërë, kush i ka masakruar, kush i ka vrarë?” Unë po i them që sipas informacioneve, ata janë vrarë nga ushtria dhe policia. Ata më thonë që kjo nuk qëndron, nuk



është e vërtetë, por ne të kemi ftuar këtu që ti duhet t'i varrosësh ato viktimat. Unë i tregoj që unë nuk jam imam i fshatit Reçak, ne kemi rregullore dhe akte normative, që asnjë imam, asnjë hoxhë nuk ka të drejtë të përziehet në terrenin e hoxhës tjetër, për një gjë të tillë duhet të kërkon leje nga qendra. Ishin shumë biseda, kishte mënyra të ndryshme të komunikimit deri në forma më të ashpra apo më të egra. Ndër të tjera më thonë, ti përcaktoi lokacionet, duhet dhjetë kufoma t'i varrosësh në Shtime, dhjetë në Petrovë, të tjerat në Mollopols. Sipas mendimit tim janë dy qëllime, e para është që të fshihen gjurmët e krimit, sepse nuk iu konvenonte pushtetit të atëhershëm një varrim dinjitoz, një varrim masovik. E dyta që pjesëmarrja të jetë sa më e vogël e qytetarëve dhe varrimi të mos ketë pompozitet, mirëpo një çështje të tillë ne nuk e kemi pranuar.

Ditën e dytë prapë kanë ardhur te xhamia më kanë marrë, më kanë sjellë këtu. Për herë të dytë pasi e kemi kryer bisedën e parë, taman kam shkuar të shtëpia dhe jam ulur në tryezë, në sofër edhe është servuar ushqimi, më kujtohet në ato momente nëna ime e ndjerë, taman e kam marrë kafshatën e parë e kam vendosur në gojë edhe po dëgjohet zilia e po më thonë familjarët që policia ka ardh. Unë u ngrita nga sofra edhe nëna më tha, o bir ha ushqim se ndoshta nuk kthehesh më. Edhe po i them jo nënë unë nuk kam bërë asgjë që të mos kthehem edhe u ngrita, sepse e dija përafërsisht reaksionet e policisë. Kur kam ardhur për herë të dytë atë ditë këtu, kanë qenë të vendosur shumë paramilitarë me shirita me ngjyra dhe të shkapërderdhur në oborrin e këtij stacioni policor dhe nuk më kanë marrë menjëherë me më dërguar lartë, por më kanë lënë përafërsisht një orë me ndej jashtë. Lëvizjet e tyre, sharjet, ofendimet kanë qenë prej më të ndryshmeve, me të vetmin

qëllim që në aspektin psikologjik mua të më lodhin apo të më frikësojnë.

Brenda asaj ditë, pra në ditën e dytë, tri herë më kanë marrë në stacion.

Dita e tretë ka qenë dita më kritike, në këtë ditë pesë herë radhazi jam marrë në këtë stacion.

Xhandarmëria serbe kanë qenë shumë, vinin, shkarkoheshin me kamionë të ndryshëm. Dita e tretë ka qenë aq e rëndë sa që ka ardhur deri në atë moment që komandanti i policisë thotë, hoxho deshte apo nuk deshte patjetër duhet t'i varrosësh.

Pas këtyre bisedave, unë kontaktova me hoxhën e ndjerë, mulla Mahmutin, i cili banonte në lagjen time dhe po i tregoj që unë kam qenë në bisedë informative te policia, ata kanë kërkuar prej meje që të bëj varrimin e viktimave të të masakruarve të Reçakut, unë iu kam treguar që nuk jam imam i xhamisë së Reçakut, imam atje është hoxha Mahmut Mahmuti dhe kam dëshirë që të mos keqkuptohem nga ju sidomos, që mulla Isa ka dashtë me e gjuajt pataten e nxehtë në anën time dhe fjalët e tij ishin këto: "O mulla Isë, mos u brengos, ma mirë të shkojë unë se sa të shkosh ti, unë i kam bërë do vite dhe nuk është dert për mua."

Pas gjithë asaj lufte të ashpër, ceremonia e varrimi u organizua në formën më madhëshore dhe viktimat u varrosën në mënyrë dinjitoze, ani pse edhe në atë ditë, policia serbe vëzhgoi gjithë procesin. Kolona të gjatë të njerëzve nga e mbarë Kosova dhe më gjerë morën pjesë në varrimin e viktimave duke dhënë një mesazh për gjithë botën.

"Kolona të gjata të njerëzve, kolonat e arkivoleve barteshin mbi supet e njerëzve, pritnin në radhë që të varroseshin në këtë

vend. Ishte një varrim shumë dinjitoz, ishte një varrim masovik. Ata njerëz nga qytete dhe vende të ndryshme të Kosovës edhe jashtë saj kishin ardhur atë ditë të ndajnë dhimbjen me banorët e Reçakut, me familjarët e viktimave.

Ka pasur një numër shumë të madh të namazfalësve, ku në mesin e tyre kanë qenë mbi 50 hoxhallarë, ka qenë edhe i ndjeri ish-myftiu dr. Rexhep Boja, i cili edhe i ka pri namazit të xhenazës, ka qenë edhe myftiu i





tanishëm, Naim ef. Tërnavë, kryetari i Këshillit të Bashkësisë Islame, Adem ef. Hoxha, e shumë e shumë hoxhallarë të tjerë.

Nuk ka qenë e lehtë me ardh në varrim, sepse punktet policore kanë qenë gjithkund. Ai guxim dhe ai vullnet i atyre qytetarëve është për admirim.

Prania e njerëzve ishte një infuzion shpirtëror për familjarët e viktimave, por edhe për të tjerët. Njëkohësisht ishte edhe një mesazh edhe për armikun, por edhe për faktorin ndërkombëtarë, sepse ne jemi ata të cilët nuk do të lejojmë asnjëherë që në këto troje të na sundojë dikush, jemi në gjendje që të sakrifikohemi me gjithçka që kemi vetëm e vetëm që të frymojmë lirshëm aty ku i madhi Zot na ka falë.

Prania e ish-ambasadorit Wilian Wolker ishte një stimulatorë shumë i madh, jo vetëm për familjarët e të masakruarve të Reçakut, por për të gjithë shqiptarët e Kosovës, sepse ai edhe në ditën kur ishte pranë të masakruarve e quajti krim kundër njerëzimit. Fjalimi i tij në ditën e varrimit ishte një fjalim shumë domethënës, njëkohësisht përçoi një mesazh shumë të fuqishëm edhe te faktori ndërkombëtarë për realitetin që po ndodhë në Kosovë, njëkohësisht edhe për pushtetin sepse këtu nuk do të tolerohet që njerëzit të masakrohen dhe të bëhet krim vetëm për shkak të identitetit të tyre, qoftë kombëtar apo fetar.”

Përjetimet e familjarëve ishin të rënda, Tërshani me dhimbje kujton disa nga momentet për të cilat thotë se nuk mund t'i harrojë kurrë.

“Asnjëherë s'më hiqet nga mendja nëna Sherife, e cila i kishte të vrarë edhe burrin edhe djalë. Është një banor i Reçakut, Ismet Emmini, ai kafkën e kokës së vëllait të tij e mbante në xhep të mbështjellë me gazetë, realisht nuk ishin vetvetja, as unë nuk isha vetvetja”.

Xhamitë dhe hoxhallarët në periudha të ndryshme kanë luajtur rol të rëndësishëm fetar e kombëtar. Hoxhë Isa Tërshani tregon për sfidat dhe përgjegjësitë që kishte në atë kohë.

“Sfidat kanë qenë të natyrave të ndryshme duke filluar prej atyre ekonomike dhe shpirtërore edhe sociale e shoqërore. Pra duke filluar së pari në periudhën prej viteve të 90-ta, angazhimi si hoxhë me xhematë në përafrimin e xhematit, gjegjësisht në aksionin e pajtimeve të gjaveve, pastaj dalja publike e UÇK-së dhe ishte sfida për neve kur xhematlinjtë na pyetshin çka mendoni për ushtarët, çka mendoni për luftën në opinionet dhe tubimet e hapura ishte një handicap që njeriu edhe atë që e mendon ta thotë, duhej të thuhej në forma të tërthorta dhe mënyra të ndryshme. Gjithashtu në një periudhë kohore e kemi pas edhe kur nuk kemi mundur me i falë kohët e namazit të gjitha se ishte aplikimi i orës policore.

Mua më kujtohet edhe një rast që ka qenë jashtëzakonisht shumë i rëndë ku ish-myezini im, dëshmor i kombit, Selim Selimi, një djalë i ri 17 vjeçar, më thotë, hoxhë jam i interesuar me shku me luftu për këtë vend me iu bashkëngjitë radhëve të UÇK-së, çka mendon, si të veprojë?

Nuk isha as ai që i them shko, as ai që i them rri, pse në radhë të parë ishte një djalë i ri, e dyta nuk e disha vendosmërinë e tij, e treta ishin hapësira të ndryshme që mendja shëtiste poshtë e lartë edhe përgjigja ime ishte që ti e ke prindin, e ke familjen, konsultohu me ta dhe vendos, inshallah Zoti të ndihmon.

Gjithashtu ligjëratat të cilat i mbanim në xhami, d.m.th. kishim obligim edhe fetar edhe kombëtar edhe moral, por edhe njerëzor, që xhematin ta frymëzojmë dhe edukojmë në frymën e atdheut, sepse ky është një parim fetar.

Njëkohësisht kemi pasur rast, njëherë më kujtohet sikur sot, kur ditë xhumaje, isha duke e mbajtur një ligjëratë dhe vjen një xhematli edhe më thotë, hoxho, policia te muri i xhamisë janë tuj të inqizu me një farë magnetofoni a kasetofoni, kështu tekstualisht më ka thënë, i them mirë ata e kryejnë punën e vet, ne e kryejmë punën tone.”

Në masakrën e Reçakut, më 15 janar të vitit 1999, forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe, vranë dhe masakruan 45 civilë shqiptarë, në mesin e të cilëve kishte edhe fëmijë, gra dhe pleq.

Shota Krasniqi

Vështrim mbi mendimin e Ukshin Hotit

Ma. Blerim Halili

DISA ASPEKTE TË MENDIMIT POLITIK E SOCIAL TË UKSHIN HOTIT

Ukshin Hoti është një ndër mendimtarët e rrallë shqiptar, i cili me mendimin dhe jetën e vet shndërrohet në pasqyrë të kujtesës dhe fatit kolektiv shqiptar. Analiza e jetës dhe mendimit të Ukshin Hotit bëhet më kuptimplote duke njohur kontekstin politik e social brenda të cilit ai u formësua dhe jetoi. Në një botë të ndëshkuar, të shtypur e të errët, regjimi i Sllobodan Millosheviçit me aparatit shtetëror serb, u vu në shërbim të ndëshkimit kolektiv, presionit sistematik, vrasjes e dëbimit të shqiptarëve, duke ndëshkuar kështu mendimin e lirë, identitetin shqiptar dhe dinjitetin e një populli të tërë. Serbia po përsëriste kështu gjenocidin dhe spastrimin etnik që kishte bërë në vitet 1912-13 e tutje disa herë mbi fshatrat e qytetet shqiptare. Shfaqja e mendimit dhe veprimtarisë së Ukshin Hotit, që shquhej me largpamësi e argumentim shkencor, pa dyshim përbënë një fat për botën shqiptare që po mbytej, pra në një rrethim në kuptimin fizik, por edhe politik, metafizik e moral të fjalës. Shfaqja, natyra dhe morali i mendimit dhe jetës së Ukshin Hotit, në planin e rezistencës kolektive shqiptare, është komplementare me shfaqjen e lëvizjes guerile, forcës mbrojtëse e kryengritëse, Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ndonëse njëra vendos premisat intelektuale e tjetra ato ushtarake të kthesës shqiptare, por që të dyja përbëjnë triumfin kolektiv moral e shpirtëror të botës shqiptare në ndryshim.

LEXIMI I PROBLEMIT SHQIPTAR NGA NJË KËNDVËSHTRIM HISTORIK

Sikurse tek autorët e tjerë të kësaj periudhe, fokusi teorik dhe shkencor i Hotit është mbi pozitën e shqiptarëve në Jugosllavi, të drejtat historike të tyre, e ardhmja e tyre si komb, e ardhmja e Kosovës si Republikë, raportet ndërmjet kombeve të ndryshme në Ballkan, ndikimi i Evropës dhe fuqive të tjera botërore në përcaktimin e fatit të popujve ballkanikë, kryqëzimet identitare dhe fetare në Ballkan, etj.. Padyshim, fokusi kryesor i Hotit ishte gjendja e shqiptarëve në Jugosllavi prej vitit 1981, duke e vlerësuar këtë si datë kthese.

Hoti niset nga premisa historike për të shpjeguar botën shqiptare dhe përballjen e saj me kombet e perandoritë. Sipas tij, historia shqiptare dëshmon se trojet shqiptare kishin një rëndësi strategjike për kombet, si romakët, bizantinët, turqit, rusët, gjermanët, italianët dhe francezët.

Sipas tij, historia shqiptare dëshmon se territoret shqiptare kanë pasur rëndësi të madhe strategjike për romakët, bizantinët, turqit, rusët, gjermanët, italianët, francezët, etj.. "Gjatë shekullit XIX dhe fillimit të shekullit XX, d.m.th. gjatë kohës së konstituimit të shteteve nacionale në Ballkan, sërish gjetën shprehje interesat globale të fuqive të mëdha. Në konfrontimin dhe thyerjen e ndërsjellë të interesave të të dy grupacioneve të Fuqive të Mëdha, të Boshtit Tripartitësh (Austro-Hungaria, Gjermania dhe pjesërisht-Italia) dhe të Aleancës (Rusia, - deri më 1917, Britania e Madhe dhe Franca), si dhe satelitëve të tyre të instrumentalizuar në Ballkan, erdhi

Ukshin Hoti është një ndër mendimtarët e rrallë shqiptar, i cili me mendimin dhe jetën e vet shndërrohet në pasqyrë të kujtesës dhe fatit kolektiv shqiptar.





deri te reduktimi i Shqipërisë në një Shqipëri viabël. Ndër shqiptarët, natyrisht, formimi i Shqipërisë u pagëzua si fitore e madhe e faktorit politik shqiptar.”¹ Por, kjo Shqipëri, thekson ai, nuk përmbushi aspiratën etnike-nacionale të shqiptarëve, por u bë si kompromis për të balancuar interesat e fuqive ndërkombëtare. “Duket qartë se politika globale e Fuqive të Mëdha në të kaluarën nuk e përgjysmoi Shqipërinë, siç mund të dëgjohet nganjëherë. Por e reduktoi në një Shqipëri viabël... për interesat e drejtpeshimit të forcave në Evropë. Shqipëria viabël e kishte kuptimin e ekzistimit të një prapavije të mjaftueshme për mbrojtjen e portave detare dhe të aftësisë për mbajtjen e vetes pa shpenzime të fuqive. Mirëpo, ajo nuk i përmbushte aspiratat legjitime të popullit shqiptar. Nga ky aspekt, mund të thuhet se çështjen shqiptare e krijuan Fuqitë e Mëdha dhe se ato, normalisht, do të duhej ta zgjidhnin. Mirëpo, Fuqitë e Mëdha nuk merren me zgjidhjen e çështjeve të tilla, pa pasur interesa të veta dhe sidomos jo pa u bërë iniciimi i zgjidhjes së një çështjeje nga vetë faktori politik shqiptar.”²

Kontekstin e krijimit të Shqipërisë dhe mos përmbushjes së planit nacional për formimin e një shteti gjithëpërfshirës shqiptar, Hoti e shpjegon në këtë mënyrë: “Historikisht, trojet shqiptare... por edhe më gjerë, ishin vend-ndeshje dhe vend-thyerje të interesave të fuqive të Evropës. Fakti se populli shqiptar globalisht u nda në dy e më tepër shtete, por në njërin i pavarur, e në tjetrin mbeti në fillim si pakicë kombëtare, e cila në periodën ndërmjet dy luftërave botërore kontestohet, ndërsa pas Luftës së Dytë Botërore herë u njoh si pakicë, e herë si kombësi, këtë e dëshmon më së miri. Austro-gjermanët e përkrahën formimin e shtetit viabël shqiptar, të cilin në bisedat diplomatike e kontestonin rusët, kurse në terren serbët. Pozita e tanishme e shqiptarëve esencialisht është rezultat i thyerjes dhe i kompromisit midis këtyre dy etnikumeve (austro-gjermanëve dhe sllavëve), por edhe i presioneve të mëdha nga jashtë që e pengonin vlerësimin e drejtë dhe real të faktorit ndërkombëtar dhe

madje pjekjen e faktorit shqiptar, i cili duhej ta bënte një gjë të tillë në favor të interesave shqiptare.”³

RAPORTET NDËRMJET SERBËVE DHE SHQIPTARËVE

Teksa shpjegon potencialin dhe rritën e shqiptarëve dhe serbëve si kombe, në kërkim të filleve të antagonizmave dhe përplasjeve ndërmjet tyre, Hoti mohon të ketë epërsi reale serbe mbi shqiptarët, madje sipas tij, nuk mund të ketë. Me argumente demografike dhe socio-ekonomike, ai vë në dukje se shqiptarët dhe serbët nuk dallojnë në hierarkinë botërore, që të kenë raporte sunduese ndaj njëri-tjetrit, prandaj duhet të jenë të barabartë. Sipas tij, epërsia potenciale e shfaqur ndonjëherë gjatë historisë nuk bazohet në premisa reale, por në ndërhyrjen e interesave të palëve të treta. “Shqiptarët dhe serbët janë kombe, të cilat për afërsisht nuk kanë pasur diferenca të mëdha, as në nivelin e zhvillimit të tyre global, as në numër të popullsisë (i takojnë kategorisë së kombeve relativisht të vogla); nuk kanë pasur religjion të vetin (ortodoksizmi u lind në Bizant, katolicizmi në Romë, ndërkaq islamizmin ua sollën otomanët). Andaj nuk kanë pasur mundësi (pa marrë parasysh përpjekjet e vona të serbëve), që atë ta shndërrojnë në instrument të ekspansionit sikurse kombet e tjera të mëdha. Historikisht pozita e tyre në dukje pak më e privilegjuar në raport me njëri-tjetrin, ishte gjithmonë rezultat i prezencës së interesave të huaja (otomanët, rusët, gjermanët, francezët etj.), por jo i rritës së shpejtuar autentike të njërit ndaj tjetrit... raportet midis tyre nuk mund të jenë raporte të hierarkisë, por të barazisë së plotë, jo raporte të përbuzjes, por të respektit të plotë reciprok të identiteteve të tyre.”⁴

MOZAIKU QYTETËRIMOR DHE KONTEKSTI SPECIFIK I KOSOVËS

Hoti vë theksin edhe te mozaiku qytetërimor dhe politik i Jugosllavisë, ku pikëtakohen fuqitë botërore: “Jugosllavia në

tërësi ishte vend specifik, strategjikisht e lidh Evropën me Azinë, Lindjen me Perëndimin, Paktin e NATO-s me Traktatin e Varshavës; politikisht, i ndante dy sistemet globale: të kapitalizmit dhe të socializmi; në pikëpamje të kulturës, i gërshetonte tri religjione (katolicizmin, ortodoksizmin dhe islamizmin) dhe dy civilizime (të Perëndimit dhe të Lindjes). Ndërkaq, Kosova, jo vetëm që i reflektonte të gjitha këto kundërthënie e ndikime, por i kishte edhe të vetat, specifike: në pikëpamje strategjike, mund të shndërrohej në garnizon të shkëlqyer ushtarak për ruajtjen e vijave të rëndësishme Lindje-Perëndim dhe anasjelltas; politikisht, reflektonte vetëqeverisjen me socializmin radikal; në pikëpamje të kulturës, jo vetëm që gërshetonte religjionet dhe civilizimet, por vetë shqiptarët, megjithëse i mbanin ato në vete me shekuj, kishin arritur të mbeten të vetes. Mbi të gjitha, Kosova i reflektonte kundërthëniet midis zhvillimit dhe ngecjes. Për këto shkaqe, pozita e saj strategjike, në literaturën ndërkombëtare politike, e përshkruar si “area of potential crises”, nuk do të duhej të përkthehej si “hapësirë e krizave potenciale”, por si hapësirë e bombardimit permanent të kundërthënies dhe të ndikimeve në fjalë.”⁵

“KOMPONENTI RELIGJIOZ” DHE E ARDHMJA E KOSOVËS

Një nga temat që Hoti trajton me kujdes është edhe identiteti fetar i shqiptarëve, përkatësisht komponenti religjioz, të cilën ai e sheh në një kontekst më të gjerë evropian e po ashtu edhe në atë qytetërimor. Pikëpamja e tij për fatin e religjionit në botën shqiptare është edhe normative edhe praktike. Ai nuk i përket opusit të intelektualëve që e mendojnë fenë si të vjetruar, të padobishme dhe që duhet braktisur kolektivisht. Ai “ia gjen” rolin dhe modalitetin asaj edhe në kontekstin e botës shqiptare me orientim perëndimor, duke theksuar kështu rolin e tolerancës fetare dhe, siç thotë ai, “pikat e afërta ose të përbashkëta kristiano-islamike”. Sipas tij, komponenti religjioz ishte shpesh e pranishme në motivet e marrjes së vendimeve politike në arenën ndërkombëtare, përfshirë edhe ato për shqiptarët. “Politika e Fuqive të Mëdha në Ballkan në të vërtetë u formësua duke qenë e ndikuar edhe prej kësaj komponente. Operacionet luftarake dhe konferencat diplomatike në Ballkan dhe rreth tij Fuqitë e Mëdha i arsyetonin si luftë interesash në Perandorinë Otomane, dhe jo si copëtim të tokave shqiptare. Për to, formimi i një shteti relativisht të fortë shqiptar, me popullsi kryesisht të besimit islamik, do të paraqiste, shprehur simbolikisht, një pykë aziatike në tërësinë e krishterë të Evropës. As atëherë dhe as sot, komponenti religjioz nuk u konsiderua si relevante për diskutime në argumentimin politik, por kjo nuk do të thotë se ishte më pak prezentë në refleksionet dhe motivet e nxjerrjes së vendimeve politike... Andaj ndonëse shqiptarët nuk kanë asgjë të përbashkët me fundamentalizmin islamik, është fare lehtë, ndonëse jo korrekte, t’u mvishet ai si hipotekë. Këtë hipotekë nuk mund ta heqim vetëm duke e theksuar areligjiozitetin e njohur

shqiptar, (religjioni konsiderohet si arritje e qytetërimit), por duke u mbështetur në traditën e rrallë të tolerancës fetare, duke e kërkuar vendin e vet në pikat e afërta ose të përbashkëta kristiano-islamike dhe duke e avancuar rolin e vet në afirmimin e mentaliteteve dhe të botëkuptimeve të të dy sistemeve të mendimit religjioz dhe politik.”⁶

Në këtë kuadër, vendin e Kosovës, krahas të drejtës për t’u kompletuar si komb i Evropës, Ukshin Hoti, e sheh në Evropë, me orientim perëndimor, duke e parë kështu problemin e Kosovës, siç bën edhe Rexhep Qosja, si problem i një kombi të ndarë në Evropë. “... Evropa do të duhej ta jepte provimin, a vlejë vallë të drejtat njerëzore, e drejta e njeriut dhe parimet demokratike për të gjithë popujt e saj njësoj, apo vetëm për ata të krishterë? Populli shqiptar niset nga besimi i plotë se është popull i Evropës, njëri ndër më të vjetrit, dhe se parimet që vlejë për të tjerët do të duhej të vlenin edhe për të. Në këtë mënyrë, tashmë është në sprovë e sipër kriteri religjioz, kaheerë i injoruar dhe i harruar, në përcaktimin e statusit të popujve të Evropës.”⁷, vë në dukje ai.

PËRFUNDIM

Spektri i temave, çështjeve dhe pikëpamjeve që shkruan Ukshin Hoti në veprën e tij është shumë më i gjerë se kaq. Mendimi politik dhe social i Ukshin Hotit bazohet mbi premisa shkencore, logjike, demokratike dhe morale. I ndikuar edhe nga fusha e studimeve të tij, marrëdhëniet ndërkombëtare, ai fokusohet në politikën dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, në kuptimin shkencor të tyre dhe në mënyrën e realizimit të politikës në shoqëri. Ai analizon në thellësi kuptimin e politikës, shtetit, qytetarit, barazisë dhe të drejtave nga një këndvështrim kritik dhe historik për t’u fokusuar të çështja e Ballkanit dhe e Kosovës (shqiptarëve). Ai arrin me kujdes e vendosmëri të kontekstualizojë njohuritë e veta filozofike e shkencore nga teoritë e shkencave politike dhe të filozofisë, në arealin e botës shqiptare. E pikërisht kjo është puna e shkencëtarit, e një shkencëtari idealist që shkrihet me fatin e popullit të vet, siç thoshte Rexhep Qosja, e një “populli të ndaluar”. Prandaj Ukshin Hoti shënjon edhe forcën morale e metafizike të triumfit shqiptar në kërkim të lirisë e drejtësisë. Leximi e zbërthimi i mendimit të Hotit është i arritshëm vetëm me leximin e zbërthimin edhe të fatit të tij personal, ngase në narrativen e tij, ndërgjegjja e mendimi janë një; ai vë në shërbim tërë potencialin intelektual në shërbim të një kauze sa morale, aq edhe humane, të një ideje universale siç është liria, drejtësia dhe barazia.

1 Ukshin Hoti, Filozofia politike e çështjes shqiptare, “Unikomb”, Prishtinë, 1994, f. 78.

2 Po aty, f. 75.

3 Po aty, f. 89.

4 Po aty, f. 101.

5 Po aty, f. 111.

6 Po aty, f. 90.

7 Po aty, f. 126.



Kontributi i grave në shkencën e tefsirit përgjatë historisë

Anisa Hoti

Gratë, si pjesë e shoqërisë myslimane, kanë treguar interesim në mësimin e fesë islame në përgjithësi e Kuranit në veçanti, e sidomos roli dhe kontributi i nënave të besimtarëve është i pamohueshëm.

Allahu i Lartësuar e ka zbritur Kuranin te njeriu më i mirë në tokë, Muhamedi a.s., duke i dhënë atij detyrën e përcjelljes së relevatës hyjnore te të tjerët. Deshi Zoti që personi i parë që i dëgjoi fjalët e Zotit dhe pranoi mesazhin hyjnor nga ymeti i Pejgamberit tonë, të jetë pikërisht një grua. Ishte ajo Hatixheja r.a., e cila jo vetëm që e pranoi Islamin, por e përkrahu Pejgamberin a.s., që në momentet e para, kur atë akoma nuk e kishin lëshuar ethet e nuk i kishte pushuar dridhja që e kishte pasur nga shpallja. Në ato momente, kur Pejgamberi a.s. kishte frikë për veten e tij, ajo i tha: “Jo, për Allahun! Allahu kurrë nuk do të të poshtërojë e të turpëroj ty!”¹

Komentimi dhe interpretimi i Librit të Shenjtë ka qenë dhe do të mbetet gjithnjë pasuri e thellë shkencore dhe fetare. Në këtë fushë thelbësore, ashtu si në të gjitha fushat e tjera, gratë kanë shfaqur një kontribut të jashtëzakonshëm, i cili ka pasur një ndikim të thellë në trajtimin e temave të ndryshme fetare dhe shoqërore, gjithherë duke e vënë në pah nxitjen e Islamit ndaj avancimit të gjinisë femërore dhe rolit kyç që ajo ka në çdo shoqëri. Sami Frashëri ka thënë: “Gruaja është themeli i shoqërisë njerëzore, është shtylla e moralit të përgjithshëm, ajo është lulishtja e njerëzimit. Ai popull që i ka gratë e edukuara, është i edukuar.”²

Gratë, si pjesë e shoqërisë myslimane, kanë treguar interesim në mësimin e fesë islame në përgjithësi e Kuranit në veçanti, e sidomos roli dhe kontributi i nënave të besimtarëve është i pamohueshëm. Kush lexon në fushën e tefsirit, është e pamundshme të mos ketë

dëgjuar për medresenë e Aishes, e cila dha kontribut të madh edhe në shkencën e tefsirit.

Aisheja r.a. ishte një personalitet i arsimuar dhe me njohuri të gjerë. Ajo e ka mësuar Kuranin me Pejgamberin a.s., si dhe e ka njohur hallallin dhe haramin. Poezinë, gjenealogjinë (originën e familjes), dhe historinë e arabëve e ka mësuar nga babai i Ebu Bekrit r.a., i cili ishte nga njerëzit më të ditur edhe para se ta pranonte Islamin. Ajo gjithashtu kishte njohuri të mira edhe në mjekësi. Arsimimi i saj ka filluar shumë herët dhe ka qenë konstant. Imam Dhehebiu e ka cilësuar si gruan më të ditur të ymetit. Nuk ka pasur si ajo në njohuritë e saj në fe dhe dispozitat e fesë, sepse shpeshherë ishte me Pejgamberin a.s.. Ajo e ka kuptuar se myslimania e vërtetë duhet të mësojë rregullisht, andaj ajo gjithë kohën e saj, përveç obligimeve elementare të gruas, ia kushtoi studimit të diturive të ndryshme.³

Si gruaja e Pejgamberit a.s., ajo konsiderohet gjithashtu si mufesirja e parë femër në historinë islame. Kontributet e Aishes nuk kufizohen në çështjet e grave, por përfshijnë gjithashtu aspekte ligjore, sociale, politike dhe të tjera.⁴

Pas vdekjes së Pejgamberit a.s., rolin e interpretuesit të fjalës së Allahut xh.sh. e morën përsipër sahabët më të arsimuar, në pajtim me dijen dhe mundësitë e tyre. Në mesin e tyre shquhej edhe Aisheja r.a..⁵ Shtëpia e saj u shndërrua në një shkollë, medrese, ku njerëzit, burra e gra, të mëdhenj e fëmijë, të pasur e nevojtarë, hynin e dilnin për të mësuar fenë, për ta mësuar Kuranin.



Ishte Aisheja r.a., ajo që kur pyetej për diçka, i adresonte njerëzit në Kuran. Kur dikush e pyeti për namazin e natës të Pejgamberit a.s. ajo ia ktheu: “A nuk e ke lexuar suren Muzemil?!⁶”

Pastaj, Aisheja i mësonte njerëzit që Kuranin të komentonin me sunet, e shembujt për këtë janë të shumtë. Shembull për këtë ishte ajeti kuranor, ku Allahu i Lartësuar thotë: “Dhe prej errësirës së natës kur ngryset plotësisht.”⁷ Këtu, për një pjesë të njerëzve ishte e paqartë se çka do të thotë fjala “gaasikin idha vekab”, andaj Aisheja nuk hezitoi që këtë t’ua shpjegonte nga suneti i Pejgamberit a.s., duke thënë: “Kur Pejgamberi a.s. e pa hënën më tha: Oj Aishe, kërko mbrojtjen e Allahut prej saj, ngase kjo është ajo që ngryset plotësisht.”⁸

Shkaku i diturisë së saj të madhe edhe në gjuhë arabe, ajo komentonte Kuranin edhe në aspektin gjuhësor, apo “Tefsir el lugavij” siç njihet te mufesirët e mëvonshëm. Ka transmetime se Aisheja dhe Umu Seleme, e kanë shpjeguar fjalën “kuruu” në ajetin: “E ato gra që janë shkurorëzuar janë të obliguara të presin tre menstruacione...”⁹ me pastërti e jo cikël, edhe pse ka mendime të ndryshme të dijetarëve.¹⁰

Përgjatë historisë islame ka pasur gra që janë marrë me shkencën e tefsirit, ani pse numri i burrave është dominant, prapë kontributi i grave dhe roli i tyre nuk mund të mënjanohet. E përmendëm Aishen r.a., shkaku i vlerës si nënë e besimtarëve dhe kontributit të madh të saj, por ka pasur edhe gra të tjera që janë marrë me dituri, mësim të Kuranit e transmetime, e që kanë pasur nxënës të shumtë, ndër to janë:

Amrah bin Abdirrahman – lindi në kohën e kalifatit të Othmanit r.a.. Ka mësuar shumë tek Aisheja r.a. dhe llogaritet

bartësja e njohurive të saj, ngase është rritur në shtëpitë e nënave të besimtarëve. Kanë mësuar shumë prej saj, si Ibën Shihab ez Zuhrij, Amër ibën Dinari, Urveh ibën Zubejri etj.. Ka pasur interesim për dije, saqë Aishen e kishte pyetur edhe se si i kishte lënë gishtërinjtë Pejgamberi a.s. në namaz, të zgjeruar apo të bërë bashkë.¹¹

Vlerën e saj e tregon edhe rasti kur Omer ibën Abdulazizi vendosi t’i tubonte transmetimet e Pejgamberit a.s., pra t’i shkruante ato. Ai i dërgoi letër Ebu Bekër ibën Hazmit, duke i thënë që personi i parë që i thotë që t’i tubonte hadithet nga ai është Amrah bint Abdirrahmani.¹² Kasim ibën Abdullahu i tha Ibën Shihabit: “O djalosh, po të shoh se po ke kujdes ndaj kërkimit të diturisë, a do të të tregoj për një thesar?” “Po si jo!” - i tha. “Atëherë shko e mos iu ndajë Amrës, se ajo është rritur brenda dhomës së Aishes!” - ia ktheu. Dhe njëmend kur shkoi e pa se ajo ishte një det që nuk shterej.¹³

Kur një herë kishte ndodhur në vjedhje në Medine, kishin vendosur t’i prehej dora e vjedhësit, ani pse shumat e vjedhur ishte më e vogël sesa ajo që duhej për të realizuar dënimin. Atëherë shkojnë e pyesin Amrën dhe i thonë se po punojnë me ajetin: “Vjedhësit dhe vjedhëses preuani duart, si shpagim i veprës që bënë, (kjo masë është) dënim nga Allahu. Allahu është i Fuqishëm, ligjdhënës i urtë.”¹⁴

Amrah i thotë se ajeti është në të përgjithshmen, por duhet ditur komentini e tij dhe masën që Pejgamberi a.s. e ka caktuar që t’i pritet dora vjedhësit dhe e sqaron situatën.¹⁵ Ngjarja përmendet në Muvetanë e Imam Malikut.

Nefise bint Hasan ibën Zejd ibën Hasan ibën Alij ibën Ebi Talib – ka vdekur më 208 hixhrij. Edhe kjo përmendet si gratë që ka pasur dije të jashtëzakonshme në shumë fusha e

dituri islame, e posaçërisht edhe në tefsir. Emri i saj përmendet te mufesirët e shquar, andaj edhe thuhet për të: “Nga gratë që ka bërë adhurim të vazhdueshëm e punë të mira, e paarritur në asketizëm dhe devotshmëri, dijetare e madhe e tefsirit dhe e hadithit. Ka lindur në Meke, ndërsa ka jetuar në Medine. Ka kryer tridhjetë herë haxhin. E ka mësuar përmendësh tërë Kuranin dhe e ka ditur komentimin e tij.”¹⁶

Në literaturë gjejmë edhe emrat e këtyre grave, si: Jasmine bint Saad (502 hixhrij), e cila përmendet në librin “El Mu’xhem el mufesirun”¹⁷ si dijetare, këshilluese dhe njohëse e tefsirit, pastaj gjejmë edhe Xhennan Bejkum (1070 hixhrij), vajza e Sulltanit Abdurrahim ibën Bejrur Han, ka arritur dije në shkencat e shumta që as burrat e as gratë e asaj kohe nuk kanë mundur t’i afrohen me dituri. Ka pasur edhe tefsirin e saj.

Pastaj është edhe Zejneb en Nisa, vajza e Sulltanit Muhji Din Ernek Zejb Almekrij, njëri nga mbretërit më të mëdhenj të Hindit. Ka vdekur më 1113 hixhrij. Ka qenë poete, hafëze, këshilluese dhe nga veprat e saj është edhe “Zejb et tefasir”, e që ishte përkthim i tefsirit “El Kebir” të Imam Rrazit nga gjuha arabe në atë perse. Ka mendime se ajo vetë nuk e ka përkthyer atë, por ka urdhëruar përkthimin e tij.¹⁸

Pastaj kemi edhe emra të ndryshëm të dijetareve bashkëkohore, që kanë kontribuar në shkencën e tefsirit, siç janë:

Zejneb Muhamed el Gazali – babai i saj ishte nga dijetarët e mëdhenj të Universitetit të Ez’herit, kështu që ajo u rrit në një ambient fetar. Ka mësuar te shumë dijetarë, ndër ta edhe te mufesirët, si: Abdulmexhid el Libani, Alij Mahfudhi etj.. Ka lënë shkrime të shumta, libra të ndryshëm, ndër to edhe “Esmallah el husna”, “Ejam min hajati” dhe në tefsir e ka komentimin e quajtur “Nadheraat fi kitabil-lah”, të cilin e ka kontrolluar dhe redaktuar dijetari i Ez’herit, Abdul Haj el Fermavij. Tefsiri i saj ka dy volume dhe është mjaft i bazuar te Kurtubiu dhe te të tjerët.¹⁹ Ndër përmbajtjet e rëndësishme në punën e saj është mbrojtja e të drejtave të grave duke i shpëtuar nga vlerat negative dhe inkurajimi i tyre që t’u përmbahen rregullave islame.²⁰

Feukije Ibrahim esh Sherbinij – është nga Egjipti. Tefsiri i saj është i pari i botuar nga Ez’heri.²¹ Tefsiri i saj quhet “Tejsir fi tefsir” dhe në të ka punuar mbi shtatë vjet dhe është në katër volume.

Fatimah Kerimaan Abdulatif Hamza – lindi më 1942 në Kajro. Pas kryerjes së fakultetit ka punuar në fushën mediatike të Ez’herit, andaj dituritë e saj i ka thelluar kur ka bashkëpunuar me dijetarët, si Imam Gazaliun, Shejh Sharavin, dr. Jusuf Kardavin etj.. Ka vepra të shkruara mjaft interesante, por ka edhe tefsirin e saj “El Lu’lu’ vel merxhan fi tefsir el Kuran” në tre volume. Ky tefsir i është botuar nga Ez’heri në vitin 2010.²² Mufesirët si Maverdiu, Zamahsheri, e prej më të rinjve, edhe

gruaja e parë, e cila e ka shkruar tefsirin Bintu Shati, stilit të Kuranit, i kushtuan kujdes jashtëzakonisht të madh.²³

Aisha Abdurrahman (1913–1998), e njohur si Bint esh Shati, është ndër gratë e para që ka qenë pioniere e interpretimit kuranor nga një këndvështrim femëror. Ajo aplikoi një qasje kontekstuale dhe më së shumti kritikoi interpretimet ortodokse të teksteve fetare. Ajo njihet gjithashtu si autore e librave të ndryshëm, duke përfshirë libra mbi biografitë e grave të familjeve të pejgamberëve. Libri i saj “Et Tefsir el Bayan li el Kur’an el Hakim” përbëhet nga interpretimi i shtatë kaptinave të xhuzit Amme.

Gra myslimane anekënd botës janë marrë dhe ende merren me shkencën e tefsirit, e që llogaritet ndër dijet më të çmuara, ngase është shpjegimi i fjalës së Zotit dhe prej tij nxirren të gjitha shkencat e tjera. Si përfundim, shohim se në ruajtjen dhe përcjelljen e kësaj feje madhështore kanë rol dhe kontribut të jashtëzakonshëm edhe gratë e këtij ymeti, të cilat kanë lënë gjurmë të pashlyeshme në historinë e Islamit.

- 1 Muhamed ibën Ismail el Buhari, “Sahih el Buhari, me komentimin e Ibën Haxherit”, përktheu: Agim Avdiu, Sh.B: Lebejke, hadithi nr.3, fq.8.
- 2 Sami Frashëri, “Gratë”, (Shkup: Logos-A, 2004), fq. 9.
- 3 Esmir Halilović, “Gratë e Pejgamberit”, 60.
- 4 Nur Saadah Hamisan, Norwardatun Mohamed Razali, “Al-Burhān Journal of Qur’ān and Sunnah Studies”, volume 5, nr.2, (August, 2021), 50-51.
- 5 Ahmed Adilović, “Kolosët e Shkencave të Tefsirit”, (Prishtinë, 2009), 9.
- 6 Transmeton Imam Ahmedi në Musnedin e tij, nr. 23748
- 7 El Felek, 3.
- 8 Grup autorësh, “Aishe umm el-muminin”, Ed dorar es senijeh, (botimi I, 2013), 197.
- 9 El Bekare, 228.
- 10 Grup autorësh, “Aishe umm el-muminin”, Ed dorar es senijeh, fq. 198.
- 11 <https://www.alukah.net/social/0/37991/> (Data e qasjes: 13.09.2023)
- 12 https://www.masrawy.com/islamayat/shakhsiat_hawl_rasul/details/2019/9/10/1632274/ (Data e qasjes: 05.09.2023)
- 13 Sijer alam nubela, vll. 4, fq. 508.
- 14 El Maide, 38.
- 15 <https://www.islamstory.com/ar/artical/3409882/>. (Data e qasjes: 15.09.2023).
- 16 Abdullah Zejut, “Xhuhuud el-mer’eti el-muaserah fi tefsir el-kuran el-kerim”, Lidhja e shkrimit: https://www.researchgate.net/publication/-353189323_jhwd_almrar_almasrt_fy_tfsyr_alqran_alkrym (Data e qasjes: 02.09.2023).
- 17 Libri: El Mu’xhem el mufesirin min sadr el islam hata asr el hadir - autor: Adil Nuvejhid - viti i botimit 1988.
- 18 Shiko: Po aty.
- 19 https://www.researchgate.net/publication/353189323_jhwd_almrar_almasrt_fy_tfsyr_alqran_alkrym (Data e qasjes: 03.09.2023).
- 20 Zaynab al Ghazali, “Nazarat Fi Kitab Allah” (Cairo: Dār al-Shurūq, 1994).
- 21 <https://al-maktaba.org/book/31871/14785> (Data e qasjes: 30.08.2023).
- 22 https://www.researchgate.net/publication/353189323_jhwd_almrar_almasrt_fy_tfsyr_alqran_alkrym (Data e qasjes: 02.09.2023).
- 23 Dr. Enes Kariq, “Hyrye në Shkencat e Tefsirit”, (Botoi: Siprint, Prizren, 2005), 160.

Muhamedi a.s. në letërsinë e divanit

Dr. Besir Neziri

HYRJE

Muhamedi a.s., zë një vend të rëndësishëm në kulturën, artin dhe letërsinë e çdo popullit, të cilët kanë përfaqëuar fenë islame dhe që kanë besuar atë si të Dërguar të Zotit. Shembullin më tipik të reflektimit të dashurisë ndaj Muhamedit a.s., e shohim në letërsinë e divanit, e cila është e formuar nën ndikimin e Islamit dhe e brumosur me dashurinë ndaj tij. Në letërsinë e divanit, ndikim dhe rol të madh ka luajtur bindja dhe synimi për të ndjekur të Dërguarin e Zotit dhe për të arritur ndërmjetësimin e tij, duke iu bindur urdhrave të Zotit që t'i bindemi Allahut dhe Pejgamberit,¹ të mos i kundërshtojmë urdhrat e Tij² dhe që t'i dërgojmë selat dhe selam atij.³ Në çdo gjini dhe formë të veprave letrare në letërsinë e divanit, hasim shprehje për respektin, dashurinë dhe përkushtimin ndaj të Dërguarit tonë, Muhamedit a.s.. Andej mund të thuhet se nuk ka asnjë njeri në botë që është aq shumë i lavdëruar dhe i dashur se sa Muhamed a.s., që çdo fazë e jetës së tij ka qenë burim i një forme letrare. Lindja, rritja, martesja, miraxhi (ngjitja në qiell), luftërat, mrekullitë dhe vdekja e tij, kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në fokus të veprave letrare përgjatë shekujve.

LETËRSIA E DIVANIT

Letërsia e divanit është njëra ndër periudhat me të rëndësishme të letërsisë së divanit, e cila është krijuar brenda kornizave të qytetërimit islam, nga fundi i shek. XIII, e deri në gjysmën e dytë të shek. XIX, krahas letërsisë arabe dhe perse. Krijimtaria e letërsisë së divanit, e cila zgjati për gjashtë shekuj, është shkruar në gjuhën turko-osmane me një numër të madh të fjalëve arabe dhe perse.⁴ Burimet kryesore të saj kanë qenë shkencat islame, si Kurani,

hadithi, fikhu, historia islame, historia e pejgamberëve, si dhe sufizmi.⁵

Perandoria Osmane kishte shtrirje në një hapësirë të madhe gjeografike në tri kontinente, dhe nën ombrellën e saj kishte elemente të ndryshme kulturore dhe etnike. Këto elemente kulturore dhe etnike kanë kontribuar në mënyrë të veçantë në krijimin dhe zhvillimin e letërsisë së divanit. Ndër ata që dhanë kontribut shumë të madh janë edhe shkrimtarët dhe poetët me origjinë shqiptare. Përveç Stambollit, që ishte qendër kulturore, ku dolën poetë të njohur dhe u zhvillua veprimtari e dendur letrare, kishte edhe qendra kulturore me rëndësi të veçantë edhe në vende të tjera brenda gjeografisë osmane, veçanërisht në Ballkan, ku shtrihen tokat shqiptare. Brenda tokave shqiptare u zhvilluan shumë qendra kulturore, si Tirana, Shkodra, Elbasani, Shkupi, Ohri, Manastiri, Prishtina, Prizreni, nga të cilat dolën shumë burokratë, poetë e shkrimtarë.⁶ Për krijimtarinë poetike dhe rëndësinë që i kushtojë asaj në vendet shqiptare, në mënyrë shumë profesionale e përshkruan Ashik Çelebiu, poet e biograf prizrenas i shek. XVI, në veprën e tij për biografinë e poetëve “Meshâ'irü'sh-shu'arâ”: “Rrëfëhet se fëmijës që lind në Prizren, para se t'ia lënë emrin, ia vejnë mahlasin (pseudonimin poetik). Fëmija që lind në Jenicen e Vardarit, kur i thotë bukës ‘mama’ i thotë në gjuhën perse. Ndërsa fëmija që lind në Prishtinë, lind me një vulë në shokë. Andaj kjo do të thotë që Prizreni është vendburim i poetëve, Jenice e Vardarit vend i persishtes, kurse Prishtina shtrat i administratës.”⁷ Ndër poetët shqiptarë që dhanë kontribut të çmuar në letërsinë e divanit janë: Prishtineli Mesihu, Prizrenli Suzi Çelebii, Jahja Bej Dukagjini, Ahmet Bej Dukagjini, Axhizi Sulejman Dede Shkodrani, etj..

Letërsia e divanit është njëra ndër periudhat me të rëndësishme të letërsisë së divanit, e cila është krijuar brenda kornizave të qytetërimit islam, nga fundi i shek. XIII, e deri në gjysmën e dytë të shek. XIX.

FORMAT LETRARE NË LETËRSINË E DIVANIT PËR MUHAMEDIN A.S.

Jeta, personaliteti, hadithet, luftërat dhe mrekullitë e Muhamedit a.s., kanë qenë një ndër burimet e pashtershme frymëzimi për poetët në letërsinë e divanit. Në fillim, në letërsinë arabe janë shkruar vepra që përshkruanin jetën e Muhamedit a.s., të cilat quheshin sira ose sijer. Me kalimin e kohës, filluan të shkruheshin forma letrare të veçanta për secilën fazë të jetës së tij. Në librat e sires është shpjeguar lindja e Pejgamberit a.s., fëmijëria e tij, martesja me Hatixhen r.a., profetësia, mrekullitë e tij, miraxhi (ngjitja në qiell), hixhreti (shpërngulja) dhe luftërat. Këto tema, të cilat janë shtjelluar gjerësisht në librat e sires, më vonë u bënë burim i formave të reja letrare si vepra të pavarura. Format kryesore letrare në vargje dhe prozë për jetën e Muhamedit a.s., që u formuan në letërsinë e divanit janë na‘t, muhammedijje, esmâ-ı nebi (emrat e Pejgamberit, a.s.), mevludi, mu‘xhizat, miraxhije, gazevati nebi (luftërat e Pejgamberit a.s.), hilje, ahlaku’n-nebi (moral i Pejgamberit a.s.), hixhretname (shpërngulja e Pejgamberit a.s.), shefaatname (ndërmjetësimi), dyzet hadithe, njëqind hadithe, një mijë hadithe.⁸ Disa prej tyre më të rëndësishme do të shtjellohen më poshtë.

NA‘T

Na‘t quhen poezitë e varguara me qëllim të lavdërimit të të Dërguarit të Zotit, Muhamedit a.s., duke përshkruar jetën, karakteristikat shpirtërore dhe karakteristikat fizike të tij. Vepra e parë e këtij zhanri u shfaq në letërsinë arabe, e cila ishte shkruar nga Esad Ebû Kerib el Himjeri, shtatë shekuj para lindjes së Muhamedit a.s.. Në kohën e Muhamedit a.s., poezi të zhanrit na‘t ka shkruar Ka‘b Bin Zuhejr me emrin Banet Suad, Imam Busiri, poezinë me emrin Kasîde-i Burde, por kanë shkruar edhe poetët e Pejgamberit a.s., Hassan bin Thabiti, Abdullah ibni Revaha, Kab ibni Maliku, Amir bin Sinani‘l Ekva. Ky zhanër i poezisë ka qenë i përhapur shumë edhe në letërsinë e divanit, saqë pothuajse të gjitha divanet me poezi kanë filluar me tevhid (poezi për Njëshmërinë e Zotit), munaxhat (lutje) dhe na‘t.⁹

Format kryesore letrare në vargje dhe prozë për jetën e Muhamedit a.s., që u formuan në letërsinë e divanit janë na‘t, muhammedijje, esmâ-ı nebi (emrat e Pejgamberit, a.s.), mevludi, mu‘xhizat, miraxhije, gazevati nebi (luftërat e Pejgamberit a.s.), hilje, ahlaku’n-nebi (moral i Pejgamberit a.s.), hixhretname (shpërngulja e Pejgamberit a.s.), shefaatname (ndërmjetësimi), dyzet hadithe, njëqind hadithe, një mijë hadithe.

MUHAMEDIJE

Muhamedijje quhen të gjithë ato vepra në vargje, të cilat shpjegojnë jetën e Muhamedit a.s.. Vepra më e njohur nga kjo formë letrare në letërsinë e divanit është vepra e Yazıcıoğlu Mehmed-it, e quajtur Muhamedijje.¹⁰ Kjo vepër është mësuar e lexuar shumë në tërë gjeografinë osmane, përfshirë edhe tokat shqiptare.

HILJE

Hilje është fjalë arabe dhe në kuptimin etimologjik do të thotë “zbukurim, stoli, bukuria e fytyrës dhe e shpirtit”. Ndërsa si formë letrare, hilje, quhen veprat që përshkruajnë karakteristikat fizike dhe shpirtërore të Muhamedit a.s.. Kurse në kaligrafi, hilje, quhen edhe tabelat me shkrime. Këtë lloj të formës letrare për herë të parë e hasim në letërsinë arabe, dhe është e ngjashme me veprat letrare të quajtura shemail. Dallimi mes tyre është se në veprat letrare shemail, jeta, sjelljet dhe gjendja shpirtërore e Muhamedit a.s., shpjegohet në një mënyrë më gjithëpërfshirëse sesa në veprat letrare hilje. Burimi kryesor i veprave letrare hilje janë hadithet.

Në letërsinë e divanit, veprat letrare hilje kanë filluar të shkruhen në formë të prozës, poezisë dhe në pllaka që nga shek. XV.¹¹

MEVLUDI

Mevlid apo mevlud quhen të gjitha veprat poetike që flasin për lindjen e Muhamedit a.s., në mënyrë të hollësishme. Në letërsinë e divanit, mevludi është një nga format letrare më të përhapura, sa që thuhet se ka mbi 100 mevlude. Mevludi i parë i njohur në letërsinë e divanit është mevludi i Ahmedit, i shkruar më 810/1407. Ndërsa mevludi i Sulejman Çelebiut, i quajtur Vesiletu’n-nexhat, i shkruar në vitin 812/1409, pati shumë ndikim të madh në letërsinë e divanit, dhe parapriu në shkrimin e shumë veprave të këtij lloji.¹² Kjo vepër i ka paraprirë shkrimit të shumë mevludeve edhe në gjuhën shqipe, të cilët janë shkruar nga personalitete të njohura në fusha të ndryshme të fesë dhe të letërsisë, si Hasan Zyko Kamberi, Ismail Fllaqi, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim

Dalliu, Tahir efendi Popova, etj.. Deri më sot njihen mbi 20 mevlude të shkruara në gjuhën shqipe.¹³

MIRAXHNAME

Miraxhname ose Miraxhije quhen veprat ose tekstet në vargje dhe prozë që flasin për ngjarjen e Miraxhit apo ngritjes në qiell të Muhamedit a.s.. Miraxhnamet, si formë letrare, në letërsinë turke kanë filluar të shkruhen që nga shek. XII. Në fillim, miraxhnamet ishin pjesë e veprave të siresë, pastaj më vonë u bënë vepra të pavarur si mevludi, hilja, etj.. Në letërsinë e divanit ka qenë traditë që poezitë që trajtonin ngjarjen e miraxhit të vendosen në divane dhe mesnevite, që nuk kishin përmbajtje fetare. Por me kalimin e kohës nga këto poezi u formua një formë e pasur letrare, ku poezitë në divane në formë të kasideteve quheshin miraxhije, ndërsa poezitë në veprat mesnevi në formë të mesnevide quheshin miraxhname.¹⁴ Ndër poetët që kanë shkruar miraxhije në divanin e tij është edhe Jahja Bej Dukagjini.

HIXHRETNAME

Hixhretname quhen veprat që bazohen kryesisht në ngjarjen e hixhretit, e cila ishte një nga kthesat më të rëndësishme në jetën e Muhamedit a.s.. Veprat të kësaj forme letrare si të pavarura, por edhe si pjesë e veprave të shkruara në forma dhe gjini të tjera letrare, në vargje apo prozë zë një vend shumë të rëndësishëm në letërsinë e divanit.¹⁵

GAZAVATI NEBI

Gazavati Nebi apo Gazanamet janë vepra letrare në vargje dhe prozë që përshkruajnë luftërat e bëra nga Muhamedi a.s., historitë e këtyre luftërave, si dhe heroizmin dhe fitoret duke përshkruar shpirti i një lufte të bërë me dashurinë ndaj Muhamedit a.s..¹⁶

MUXHIZATI NEBI

Muxhizati Nebi janë vepra letrare në prozë dhe poezi që përshkruajnë një ose më shumë muxhize të Muhamedit a.s.. Në disa raste janë pjesë e veprave nat dhe e disave veprave në formën mesnevi. Në letërsinë e divanit kanë filluar të shkruhen në shek. XIV dhe XV. Ndër muxhizet e Pejgamberit a.s., që janë trajtuar në këto vepra janë çarja e hënës, dalja e ujit nga gishtërinjtë e Pejgamberit a.s., biseda më qengjin, etj..¹⁷

DYZET HADITHE

Dyzet hadithet janë ndër veprat letrare në prozë dhe poezi më të përhapura në letërsinë e divanit. Kryesisht janë përkthime dhe komentime të haditheve të Muhamedit a.s.. Këto vepra janë shkruar më qëllimin e vetëm që të arrihet sihariqi i Muhamedit a.s., se “Kushdo nga ymeti im që mëson dyzet hadithe për fenë e tij, Allahu do ta ringjallë atë në mesin e fakihve dhe dijetarëve në Ditën e Gjykimit.” Në letërsinë e



divanit edhe në numër të vogël janë shkruar edhe vepra që përmbajnë njëqind hadithe dhe një mijë hadithe.¹⁸

Nëse shikojmë veprat letrare të letërsisë së divanit, si në vargje dhe në prozë, mund të shohim se çdo aspekt i jetës së Muhamedit a.s., si aspekti i moralit, karakterit, por edhe aspekti i pamjes së jashtme është trajtuar në këto vepra.

- 1 Muhamed, 47/33.
- 2 Nur, 24/63.
- 3 Ahzab, 33/56.
- 4 Ömer Faruk Akün, “DİVAN EDEBİYATI”, DİA....
- 5 Mustafa Mirza DEMİR, “Divan Edebiyatında Peygamber Sevgesi”, *Diyanet Aylık Dergi* 337 (Janar 2019), fq. 64-67.
- 6 Mehmet Ünal, “Sadiye Tarikatı Şeyhi Acizî Süleyman Dede ve Divanı”, *Uluslararası Sosyal Araştırmalar Dergisi*, 12 / 67 (2019), fq. 1069-1081.
- 7 Aşık Çelebi, *Meşâ'irü's-şu'arâ*, haz. Filiz Kılıç, Ankara: T.C. Kültür ve Turizm Bakanlığı Kütüphaneler ve Yayımlar Genel Müdürlüğü, 2018, fq. 11.
- 8 Mahmut Kaplan, “Divan Şiirinde Hazret-i Muhammed”, *Köprü*, 74/1 (2001), fq. 106-117.
- 9 Meliha Aydın, “On Altıncı Yüzyıl Türk Edebiyatı'nda Na't”, *Yüksek Lisans Tezi*, İstanbul Üniversitesi, 2018, fq. 43.
- 10 Po aty
- 11 Diba Bahadıroğlu, “Eski Türk Edebiyatında Allah ve Peygamber ile İlgili Edebi Türler”, <https://www.makaleler.com/eski-turk-edebiyatinda-allah-ve-peygamber-ile-ilgili-edeb-turler>
- 12 Kaplan, po aty.
- 13 Ramadan Shkodra, “Manifestimi i Mevludit në Kosovë (dikurdhe sot)”, *Përmbledhje kumesash nga sesioni shkencor (Prishtine, 22 prill 2009)*, Prishtinë: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, 2010, fq. 9.
- 14 Hasan Şener, “Türk Edebiyatında Mi'râciyye Geleneği ve Harputlu Rahmî'nin Beyân-ı Mi'râc Başlıklı Manzumesi”, *Fırat Üniversitesi Sosyal Bilimler Dergisi*, 26/2 (2016), 78-80.
- 15 Ferdi Kiremitçi, “Türk İslam Edebiyatında Manzum Hicretnâmeler ve Mustafâ Fevzi b. Nu'mân'ın “Hicret-i Habîb-i Rabbü'l-Âlemîn” Başlıklı Mesnevisi”, *Divan Edebiyatı Araştırmaları Dergisi*, 18 (2017), fq. 333-402.
- 16 Aydın, po aty, fq. 47.
- 17 Po aty, fq. 48.
- 18 Müzahir Kılıç, “Edebiyat Tarihi Bakımından Kırk Hadisler”, A.Ü. Türkiye Araştırmaları Enstitüsü Dergisi, 18 (2001), 93-95.

Kultura, keqkuptimet dhe ridizajnimi i vlerave

Imer Topanica

Në gjuhën e përditshme, nocioni KULTURË, përvидhet shpesh i mbërthyer për togfjalësh të ndryshëm që përpiqen ta klasifikojnë atë, përtej kuptimit të përgjithshëm – si një element që e shquan një shoqëri të zhvilluar.

Vetëm refuzimi i produkteve dhe gjërave që marrin vëmendje në rrjete sociale, në media online dhe televizione, nuk i zhveshë tërësisht këto nga pjesa e kuptimit që ngërthen në vetvete nocioni KULTURË për dikë, dikë. Por, pa mëdyshje, një pjesë të mirë të asaj që ekspozohet sot për sot në këto hapësira virtuale duhet flakur pamëshirë duke e klasifikuar thjesht si “për masat”. (Po i marrim mediat si referencë të kultivimit dhe ekspozimit të kulturës, meqë ato janë determinueset kryesore të kësaj ane shoqërore). Kaq fundja mund të bëjmë në një kohë të vrullshme të zhvillimit të teknologjisë informative, ndërsa përditë e më shumë vlerat kontestohen, përplasen, përthyhen, ri-dizajnohen e ekspozohen duke pushtuar dimensione të tjera, ndërsa në esencë gjakojnë ta ruajnë kuptimin e tyre origjinar, për të mos e rrudhur këmishën që e mbështjell personalitetin e individit, privatësia e të cilit tashmë është inegzistente, e për rrjedhojë, edhe shija e tij, e cenueshme.

Në gjuhën e përditshme, nocioni KULTURË, përvидhet shpesh i mbërthyer për togfjalësh të ndryshëm që përpiqen ta klasifikojnë atë, përtej kuptimit të përgjithshëm – si një element që e shquan një shoqëri të zhvilluar. Fjala vjen, “kultura jonë”, “kultura fetare”, “kultura e ushqimit”, “kultura e veshjes”, “kultura e komunikimit”, “kultura tradicionale”, e deri te varietetet që provojnë t’ia veshin një konotacion negativ, si “pseudo-kultura”, ose “anti-kultura”. E po, çfarë është KULTURA, dhe çfarë anti-KULTURA, e cila po i qëndruaka për karshi? Kjo është një çështje për të cilën nuk ka konsensus të qartë.

Le ta kujtojmë se në krye të herës, Sir Edwad B. Taylor – antropolog britanik, përkufizonte kulturën si “një tërësi komplekse që përfshin dijen, besimin, artin, ligjet, moralet, zakonet dhe çfarëdo mjeshtëri dhe shprehish të krijuara nga njeriu si anëtar i shoqërisë.”¹ Që atëherë, antropologjia, sociologjia, shkencat shoqërore e disiplina të ndryshme e kanë bërë KULTURËN pjesë të preokupimit vetjak.

Në fjalorët webster², fjala vjen, definicioni varion afër standardit të Taylor-it, si “besimet zakonore, format shoqërore dhe tiparet materiale të një grupi racor, fetar ose shoqëror”; pastaj edhe si “tiparet karakteristike të ekzistencës së përditshme (të tilla si devijimet ose mënyra e jetesës) të përbashkëta nga njerëzit në një vend ose kohë”; duke e përimtuar më tej si një mostër të marrë nga entitete të tjera më të vogla, si institucione, organizata, grupe të veçanta etj..

Antipodi i saj vihet karshi standardit të lartë që e gëzonte e para, të paktën deri në fund të shekullit të kaluar. Këtë antipod të këtij entiteti, antropologu nga Kosova, Arsim Canolli e nënvlerëson duke e nënvizuar me “k” të vogël, te libri i tij i njohur “Kultura K”.³

Çfarë edhe mund të shtrojmë si hipotezë në këtë fillim tonin është se, vërtet kufijtë ndërmjet dy K-ve, përfundimisht janë të paqartë.

NJË SIMULAKRUM VLERASH

Përvetësimi “i kulturës së lirë” nga mediat, është një investim i grupeve të fuqishme të interesit, të cilat kanë për qëllim ta homogjenizojnë shoqërinë. Duke i shtypur shtresat më kryeneçe, që refuzojnë të ushqehen me çdo gjë që hidhet në pjatën e



kulturës së masave, ato farkëtojnë produkte për këto të fundit, të cilat mandej mund t'i shtrijnë lehtësisht në treg, duke iu dhënë karakter masiv.

Dikur libri, biblioteka, teatri, galeria, e më vonë kinemaja, ruanin një standard vlerash të pakontestueshme, por të cilat janë luhatur si autoritete që me futjen në përdorim të internetit, përkatësisht rrjeteve sociale.

Në fakt, “kredoja” e KULTURËS në opinionin publik perëndimor, shpesh është vënë në krizë. Madje mund të themi se civilizimi perëndimor shquhet për një traditë përmbysjesh vlerash, e rigjallërim të të rejave. Shembull, arti jo gjithëherë klasifikohet si “i fisnikërisë”, ndonjëherë vlente parimi se “gjithçka çka artisti pështynë, është art”. Andaj Richard Appignanesi, Chris Garratt, Ziauddin Sardar dhe Patric Curry të libri “Postmodernizmi” pyesin me të drejtë: “Si u bë aq i vështirë e jopopullor arti avangardist modern i pranuar si standard institucional i shijes? Shije e kujt është ajo? Shije e galerive të artit, e muzeumeve, e agjentëve të shitjes së artit dhe publikut të tyre blerës. Shkurt: e tregtarëve të artit dhe koleksionistëve të tij.”⁴

Domethënë, në qoftë se në antikë, grekët, romakët dhe helenët e kishin të qartë çfarë ishte vlerë, në Mesjetë ai sistem u përmbys nga kisha, ndërsa në renesancë, vlerat që kishte konservuar kjo e fundit, u zhvlerësuan, duke e çuar Perëndimin drejt rrymave të reja (romantizëm, realizëm,

modernizëm, postmodernizëm etj), fundi i të cilave nuk dihej. Në çdo rrënojë të një sistemi vlerash të vjetër, mbinte një i ri, i cili rritej duke e kundërshtonte të parin. Ndërsa antika prodhonte art duke iu thurur lavde perëndive, mesjeta imponon sistemin e shenjtë, ndërsa periudhat pas saj, duke e kthyer vëmendjen nga njeriu, harrojnë Zotin, dhe kështu e humbin kuptimin.

Duke iu shmangë një shpjegimi kronologjik të lindjes dhe zhvillimit të kuptimit të nocionit, mund deklarojmë se fundi i shekullit të kaluar dhe fillimi i këtij shekulli, të paktën në sferën e artit, është futur në një rrugë çore.

“Duket se gjenealogjia e artit postmodern mund të shkëputet nga modernia vetëm në teori. Në kuptimin teorik nuk është kulmi por negacion, fjalë për fjalë, ‘fund i artit’”⁵, thonë autorët e librit “Postmodernizmi”. Për shembull ilustrues e marrin “Simulakrumin”, definicionin e së cilit e shpjegojnë kështu: “Simulakrumi arrihet atëherë kur dallimi ndërmjet përfaqësimit dhe realitetit – ndërmjet shenjave dhe gjësëndeve që ato u referohen në botën reale – të jenë shkatërruar”⁶.

Me këtë këta autorë konstatojnë shtegun pa krye në të cilën është futur arti perëndimor, e që njësoj si arti, edhe përditshmëria, iu nënshtrua një stili të lirë të jetesës, duke iu çelur rrugë eksperimenteve të pafundme, prej të cilave nuk ka shpëtuar as familja.

SHTEGU I KRIZËS SË VLERAVE

Plot mund të mos jenë të vetëdijshëm për kufijtë e kuptimit të nocionit KULTURË dhe përdorimit të QYTETËRIMIT si sinonim. Për një “rrezik të këtyllë” na vetëdijeson Ibrahim Kalin të libri i tij i famshëm “Barbarë, Modernë, të Qytetëruar”.

Ndër të tjera, Kalin na mëson se rrënja e nocionit KULTURË ka të bëjë me punimin e tokës. Së këndejmi, lidhja e nocionit me veprimtarinë e përditshme, me një lokalitet a hapësirë gjeografike, që është esenciale dhe ajo që e diferencon nga QYTETËRIMI.

Ndërsa e përvijon mendimin e tij nëpërmjet faktesh historike, na e rikujton se si këto dy nocione janë parë e kuptuar si sinonime edhe prej vetë perëndimorëve. Përfundim prej këtij konteksti, sipas tij, bënin vetëm gjermanët.

“Ndjekësit gjermanë të Nietzsche-s do ta zbatonin për rrethanat e tyre specifike këtë këndvështrim të tij duke bërë një dallim të prerë e të thellë mes “Kulturës Gjermane”, dhe “Qytetërimit Evropian”. Në këtë tension mund të gjenden kodet kulturore të nacionalizmit gjerman. Kundrejt qasjes kozmopolite, ekspansioniste dhe egocentrike të përfaqësuar nga Anglia dhe Franca, prijësit e opinionit gjerman jo vetëm kanë vënë në dukje se kultura gjermane është e ndryshme nga kultura angleze, franceze, spanjolle apo ruse, por se dallimi mes tyre është cilësor dhe burimor.”⁷

Kapitujt të zgjeruar mbi kulturën perëndimore, u paraprijnë atyre për kulturën dhe Civilizimin Islam. Ndryshe nga Perëndimi, Civilizimi Islam, sipas Kalin, ka shpërfaqur një kulturë që kudo ku është manifestuar, është ndërlidhur me librin, bibliotekat, dijen, pra ilmin.

Sipas tij, pak ta gërryesh Perëndimin, të nxjerr në shesh ngjyrën raciste, përjashtuese e egocentrike. A e merrni me mend që deri në mesin e shekullit XX, në metropolet perëndimore ekspozoheshin robërit afrikanë, të cilët trajtoheshin si kafshë, ose gjysmë njerëz?

“Pasioni për kopshtet njerëzore vazhdoi deri në mesin e shekullit XX. Në ekspozitën e përbotshme të organizuar në vitin 1958 në Bruksel, në fshat kongolez sërish u ekspozua në formatin e kopshteve njerëzore. Një fotografi e shkrepur aty do të bëhej një nga simbolet e këtij turpi njëqind vjeçar: një vajzë afrikane 5-6 vjeçe e veshur me rroba perëndimore dhe një grua e bardhë evropiane që i jep ushqim nga pas gardhit. Një buzëqeshje dhe lumturi e parrëfyeshme të evropianëve qytetarë që bëjnë sehir këtë skenë. Viti: 1958. Vendi: në qendër të Evropës. Kjo skenë e turpshme për njerëzimin, moralin e qytetërimin, zhvillohej në një truall që e konsideronte veten si atdhe të qytetërimit, të lirisë e të dinjitetit njerëzor.”⁸

Por Qytetërimi Islam erdhi dhe shpërfaqti një kulturë tjetër në të gjitha pikëpamjet. Duke mos qenë përjashtues por përbashkues, aspak ekspansionues por çlirues, përvetësoi çdo vlerë të mirë të cilën e hasi rrugës, dhe e pajtoi me parimet fundamentale e universale të vetat.

“Parimi i universalitetit të së vërtetës si parim bazë dhe orientues, ka luajtur një rol qendror në krijimin e një trashëgimie pluraliste qytetërimore”⁹, - shkruan Kalin.

Sot një pjesë e mirë e opinionit perëndimor është shumë e vetëdijshme për këto vlera. Empatia që shfaqin perëndimorët për ngjarjet në Palestinë dhe vendet e tjera, flet shumë. Ditëve të fundit, pikërisht shkak i këtyre zhvillimeve, nevoja për ta njohur Islamin prej afër nëpërmjet librit të shenjtë Kuranit, është rritur jashtëzakonisht shumë.

Shoqëritë perëndimore kanë vuajtur dekadave të fundit për shkak të ndryshimeve të mëdha demografike. Depërtimi i myslimanëve, veçmas si refugjatë nga zona të shumta luftës, ka qenë një tjetër faktor për nxitjen e kureshtjes.

E përjavshmja britanike “The Economist”, vite më parë, nxirrte statistika mjaft interesante që synonin t’i përshkruanin këto ndryshime.

Artikulli me titull “Belgium struggles to manage its burgeoning Islamic scene”,¹⁰ tërthorazi shpërfaqte indikacionin e këtij depërtimi kulturor, në zemër të Evropës: “Gjatë shtatë viteve të fundit, pjesa që zgjedh edukimin nga klerikët/mësues katolikë është zvogëluar nga 23% në 16%; ndërsa numri i nxënësve të interesuar për klerikët/mësues myslimanë është rritur nga 43% në 51%” – thuhej ndër të tjera në këtë artikull.

Konteksti i ri kulturor, për rrjedhojë, ka nxjerr një varg figurash që me kompetencë kanë dekonstruktuar propagandën perëndimore kundrejt Islamit. Trendi i konvertimeve në vendet evropiane viteve të fundit, ka qenë në rritje, krahas numrit në rritje të braktisjes së krishterimit.

PELLGU I BALLKANIT

Ballkani kaherë është parë si kufiri i dy civilizimeve. Shumë historianë kompetentë vënë në dukje faktin se përhapja e Islamit në viset e Ballkanit, ka gjetur paraprakisht një terren të përshtatshëm, sidomos te paraardhësit e shqiptarëve dhe boshnjakëve. Të dy popujt duket të kenë qenë ndjekës të doktrinës së Ariusit, një prifti mesjetar, i cili kundërshtonte me ashk idenë e trinitetit.¹¹

Përtej narracioneve të mëdha, mbetet fakt që kjo pjesë e Evropës është parë si udhëkryq i përplasjeve të forta ideologjike që prodhuan luftëra e gjakderdhje të mëdha. Sot ata që i popullojnë këto vise, rrëfimet për të kaluarën e tyre e ndërtojnë mbi mite. Mbase për shkak të komunizmit dhe dëmeve të pariparueshme që i shkaktoi te shqiptarët në aspektin e kujtesës kolektive, për rrjedhojë edhe në ruajtjen e identitetit, këta mbeten të fundit në krijimin e disa miteve.

Por ligjet universale ndaj së cilave nënshtrohet edhe kultura, thonë se: vetëm e vërteta mbijeton në fund të fundit. Kështu plot tendenca të reja për krijime mitesh të reja, janë të destinuara të dështojnë në një epokë kur shoqëritë e civilizuar merren me gjëra krejt të reja, ndërsa kanë kapërcyer urat e këtyre proceseve shekuj më parë.

Prandaj, trashëgimia popullore gojore, ritet, zakonet, veshjet, gjuha, letërsia, feja e kështu me radhë, përbëjnë vetëm disa shtresime identitare, të cilat nuk mund të ndahen nga njëra-tjetra, meqë pa to, një personalitet nuk ka kuptim. Me një fjalë, te KULTURA shqiptare zë vend qendror edhe Islami, ndër të tjera edhe si një faktor që nxiti dhe kultivoi ndjenjën e atdhedashurisë.

1 Tylor, Edward (1871), ORIGINS OF CULTURE; New York: Harper & Row, fq. 28

2 <https://www.merriam-webster.com/dictionary/culture>

3 Canolli, Arsim: KULTURA K, Akid, Prishtinë – 2009.

4 A. Richard, G. Chris, S. Ziauddin, C. Patric: Postmodernizmi, Rrokullija, Prishtinë 2010, fq. 51.

5 A. Richard, G. Chris, S. Ziauddin, C. Patric: Postmodernizmi, Rrokullija, Prishtinë 2010, fq. 54.

6 Po aty.

7 K. Ibrahim: Barbarë, modernë, të qytetëruar; Logosa, Shkup 2020, fq. 129.

8 K. Ibrahim: Barbarë, modernë, të qytetëruar; Logosa, Shkup 2020, fq. 118 -119.

9 K. Ibrahim: Barbarë, modernë, të qytetëruar; Logosa, Shkup 2020, fq. 253.

10 <https://www.economist.com/erasmus/2018/07/14/belgium-struggles-to-manage-its-burgeoning-islamic-scene?>

11 <https://en.wikipedia.org/wiki/Arius>

Reportazh nga vizita e Myftiut Naim ef. Tërnava në Arabinë Saudite

Me ftesë të ministrit të Ministrisë së Haxhit dhe të Umres së Arabisë Saudite, dr. Tevfik Rabiah, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnava, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, nga data 6 deri më 16 janar, qëndroi për vizitë në Arabinë Saudite. Kjo vizitë disa ditore ishte e mbushur me angazhime dhe aktivitete të shumta të Myftiu Naim ef. Tërnava. Pas arritjes në Xhide, delegacioni i BIK-ut, kreu ritualin e umres në Meken e bekuar.

Në ditën e dytë të qëndrimit në Xhide, Myftiu Tërnava, u prit në takim nga ministri dr. Tevfik Rabiah, ku nënshkruan marrëveshjen e Haxhit për vitin 2024, me të cilën rregullohet shkuarja e besimtarëve kosovarë për ta kryer haxhin.

Në këtë takim, Myftiu Tërnava, falënderoi autoritetet e Arabisë Saudite për lehtësimin e procedurave administrative për haxhitë anembanë botës, e në mesin e tyre edhe për besimtarët e Kosovës. Këto procedura në përgjithësi lehtësojnë dhe ofrojnë kushte më të mira për akomodimin, si dhe kujdes shëndetësor më cilësor për haxhitë.

Myftiu Tërnava, gjatë këtij takimi gjithashtu falënderoi ministrin për lehtësimet dhe kushtet e ofruara për vizitorët e dy vendeve të shenjta, të cilët gjatë vitit vizitojnë Arabinë Saudite për ta kryer umren. Myftiu Tërnava shprehu

gatishmërinë e plotë që ky bashkëpunim i frytshëm ndërmjet dy institucioneve të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ndërkaq, ministri Rabiah, shprehu fjalë miradije për organizatorët e Haxhit nga Kosova, Bashkësinë Islame të Kosovës, si organizatorët me traditë dhe si të vetmit institucion zyrtar në Kosovë. Ai tha se haxhitë nga Kosova janë gjithnjë të mirëseardhur në vendin e dy faltoreve të shenjta.

KONFERENCA PËR SHËRBIMET E HAXHIT DHE UMRES

Më 8 janar 2014, në Xhide të Arabisë Saudite filloi punimet Konferenca dhe Panairi për shërbimet e Haxhit dhe Umres. Në këtë Konferencë, me ftesë të ministrit të Haxhit dhe Umres, dr. Tevfik Rabiah, mori pjesë edhe delegacioni i Bashkësisë Islame të Kosovës, i kryesuar nga Myftiu Naim ef. Tërnava. Në këtë Konferencë morën pjesë ministra, krerë të institucioneve përgjegjëse për organizimin e haxhit nga më shumë se 80 vende.

Konferenca u hap nga zëvendësemiri i Rajonit të Mekës, princi Saud bin Mishal. Në fjalën e tij hapëse, ministri saudit i Haxhit dhe Umres, dr. Tevfik Rabiah, theksoi se janë nisur projekte për zhvillimin e infrastrukturës për vendet e shenjta



në vlerë më shumë se pesë miliardë rialë (rreth 1.3 miliardë dollarë).

Konferenca vazhdoi punimet deri më 11 janar dhe përgjatë zhvillimit të saj, u diskutuan iniciativat e shquara, produktet, shërbimet, projektet dhe investimet në teknologjinë inovative në sektorin e Haxhit dhe Umres.

Në margjinat e Konferencës, zyrtarët përgjegjës për rregullimin dhe menaxhimin e procedurave të haxhit nga Kosova, kryeimami Vedat ef. Sahiti dhe zv.kryeimami, Fatmir ef. Iljazi, zhvilluan takime dhe nënshkruan dokumentacione relevante në emër të BIK-ut.

TAKIMI ME MINISTRIN PËR ÇËSHTJE FETARE I ARABISË SAUDITE, SHKËLQESINË E TIJ, DR. ABDULATIF BIN ABDULAZIZ AL SHEIK

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, gjatë qëndrimit në Arabinë Saudite, u prit në takim edhe nga ministri për Çështje Fetare i Arabisë Saudite, shkëlqesia e tij, dr. Abdulatif bin Abdulaziz al Sheik.

Gjatë këtij takimi u shkëmbyen biseda të përzemërta dhe u diskutuan tema me interes të përbashkët lidhur me çështjet islame.

Myftiu Tërnavë, shfrytëzoi rastin që të falënderojë Qeverinë e Arabisë Saudite, në krye me mbretin Selman bin Abdulaziz, si dhe princin e kurorës, Muhamed bin Selman, për përkrahjen e ofruar nga shteti i Arabisë Saudite, si në të kaluarën ashtu edhe tash për integrimin e vendit në institucionet ndërkombëtare. Ai gjithashtu falënderoi ministrin për bashkëpunimin e ndërsjellë, si dhe shprehu gatishmërinë e plotë që ky bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Nga ana e tij, ministri Al Sheik, çmoi dhe vlerësoi lart vizitën e Myftiut Tërnavë, duke theksuar kështu faktin se Arabia Saudite, çmon lart vullnetin dhe sakrificën e popullit të Kosovës për liri, duke i dëshiruar kështu prosperitet dhe zhvillim.

FALJA E NAMAZIT NË BRENDËSINË E QABESË

Pas përfundimit të takimit me ministrin e Haxhit, ku edhe u nënshkrua marrëveshja e Haxhit për vitin 2024, me të cilën rregullohet shkuarja e besimtarëve kosovarë për ta kryer haxhin, ministri saudit përgëzoi Myftiun Tërnavë me një lajm të këndshëm, me përzgjedhjen e Myftiut Tërnavë për t'u falur në brendësinë e Qabesë, kështu që, pas përfundimit të seancës hapesë të Konferencës se Haxhit, krerët e disa delegacioneve të përzgjedhura pjesëmarrës, me ftesë të





ministrit të Haxhit, z. Tefvik Rebiah, vizituan Mekën e shenjtë ku iu ofrua mundësia ta vizitojnë edhe Xhaminë e Shenjtë, Qabënë.

Nën përcjellën e protokollin mbretëror dhe në një ambient imanor i mbushur me mallëngjim dhe përpulje ndaj Krijuesit Suprem, Allahut xh.sh., u privilegjuan dhe hynë në brendësinë e Qabesë së nderuar. Aty falen dy rekate namaz nafile, si dhe iu lutën Allahut xh.sh. për mëshirë, mbarësi dhe mirësi për gjithë globin.

Ajo që e bëri më madhështore këtë ngjarje, përveç së ishte e karakterit tërësisht fetar dhe me synim të përkuljes ndaj Krijuesit suprem, ishte madhështore për faktin së për herë të parë në historinë tonë kombëtare, u futën së bashku tre liderët shpirtëror fetarë të besimtarëve myslimanë në Qabe, ku bashkë me Myftiun e Kosovës, ishte kreu i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Bujar ef. Spahiu, dhe reisul ulema i Bashkësisë Fetare Islame të Maqedonisë së Veriut, Shaqir ef. Fetai.

VIZITA NË MEDINE

Pas qëndrimit katër ditorë në Xhide dhe Meke, delegacioni vazhdoi udhëtimin për në Medinë e ndritshme.

Gjatë qëndrimit në Medinë, Myftiu Tërnavë zhvilloi disa aktivitete dhe vizita, ku vizitoi Kodrën e Uhudit, Xhaminë Kibletejni, Xhaminë e Kubas, si dhe varrezat e Bekije. Ai gjithashtu shfrytëzoi qëndrimin në Medinë për të pritur grupin e parë të umrexhive kosovare për vitin 2024, të cilët erdhën për të kryer ritualin e umres nën organizmin e BIK-



ut. Ky grup përbëhej nga 44 persona dhe ata qëndruan në Medinë deri më 15 janar, ku më pas vazhduan vizitën në qytetin e Mekës.

VIZITA DHE FALJA E NAMAZIT NË RAUDAH SHERIFAH

Raudah, ose kopshti fisnik, është një zonë midis minberit dhe shtëpisë së Profetit tonë të dashur, Muhamedit a.s. dhe Ajshes r.a., që përfundimisht u bë dhoma e varrit. Ajo pjesë konsiderohet si një nga kopshtet e Xhenetit sipas thënies së Pejgamberit a.s..

Delegacioni i BIK-ut, në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë, pati fatin dhe privilegjin që të nderohet edhe me vizitën dhe faljen në Raudah në brendësinë e Xhamisë së Profetit a.s. në Medinë e ndritshme.

Në një vizitë speciale dhe protokollare, pas namazit të jaciesë, më 12 janar 2024, Myftiu Tërnavë u prit nga zyrtari i Haxhit në Medinë z. Bedër Meki, i cili e shoqëroi delegacionin e BIK-ut gjatë vizitës së Xhamisë së Pejgamberit a.s., ku në një ambient privat dhe enkas për delegacionin dërguan selame për Muhamedin a.s. dhe dy kalifët, Ebu Bekrin dhe Omerin r.a., si dhe falën namaz në Raudah, duke iu përkulur dhe lutur Allahut xh.sh..

Në shoqërim të Myftiut Tërnavë gjatë kësaj vizite në Arabinë Saudite ishin kryeimami Vedat ef. Sahiti, shefi i kabinetit të Myftiut, Besim ef. Mehmeti, zv.kryeimami Fatmir ef. Iljazi dhe Fatlum Podvorica.

Përgatiti: Mr. Besim Mehmeti

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM SHEFEN E UNMIK-UT, ZNJ. CAROLINE ZIADEH



Më 25 janar 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim shefen e UNMIK-ut, znj. Caroline Ziadeh.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka institucioni i Bashkësisë Islame të Kosovës me UNMIK-un, si dhe për mundësinë e intensifikimit të këtij bashkëpunimi

edhe në të ardhmen. Myftiu Tërnavë tha se si institucion mbesim të përkushtuar për një bashkëpunim të mirëfilltë, duke potencuar kështu gatishmërinë dhe përkushtimin e BIK-ut që në vend të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërfaqetare dhe ndëretnike.

Nga ana e saj, znj. Ziadeh, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe për përkushtimin e tij dhe të institucionit

që ai drejton për një bashkëpunim me misionin e UNMIK-ut në Kosovë. Ajo vlerësoi lart rolin dhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kultivimin e dialogut ndërfaqetare e ndëretnik, si dhe për promovimin e vlerave të tolerancës dhe të bashkëjetesës në Kosovë.

MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E AUSTRIËS NË KOSOVË, Z. GEORG SCHNETZER

Më 29 janar 2024, kryetari i BIK-ut, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ambasadorin e Austrisë në Kosovë, z. Georg Schnetzer.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që t'i urojë ambasadorit z. Schnetzer mirëseardhje në Bashkësinë Islame të Kosovës, e më pas edhe e uroi atë për marrjen e detyrës së re si ambasador, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme. Ai më pas e njohu mysafirin me historikun, misionin, punën dhe angazhimin e institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, që në vend të mbretërojë paqja dhe harmonia ndërmjet komuniteteve fetare. Myftiu Tërnavë gjatë bisedës përmendi edhe kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhënë në proceset e ndryshme në të cilat ka kaluar vendi ynë. Myftiu Tërnavë, nëpërmes ambasadorit z. Schnetzer, falënderoi shtetin e Austrisë për përkrahjen e vazhdueshme që ka pasur ndaj Kosovës.

Nga ana e tij, ambasadori z. Schnetzer, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen, e më pas edhe e përgëzoi atë dhe institucionin e Bashkësisë Islame të Kosovës për kontributin e tyre të dhënë

për mbarëvajtjen e jetës fetare në vend. Ai tha se mbesim në shpresë që takimet e përbashkëta dhe bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve të vazhdojë edhe më tutje.



MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM NËNKRYETARIN E KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS, Z. BESNIK OSMANIN

Më 29 janar 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim nënkryetarin e Komunës së Fushë Kosovës, z. Besnik Osmanin, i cili shoqërohej nga kryesuesi i Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, z. Ali Ismaili.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e mirë që ka Komuna e Fushë Kosovës me Bashkësinë Islame të Kosovës dhe me Këshillin e BI-së së Fushë Kosovës, për çka të dyja palët u pajtuan se një gjë e tillë duhet të vazhdohet edhe në të ardhmen, gjithnjë për të mirën e besimtarëve dhe qytetarëve tanë.

Nga ana e tyre, nënkryetari Osmani dhe kryesuesi Ismaili, shfrytëzuan rastin që të urojnë Myftiun Tërnavë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme.



MYFTIU TËRNAVA VURI GURTHEMELIN E XHAMISË NË FSHATIN TORINË

Më 3 janar 2024, në një ceremoni të organizuar nga banorët e fshatit, u vu gurthemeli i xhamisë në fshatin Torinë. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, me bashkëpunëtorë, kryetari i KBI-së në Lipjan Zaim ef. Baftiu, me bashkëpunëtorë, kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti me bashkëpunëtorë, banorë të fshatit, si dhe shumë pjesëmarrës të tjerë.

Myftiu Tërnavë në fjalën e tij, pas urimeve, tha: “Xhamia është institucion shumëdimensional dhe vend i bekuar, të cilin e do Allahu. Është vendi ku besimtarët kultivojnë nektarin e besimit, të cilin duhet ruajtur e duhet përcjell brez pas brezi.”

Kryetari i Komunës së Lipjanit, njëherësh banor i fshatit, Torinë, z. Imri Ahmeti, uroi bashkëfshatarët dhe

falënderoi udhëheqësit e BIK-ut për sigurimin e donacionit.

Kryetari i KBI-së së Lipjanit, Zaim ef. Baftiu, uroi banorët për fillimin e ndërtimit të xhamisë, duke falënderuar

banorët për kontributin dhe angazhimin e tyre në ndërtimin e saj.

Ndërtimi i kësaj xhamie është donacion i besimtarëve shqiptarë nga Londra.



MYFTIU TËRNAVA MORI PJESË NË PANELIN SHKENCOR ME TITULL “BULLIZMI - FORMAT, PASOJAT DHE PREVENTIVA”

Më 4 janar 2024, nën organizimin e Bashkësisë Fetare Islame të RMV-së, në ambientet e Medresesë “Isa Beu” në Shkup, u mbajt paneli shkencor me titull “Bullizmi - format, pasojat dhe preventiva”.

Në këtë ngjarje, të pranishëm ishin reisul ulema, h. Shaqir Fetahu, Myftiu i Republikës së Kosovës, Naim ef. Tërnavë, së bashku me sekretarin e BIK-ut, Ahmet ef. Sadriun.

Në fjalën përshëndetëse, Myftiu Tërnavë, foli mbi rëndësinë e stolisjes së karakterit me vlera morale, e mbi të gjitha që besimtari të jetë i respektueshëm, i afërt dhe i dobishëm për të gjithë rrethin ku ai jeton.

Reisul ulema, z. Fetahu, pasi u uroi mirëseardhje mysafirëve dhe panelistëve, vuri në spikamë që ky takim është vetëm fillimi i organizimeve të paneleve të ndryshme shkencore për të diskutuar çështjet që janë të rëndësishme për shoqërinë dhe besimtarët tanë. Ndërsa

panelistët në përbërje nga prof. dr. Ali Pajaziti, mr. Edlira Destani, mr. Jakup Çunaku dhe prof. dr. Muaz Agushi, trajtuan këtë tematike nga shumë perspektiva, si ajo sociologjike, psikologjike dhe atë fetare.

Si konkluzion i përbashkët doli që të gjithë, duke u nisur nga individ, familja, shoqëria dhe të gjitha institucionet, të merren seriozisht me këtë fenomen, në mënyrë që të arrihet

të reduktohet bullizmi, sidomos te fëmijët. Në fund, të gjithë panelistëve, në shenjë mirënjohje iu ndanë certifikata nga reisul ulemaja.

Kurse, drejtori i Medresesë “Isa Beu”, dr. Islam Islami, i ndau mirënjohje Myftiut Tërnavë për kontributin dhe bashkëpunimin e mirë që kishte me Medresenë “Isa Beu” derisa ishte në detyrën e drejtorit të Medresesë “Alauddin”, e në veçanti gjatë vitit 1999.



IMAMËT DHE XHEMATI I ZHUPËS URUAN MYFTIUN TËRNAVA



Më 23 janar 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim një pjesë të imamëve dhe të xhematit të Zhupës, të cilët e uruan atë për rizgjedhjen e tij në krye të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës edhe për një mandat, duke i dëshiruar punë të mbarë, të suksesshme dhe të bereqetshme.

Myftiu Tërnavë falënderoi imamët dhe xhematin për urimet, duke shprehur kështu konsideratën e tij për punën dhe angazhimin e imamëve të asaj pjese në përcimin e mesazheve të fesë islame. Ai porositi ata që edhe më tej të vazhdojnë të punojnë dhe ta çojnë në vend amanetin e tyre që e kanë marrë mbi supe. Myftiu Tërnavë falënderoi edhe xhematin, të cilët

gjithnjë kanë kontribuar dhe po vazhdojnë të kontribuojnë për këtë fe dhe për këtë vatan.

Nga ana e tyre, imamët shprehën falënderimet e tyre të jashtëzakonshme për përkrahjen e vazhdueshme të Myftiut Tërnavë.

URIMI I MYFTIUT TËRNAVA PËR ZGJEDHJEN E KRYEMINISTRIT TË MAQEDONISË SË VERIUT, Z. TALAT XHAFERIT

Kam nderin dhe kënaqësinë e veçantë që në emër të Bashkësisë Islame të Kosovës, në emër të institucioneve të saj dhe në emrin tim personal, të përgëzoj e të uroj z. Talat Xhaferi, me rastin e zgjedhjes si kryeministër i Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke i uruar suksese e mbarësi për mandatin që sot e mori nga kuvendarët e Parlamentit të Maqedonisë së Veriut.

Zgjedhja e z. Xhaferit në krye të Qeverisë së Maqedonisë së Veriut, përveç që është një moment historik për shqiptarët në viset e Maqedonisë, s'ka dyshim se paraqet premisa për qasje të re në rajonin tonë, ku dëshmohet që komunitetet e etnitë në këtë nënqiell, mund të jetojnë në paqe e mirëbesim, si dhe dëshmon se mund të ngrenë institucione të përgjegjshme, që promovojnë vlerat e bashkëjetesës, respektit e harmonisë në rajonin tonë.



Jam i bindur se zgjedhja e z. Xhaferit për të udhëhequr Qeverinë e Maqedonisë, do ta dëshmojë katërçipërisht orientimin e popujve tanë në rrugën e tyre drejt integriteteve në BE, si dhe për përcaktimin e tyre për shoqëri të lira e demokratike.

*Zoti të ndihmoftë vëlla Talat!
Myftiu i Kosovës,
Naim ef. Tërnavë
Prishtinë, më 28 janar 2024*

SEKRETARI SADRIU PRITI NË TAKIM KRYETARIN E FONDACIONIT PËR STUDIME BALLKANIKE (FSB), Z. SEVBA ABDULA

Më 11 janar 2024, sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka pritur në takim një delegacion nga Fondacioni për Studime Ballkanike (FSB), në përbërje nga z. Sevba Abdula, kryetar, prof. dr. Ahmet Köroğlu,

profesor në Universitetin e Stambollit dhe prof. dr. Serdar Serdaroğlu, këshilltar i rektorit të Universitetit Ndërkombëtar Ballkanik (IBU).

Sekretari Sadriu iu uroi mirëseardhje mysafirëve, e më pas i njohu ata me punët dhe aktivitetet që zhvillon

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, me theks të veçantë në fushën e studimeve dhe të botimeve.

Nga ana e tij, kryetari z. Sevba Abdula, falënderoi sekretarin për pritjen, e më pas e njohu atë me projektet hulumtuese të cilat synojnë që t'i realizojnë.



KËSHILLI DREJTUES I IHSI-SË MBAJTI MBLEDHJEN E RADHËS

Më 11 janar 2024, Këshilli Drejtues i Institutit për Hulumtime dhe Studime Islame, ka mbajtur mbledhjen e radhës, të cilën e kryesoi drejtori i Institutit, prof. Sabri ef. Bajgora.

Në këtë mbledhje, Këshilli analizoi dhe vlerësoi organizimin e Konferencës Shkencore “Xhamia te shqiptarët – histori, mision, identitet”, e cila u mbajt më 9 dhe 10 dhjetor 2023.

Konferenca Shkencore “Xhamia te shqiptarët – histori, mision, identitet”, u mbajt më 9 dhe 10 dhjetor 2023, ku rreth vetes mbledhi mbi 70 studiues



nga Kosova, Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina, Jordania dhe Egjipti, të cilët, me kumtesat e tyre vunë në pah të

rëndësinë, historinë dhe misionin që ka pasur xhamia si institucion te populli ynë.

KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM KOORDINATOREN E AGJENCISË TIKA

Më 25 janar 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, priti në takim koordinatoren e Agjencisë Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim në Kosovë (TIKA), znj. Fulya Aslan.

Kryeimami Sahiti e falënderoi znj. Fulya Aslan për vizitën dhe për bashkëpunimin e shkëlqyer që ka TIKA me Bashkësinë Islame të Kosovës në realizimin e një sërë projektesh të rëndësishme për Bashkësinë Islame, sidomos në ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore islame në Kosovë, duke restauruar disa objekte të trashëgimisë fetare islame në vend.



Nga ana e saj, znj. Fulya Aslan, falënderoi kryeimamin Sahiti për pritjen dhe për bashkëpunimin e mirë të deritanishëm që kanë pasur, duke pohuar kështu se një gjë e tillë do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Agjencia TIKA përgjatë viteve të fundit ka restauruar disa objekte të rëndësishme të trashëgimisë fetare islame në Kosovë.

DREJTORI SIMNICA PRITI NË TAKIM MUSTAFË EF. ISLAMIN

Më 8 janar 2024, drejtori për Diasporë i Bashkësisë Islame të Kosovës, Ekrem ef. Simnica, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, ka pritur në takim nëpunësin dhe aktivistin e Qendrës Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork, Mustafë ef. Islamin.

Gjatë këtij takimi, drejtori Simnica, fillimisht i uroi mirëseardhje mysafirit, dhe shfrytëzoi rastin që ta njoh atë me ecurinë e punëve dhe zhvillimeve në Bashkësinë Islame të Kosovës, si dhe për bashkëpunimin që kanë me qendrat islame në diasporë. Ai edhe njëherë

rikonfirmoi gatishmërinë e tij që të kenë edhe më tutje bashkëpunim në të gjitha fushat me rëndësi për besimtarët myslimanë.

Nga ana e tij, nëpunësi dhe aktivisti, Islami, fillimisht falënderoi për pritjen dhe pas falënderoi drejtorin Simnica për bashkëpunimin e deritanishëm që ka pasur ai dhe institucioni i BIK-ut me qendrat islame në diasporë, e në veçanti me Qendrën Shqiptare Islame Kulturore në Nju Jork.



Frymëzimi

(Diptik)

Granit Sadiku

*Puna e pastër matet nga nijeti,
për të shpërblim është vetë Xheneti.*

*Kush ka pasur nijet të mirë,
së ka pasur aspak vështirë.*

*Në rrugë të jetës kur është tretur,
gjithmonë zgjidhjen e ka gjetur.*

*Se zgjidhja është bazë, e themel e ka nijetin.
Besimi është ndjenja vetëm për Të Vërtetin.*

*E kur hiri hidhet syve nga ai që s'përpiqet,
vepra e vepruesi në zjarr digjet!*

*Nuk lehtësohet dega kur rrënja këputet,
e as çështja e të padrejtë që për të keq lutet!*

*Nijeti është një gjë e paparë.
Nuk i vëren dot mynafikët nga safi i parë!*

*E kur zemra vdes pa jetuar,
vdekja e bartësit quhet e merituar.*

*E sa për ata që shpirtin e kanë të ndriçuar,
aspak shpërblimi s'do t'u jetë vonuar!*

*Se Zoti ka bërë Xhenet me stoli,
për zemrën që bymehet nga dashuria e Tij.*

*Zemra e njeriut është pasqyra,
që shfaq arsye dhe jo mënyra!*

*Andaj, o njeri, duro pa gjykuar
imanin ndaj Zotit të lartësuar!*

*Se nijeti është si uji i turbullt,
që në shikimin tënd duket i mjegullt.*

*Ti mund ta urresh se është i pashijshëm,
por Zoti ta dojë vetëm pse është i pijshëm!*

*"Me të vërtetë veprat janë sipas nijetit"
- ishin fjalët e të vërtetit.*

*Andaj kur vepra të kesh gjykuar,
ndaj nijetit, aman, kujdes të shtuar!*

*T'u bëftë nijeti zgjidhje e çdo ankimi,
kur vullneti është mirësia, e jo dredhimi!*



Perlë e kokës sime

Perlë!

Mbi kokën time qëndron,

si një kurorë e pashuar që krenarinë ma shpalon.

Ti jep dritë ngado që shkon!

Zoti mua më obligoi që një pëlhurë ta vendoi.

Por, kjo nuk është thjesht pëlhurë, është më shumë.

“O ti Pejgamber, thuaju grave tuaja të vendosin mbulesën mbi kraharorët e tyre...” (El Ahzab, 59),

e urdhri pasoi mbi çdo grua, mbi ty dhe mbi mua.

Por nuk është thjesht një pëlhurë,

është shumë më shumë,

është urdhër nga i Ndríturi,

që me të, të ndriçoj edhe unë.

E atëherë kur lapsi shkroi,

mua dhe ty na obligoi që ta mbajmë kurorën.

T'i japim dije kësaj mendjes sonë të dëlirë!

Ti edhe mund të pyesësh, po çfarë do dija me pëlhurën?

Po, a bën ngjyra pa pikturën?!

A bën të jetojmë pa ujë dhe bukë?!

Njësoj është edhe pëlhura me dijen,

bëhen bashkë dhe japin shëmbëlltyrën.

Perlë!

Është vështirë të gjendesh,

në thellësinë e oqeanëve ti fshihesh,

nën guaska të mbyllura që thyhen.

Prandaj vlera rritet për shkak të mbulimit të saj.

E gjen, e thyen dhe ia di rëndësinë,

e pastaj, ti shkëlqen si rruazë e Xhenetit.

Të premtoj, kështu jemi unë edhe ti nën hijen e këtij petku.

Perlë!

Me vështirësi të gjendesh,

por shkëlqen e nuk venitesh.

Bardhësia jote shndritë në çdo anë.

S'mund të të quajnë ndryshe veçse thesar.

Nderi yt është ngritur lart,

e nuk mund ta nëpërkëmbin as rërë e as baltë.

Me mbulimin tënd ti nuk fshihesh,

teksa me nderin tënd ti zbulohesh,

e në mbylljen e guaskave ti mbrohesh.

Prandaj edhe vlera jote rritet për shkak të vështirësisë.

Edhe kur gjendesh, ti jep vetëm dritë.

Perlë!

Edhe pse ti mbuloresh,

nuk të humbet vlera,

por veçse të shtohet.

Pa më thuaj ti njeri, thesari, a fshihet në errësirë për të bërë dritë,

apo lihet në dritë që të bëhet si errësirë.

E ndoshta perlë, ty të kam mbivlerësuar,

kur me mbulesën time të kam krahasuar.

Ty të mban çdokush në dorë,

e mbulesa ime është kurorë mbi kurorë.

Kurora e parë është mendja,

e ndërsa e dyta është mbulesa.

Pa u ndriçuar e brendshmja me diturinë,

nuk zbukurohet e jashtmjja me shaminë.

Kurorë mbi kurorë kam vënë në kokë,

e dëgjoj zërin e bindjes e dal jashtë nëpër botë.

Perlë apo pëlhurë,

sido që të quajnë.

Je pjesë e trupit tim!

Je pjesë e nderit tim!

Sa ke vlerë ti, më thuaj?

Vlerë të pa përshkruar,

me shpërblim të caktuar te Zoti kur të shkojmë,

e ballëhapur me Të, takimin do ta kërkojmë.

Obligimin e kemi plotësuar,

e shpresojmë ta marrim shpërblimin e kërkuar,

atë dhuratën më të çmuar,

shikimin e Zotit të Madhëruar.

Eh po!

Perlë, kot nuk i themi,

se ajo na e dha këtë emrin e bukur që e kemi.
 E mbuluar të jesh,
 do të thotë nder të kesh.
 E nderi nuk është për këdo,
 por për këtë çështje, ti vetëm puno!
 Mbulesën mbi kraharor hidhe e mos e fal për asnjë kacidhe!
 Mbaje qëndrimin e me kokën lart qëndro,
 çdo minutë vetëm shpërblime fito.
 Në të nxehtë nuk do të kesh vështirësi,
 pasi edhe dielli do të largohet nga ti,
 e në të ftohtë do të kesh mburojë.
 Asnjë i ftohtë te ti nuk do të depërtojë.
 E bukur është të jesh e mbuluar,
 pasi kjo është shenjë e një shoqërie të civilizuar.
 Perlë!
 Shpirti ndien kënaqësi,
 e vetëm ti na e ofron këtë ndjesi.
 Pëlhurë e bukur,
 ti je e dashur,
 me ty më qetësohet trupi,
 kur e di se çka është turpi.
 E ndiej veten të qetë kur e di se ti më jep vlerë.
 Kur mbulova trupin,
 nuk mbulova trurin,
 unë vazhdova të mësoj e mendjen time ta ndriçoj.
 E dija që ajo nuk është pengesa,
 përkundrazi është vetëm ndihmesa.
 E lirë mund të dal dhe askush për dituri nuk do të më ndal.
 Shaminë time do ta dëshmojë,
 se ajo vetëm për të mira njihet dhe se gjithkrah do të shihet.
 Me vete mbulesën time gjithmonë do ta kem,
 unë dhe ajo jemi një,
 ajo është unë dhe unë do të jem ajo përgjithnjë.

Samire Bilalli



**BOTIM
I RI**



Libri “Nga kursija e xhamisë” i Isa ef. Tërshanit është një koleksion temash e trajtesash të bukura, të cilat kanë për synim që Islamin ta bëjnë të qartë, të lehtë e të jetësueshëm për secilin njeri mendjeshëndoshë të këtij brezi, mirëpo jo vetëm. Ai, pa u tejzgjatur në shtjellime jovlerore, prezanton një mozaik temash e trajtesash islame, të cilat nxisin për veprime të kërkuara prej Allahut, apo edhe tërheqin vërejtjen dhe lëshojnë alarmin për disa të tjera të ndaluara prej Tij.

DITURIA ISLAME • Nr. 399 SHKURT 2024